



SHQYRTIMI I SEKTORIT TË SIGURISË SË BRENDSHME TË KOSOVËS

**Fazat I & II
(SHQYRTIMI STRATEGJIK I MJEDISIT
DHE ANALIZA E KËRCËNIMEVE TË
SIGURISË)**

TË DHËNAT FILLESTARE

KIPRED
Mars, 2006

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	f.3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	f.5
HYRJE.....	f.11
Pjesa I: SHQYRTIMI STRATEGJIK I MJEDISIT.....	f.12
SIGURIA E PËRGJITHSHME POLITIKE.....	f.12
SIGURIA SOCIALE.....	f.28
SIGURIA EKONOMIKE.....	f.35
SIGURIA E AMBIENTIT	f.43
SIGURIA E KOMUNITETEVE ETNIKE.....	f.46
INSTITUCIONET E SIGURISË.....	f.50
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	f.57
Pjesa II: ANALIZA E KËRCËNIMEVE TË SIGURISË.....	f.60
KËRCËNIMET E BRENDSHME.....	f.60
KËRCËNIMET TEJ-REGJONALE.....	f.62
KËRCËNIMET NDËRKOMBËTARE.....	f.63
PIKAT E BRISHTA.....	f.64
PËRFUNDIMET.....	f.66
BIBLIOGRAFIA.....	f.71

LISTA E SHKURTESAVE

ABPK (Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës)
AER (Agjencia Evropiane për Rindërtim)
AKMA (Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Ambientit)
AP (Anëtar i Parlamentit)
BB (Banka Botërore)
BE (Bashkimi Evropian)
BK (Buxheti i Kosovës)
BKK (Buxheti i Konsoliduar i Kosovës)
CIVPOL (Policia Civile e Kombeve të Bashkuara në Kosovë)
EHKK (Ethet Hemorragjike Krimere të Kongos)
EJ (Evropa Juglindore)
FID (Fondacioni për Iniciativa Demokratike)
FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar)
IPVQ (Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes)
IRJM (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë)
KB (Kombet e Bashkuara)
KEK (Korporata Energjetike e Kosovës)
KFOR (Forca e Kosovës)
KIPRED (Instituti Kosovare për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave)
KPP (Kompanitë me Pronësi Publike)
KPSH (Kompanitë më Pronësi Shoqërore)
KVM (Kompanitë e Vogla dhe të Mesme)
LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës)
MASHT (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë)
MAPH (Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor)
MASS (Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Serbisë)
MBPZHR (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural)
MEF (Ministria e Ekonomisë dhe Financave)
MSAS (Ministria e Serbisë e Arsimit dhe Sportit)
MTL (Marrëveshje e Tregtisë së Lirë)
MW (Megavat)
OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë)
OJQ (Organizatë Jo-qeveritare)
PBV (Prodhimi Bruto Vendor)
PDK (Partia Demokratike e Kosovës)
PFB (Pariteti i Fuqisë Blerëse)
PS (Pakti i Stabilitetit)
PSSP (Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm)
PZHBV (Personat e Zhvendosur Brenda Vendit)
QKKM (Qendra Koordinuese për Kosovë dhe Metohi)
QKS (Qendra për Kontroll të Sëmundjeve)

RKSKB (Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara)
RPH (Raporti i Paralajmërimit të Hershëm)
RSHS (Reparti i Shërbimeve të Sigurisë i SHPK-së)
SHSBS (Shqyrtimi i Sektorit të Brendshëm të Sigurisë)
SHPK (Shërbimi Policor i Kosovës)
SMSJ (Studimi për Matjen e Standardit Jetësor)
SMZ (Serbia dhe Mali i Zi)
TMK (Trupat Mbrojtëse të Kosovës)
UNAIDS (Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara kundër HIV/AIDS)
UNDP (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara)
UNMIK (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)
Rez. 1244 (Rezoluta e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244)
USD (Dollari i Shteteve të Bashkuara)
ZSK (Zyra e Statistikave të Kosovës)

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport ka të bëjë me dy fazat e para (Shqyrtimin Strategjik të Mjedisit dhe Analizën e Kërcënimeve të Sigurisë) të Shqyrtimit të Sektorit të Brendshëm të Sigurisë në Kosovë (ang: ISSR). Ky raport është shkruar nga KIPRED-i duke u bazuar në intervistat dhe hulumtimet e bëra, dhe mbështetet në të dhënat zyrtare si dhe të dhëna të tjera relevante. Raporti është i argumentuar me komente dhe të dhëna të cilat janë nxjerrë nga një seri e këshillimeve të bëra nëpër komuna të ndryshme me ndihmën e OSBE-së gjatë muajve shkurt – mars 2006, me pjesëmarrjen e mbi njëmijë pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme që jetojnë në Kosovë.

Qëllimi i të dhënave fillestare të Shqyrtimit Strategjik të Mjedisit dhe Analizës së Kërcënimeve të Sigurisë (Fazat 1 & 2 të ISSR) është vënia në pah e faktorëve kryesorë të cilët duket se do të kenë ndikim në formësimin strategjik të mjedisit të tanishëm dhe të ardhshëm, sikundër edhe identifikimi i burimeve kryesore të kërcënimeve të sigurisë.

Faktorët Strategjik

Kosova administrohet sipas autorizimeve që dalin nga Kapitulli VII i Kartës së OKB-së në emër të qetësimit të rreziqeve të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Për shkak të kësaj përgjegjësie prania e KB në Kosovë nuk është përfshirë në shkallë të madhe në një proces të mirëfilltë shtet-formues. Përveç kësaj, Kosova ende është duke përjetuar një qeverisje të dyfishtë, me kompetenca të shpërndara ndërmjet autoriteteve lokale dhe atyre ndërkombëtare. Kjo zgjidhje e kompetencave të rezervuara vetvetiu imponon një ndarje jo të qartë të përgjegjësisë dhe krijon konfuzion për vijat e ndarjes së përgjegjësisë. Për më tepër, institucionet qeverisëse shikohen me një dozë të konsideruar dyshimi nga ana e komunitetit serb. Si rrjedhojë, serbët e Kosovës në masë të theksuar mbështeten në strukturat paralele për shumë shërbime elementare.

Legjitimiteti i institucioneve të Kosovës është i kufizuar kryesisht në pjesën mbizotëruese të shqiptarëve të Kosovës dhe të komuniteteve të tjera jo-serbe. Në mënyrë eksplicite apo implicite, popullata serbe e Kosovës nuk iu ka dhënë legjitimitet IPVQ-ve/UNMIK-ut dhe ata nuk kanë instrumente legjitime të përfaqësimit. Rrjedhimisht, sfida me të cilën ballafaqohet Kosova është se si në mënyrë të vazhdueshme të përmirësohet puna dhe të forcohen kanalet të cilat mundësojnë shprehjen e vullnetit politik përmes mjeteve ligjore, legjitime dhe konstruktive.

Arsimi vazhdon të mbetet një sfida e rëndësishme në Kosovë dhe aktualisht është duke iu kushtuar vëmendje e pamjaftueshme reformave të sistemit arsimor. Shkalla e analfabetizmit në Kosovë është njëra ndër më të lartat në Evropë dhe kjo vë në dyshim kualitetin e mësuësve.

Kapacitetet e kujdesit shëndetësor të Kosovës janë larg nën mesataren e BE-së dhe të nevojave të popullsisë. E drejta për përkujdesje adekuate shëndetësore është çështje fundamentale për shumë njerëz në Kosovë, dhe në veçanti për minoritetet të cilat kanë

probleme të mëdha në qasjen e këtyre shërbimeve. Pandemia mund të sjell një kërcënim serioz për popullsinë e Kosovës. Me rritjen globale të transportit dhe komunikimit, gjithashtu të urbanizimit të mbipopulluar, shumë lehtë mund të përhapën epidemi, si për shembull: virusi i ri i gripit mund të përhapet shumë lehtë në mbarë rajonin. Është parashikuar që ndikimi i pandemisë së ardhshme do të ketë efektin më të madh në vendet me zhvillim të ulët sepse aty shumë shpejt mund të harxhohen burimet e kufizuara të kujdesit shëndetësorë. Mungesa e koordinimit qeveritar është një shqetësim i veçantë në rast se Kosova do të përballëj me ndonjë shpërthim të ndonjë sëmundje.

Me një shkallë të lartë të papunësisë dhe më një parashikim të rritjes së popullsisë në vitet e ardhshme, varfëria në Kosovë po bëhet një problem strukturor që lidhet me sigurinë. Zgjerimi demografik vazhdon të shkojë përtej zhvillimit ekonomik dhe sinjalizon për një perspektivë të zymtë ekonomike. Mungesa e një baze të efektshme taksimi ka bërë që rritja ekonomike në Kosovë gjatë gjashtë viteve të fundit të jetë e varur në masë të lartë nga ndihma e donatorëve. Megjithatë, ndihma nga donatorët e huaj është në rënie, (23 % e BPV në vitin 2004 krahasuar me 36% në 2002 dhe 28% në vitin 2003). Në vitet që pasuan menjëherë pas përfundimit të luftës, ekonomia e Kosovës shënoi rritje të konsiderueshme ekonomike por kjo rritje u ngadalësua në vitin 2004 dhe ka vazhduar të ketë rënie si pasojë e zvogëlimit të ndihmave të huaja.

Investimet private dhe të huaja në Kosovë nuk kanë dhënë sukses. Respektimi i ulët i rëndit dhe ligjit, korrupsioni, problemet e sigurisë, situata e paqartë e tatimeve dhe çështjet e pronësisë kanë bërë që investimet të mos jenë tërheqëse. Infrastruktura joadekuatë, duke përfshirë mungesën për furnizim me energji, ku sistemi energjetik nuk ka arritur të jetë i qëndrueshëm dhe i garantuar në gjashtë vitet e fundit, ka ndikuar edhe më shumë në perspektivën e zymtë për rritje ekonomike dhe përmirësimin e mundësive për punësim.

Fqinjësia e Kosovës po bëhet me e sigurt dhe mundësia potenciale për konflikte në rajon është pothuaj e izoluar. Edhe pse, përmes prezencës ushtarake NATO-ja siguron Kosovën nga kërcënimet e jashtme, akoma nuk mund të thuhet se Kosova është njëra ndër vendet më të sigurta në rajon për shkak të sektorit të dobët të sigurisë, dhe në mënyrë të veçantë për shkak të shërbimeve në hije të inteligjencës të mbështetura financiarisht nga partitë politike kosovare. Përveç kësaj, janë edhe aktivitetet e shërbimeve të sigurisë së Serbisë të cilat vazhdojnë ta minojnë edhe më tepër mjedisin e përgjithshëm të sigurisë dhe rëndit kushtetues të Kosovës.

Kërcënimet e Sigurisë

Kosova ballafaqohet me një numër të kërcënimeve potenciale të sigurisë. Ekstremizmi politik, dhe organizatat terroriste të lidhura me të, janë ato që paraqesin kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë e brendshme e cila lidhet me pasigurinë politike aktuale dhe shqetësimet rreth procesit dhe rezultateve të statusit përfundimtar të Kosovës. Mungesa e një perspektive të qartë për të ardhmen, strukturat paralele të sigurisë nga të dy komunitetet e mëdha, subverzioni politik i ushtruar nga Serbia dhe mos integrimi etnik kanë sjellë Kosovën në prag të dështimit.

Krimi i organizuar paraqet një kërcënim të sigurisë në planin e tanishëm dhe afatgjatë. Lidhjet e korrupsionit politik me krimin e organizuar, shoqëruar me sundimin e dobët të

rëndit dhe ligjit paraqesin probleme serioze për sigurinë e Kosovës. Kësaj gjendjeje i shtohet edhe fakti se sikur shumica e vendeve në rajon, Kosova është e ndikuar nga trafikimi i genieve njerëzore, drogës dhe armëve. Posedimi i armëve të vogla dhe armëve të lehta është edhe një burim tjetër i pasigurisë.

Në momentin e tanishëm Kosova nuk mund të konsiderohet si një nga burimet e terrorizmit ndërkombëtar, fundamentalizmit fetar apo përhapjes të armëve të shkatërrimit në masë. Megjithatë, në rast se ekonomia nuk do të përmirësohet dhe institucionet shtetërore nuk do të forcohen, atëherë Kosova mund të bëhet një vend ideal për grupet fetare fundamentaliste.

Përmbledhje

Rezultatet e këtij raporti janë të përmbledhura si më poshtë:

Siguria politike

- Ka pasur mungesë të përgatitjeve për qeverisje të mirë në Kosovë dhe kjo ka shkaktuar zbrazëtira serioze në kapacitetet e gjithëmbarshme.
- Qeverisja e dobët dhe politizimi i administratës publike i shkaktuar pjesërisht nga situata aktuale politike, zvogëlon kapacitetin e qeverisë për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të popullatës dhe t'iu adresohet çështjeve të sigurisë.
- Kuvendi nuk është duke përmbushur në nivel të duhur rolin e tij mbikëqyrës dhe legjislativ. Kuvendi duhet të forcohet nëse dëshiron që në mënyrë adekuate ta përmbush rolin e tij në kuadër të sigurisë. Duhet ti kushtohet një vëmendje nevojës së ndryshimit të sistemit zgjedhor me qëllim që deputetët të bëhen më të përgjegjshëm për veprimet e tyre kundrejt zgjedhësve.
- Mungesa e koordinimit qeveritar brenda dhe ndërmjet IPVQ-ve dhe UNMIK-ut si në duplikim dhe dështimet për t'iu përgjigjur emergjencave komplekse qofshin ato pakënaqësi sociale apo emergjenca natyrore.
- Rritja e zhgënjimit dhe mungesa e besimit në IPVQ dhe UNMIK nënkupton se legjitimiteti është në masë të madhe problem në Kosovë, dhe kjo në vetvete paraqet një kërcënim të rëndësishëm për sigurinë. Komuniteti serb gjithashtu ka vazhduar që të refuzoj të njoh legjitimitetin e institucioneve të Kosovës. Dyshimi për aftësinë e qeverisjes efektive në Kosovë është njëra ndër dukuritë më shqetësuese në planin e kërcënimeve afatgjata.
- Pakënaqësia me punën e gjyqësorisë dhe papërshtatshmëria e sistemit penal janë duke e minuar sundimin e ligjit dhe mundësinë për funksionimin e policisë. Vazhdimësia e ekzistencës së strukturave paralele gjyqësore nxitë edhe më tepër mungesën e respektit për organet gjyqësore të Kosovës. Ende ka identifikim të vogël të popullatës së Kosovës me kornizën e tanishme ligjore.

- Zyra e Ombudspersonit ballafaqohet me një mungesë serioze të kredibilitetit dhe kjo nuk është ndihmuar as pas vendimit të fundit të UNMIK-ut se institucionet ndërkombëtare edhe më tutje nuk mund të jenë objekt i inspektimit të tyre.
- Sigurimi i mirëqenies sociale është një funksion thelbësor i funksionimit të shtetit e që aktualisht nuk është garantuar në mënyrë adekuate dhe kështu dëmton besimin publik në institucionet shtetërore. Favorizimet që bëhen në disa nivele, duke përfshirë ndikimet e partive politike dhe ato në baza etnike lidhur më atë së kush duhet të përfitoj, vetëm sa përkeqësojnë gjendjen.
- Mungesa e sigurisë politike është një faktor tjetër shoqëruar që ndikon në jo stabilitetin rajonal dhe pasiguri.

Siguria sociale

- Mospërputhja ndërmjet trendëve demografike dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë përbën një nga kërcënimet strukturore afatgjate të sigurisë në Kosovë. Shërbimet joadekuate të shëndetësisë dhe edukimit nuk janë të mjaftueshme për t'i përmbushur nevojat e popullsisë në rritje të Kosovës dhe kjo gjendje vetëm sa do të përkeqësohet edhe më shumë në mungesë të zhvillimit social dhe ekonomik. Zhgënjimi në shkallë të gjerë dhe mos edukimi i duhur i rinisë do të jetë një stimulues i madh për rritjen e kriminalitetit dhe rasteve sociale.
- Rritja e analfabetizmit në Kosovë, në veçanti në mesin e femrave në vendet rurale, është një pengesë për zhvillimit afatgjatë në planin social dhe ekonomik, punësim dhe si rrjedhojë edhe në siguri.
- Arsimi mbetet një çështje shqetësuese pasi që vazhdon të thelloj ndarjen ndërmjet komuniteteve si në aspektin fizik e gjithashtu edhe nëpërmjet programeve në të cilat mësohen në shkollat e ndara shqiptare dhe serbe. Për më tepër, për aq kohë sa komunitetet janë të frikësuara që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në të njëjtat shkolla, atëherë kjo paraqet edhe një tregues tjetër për gjendjen e tensionuar ndëretnike.
- Varfëria ekstreme në Kosovë për një kohë të gjatë do të vazhdojë të mbetet prodhues i krizave sociale dhe i rritjes së kriminalitetit pasi njerëzit ose do të shprehin mllefën e tyre ndaj shtetit dhe shoqërisë ose do t'i rreken kriminalitetit si strategji për të mbijetuar.
- Kosova mbetet një shoqëri e ndarë me shumë pak ndërveprim ndërmjet shumicës shqiptare dhe minoritetit serb. Kjo ndarje në pjesë të madhe është rezultat i gjendjes së krijuar në të kaluarën por edhe i ndjenjave aktuale të pasigurisë tek serbët e Kosovës që për pasoj sjell krijimin e rrethit vicioz në mungesë të sigurisë dhe thellimin edhe më të madh të gjendjes së pasigurisë si pasojë e ndarjeve etnike.

Siguria ekonomike

- Mbështetja e madhe e Buxhetit të Kosovës (BK) në taksat doganore (70%) pasqyron deficitin e tanishëm tregtar dhe po ashtu edhe ekonominë jo të shëndoshë. Megjithëkëtë, në planin afatgjatë kërcënimi më i madh që lidhet me sigurinë do të mund të jetë korrupsioni eventual në shërbimet doganore. Në kuadër të kësaj duhet theksuar edhe faktin se buxheti i Kosovës dhe politikat fiskale do të ndikohen negativisht nga aplikimi i mundshëm i Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë (MTL).
- Mungesa e ekonomisë së qëndrueshme minon çdo mundësi afatgjate për Kosovën dhe sjell papunësi të lartë, që ndoshta është kërcënimi më i madh për sigurinë në planin afatgjatë.
- Vazhdimësia e gjendjes së tillë ekonomike e karakterizuar nga përkrahja e donatorëve mund të rezultojë edhe më zvogëlimin e mundësive të Kosovës për t'iu përgjigjur kërcënimeve të sigurisë.
- Pamundësia për të pasur burim të pandërprerë të energjisë është një faktor tjetër shkatërrues i investimeve në Kosovë. Për më tepër, mungesa e ndriçimit në zonat e urbanizuara krijon përshtypjen e pasigurisë dhe gjithashtu demonstroi paaftësinë e qeverisë dhe zbehë legjitimitetin e saj.

Siguria e ambientit

- Situata e tanishme e papërgjegjesisë ka ndikuar shumë edhe në ambientin e Kosovës i cili është nën kërcënim të vazhduar për shkak të ndërtimeve ilegale, menaxhimit të dobët të mbeturinave, ndotjes dhe i veprimeve të cilat shkaktojnë erozionin e tokës dhe vërshimet. Kjo gjendje pengon investimet dhe për më tepër vështirëson edhe me shumë gjendjen problematike të ambientit me të cilin ballafaqohet popullata në rritje në Kosovë, dhe për rrjedhojë sjell rritjen e sëmundjeve.

Siguria etnike

- Vazhdimi i perceptimit të pasigurisë në mesin e komuniteteve, e në veçanti tek komuniteti serb, e gjithashtu edhe mos integrimi i komuniteteve paraqesin një problem kërcënues afatgjatë për stabilitetin dhe sigurinë.
- Pasiguria politike dhe ekonomike është forca kryesore e cila nxit migrimin jashtë Kosovës. Sa i përket popullatës serbe kryesisht janë arsyet politike ato të cilat nxisin këtë fenomen ndërsa për popullatën shqiptare duket se mungesa e mundësive ekonomike është shkaku kryesor.

- Përkundër kornizës ligjore e cila garanton barazinë ndërmjet grupeve etnike dhe të drejtën për kthim, mundësitë për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin e komuniteteve ndërmjet minoriteteve janë të kufizuara.

Institucionet e sigurisë

- Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të SHPK-së do të bëhet problematike në atë moment kur atyre do t'iu kërkohet të marrin përsipër rolin që momentalisht e kryen prania e policisë ndërkombëtare.
- TMK-ja nuk është e pranuar akoma nga minoriteti serb. Ndërkohë që TMK-ja mund ta tejkaloj këtë pengesë, ekziston një problem tjetër që ka të bëjë perceptimin e popullatës se mandati i tanishëm i TMK-së si një organizatë civile emergjente duhet të avancohet në ushtri të ardhshme. Kjo mospërputhje ndërmjet mandatit dhe aspiratave, si nga ana e personelit e po ashtu edhe nga popullata konsiderohet si një çështje problematike.
- KFOR-i është përgjegjës për sigurinë dhe ofron përkrahje për të gjitha komunitetet në tërë Kosovën. Si garantuesi i vetëm i sigurisë së jashtme në Kosovë, vazhdimi i rolit të KFOR-it do të jetë faktor thelbësor për të siguruar stabilitet të vazhdueshëm në Kosovë. Komuniteti ndërkombëtar, megjithëkëtë, në planin afatgjatë duhet të mendoj për ndonjë mekanizëm tjetër adekuat që do ta zë vendin e KFOR-it kur ai të tërhiqet.

Institucionet ndërkombëtare

- Largimi i UNMIK-ut do të krijoj një zbrazëturë të konsiderueshme të kapaciteteve dhe institucioneve në çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me sigurinë, andaj duhet që ky problem të trajtohet para largimit të tij.

HYRJE

Ky raport paraqet fazat një dhe dy (të Shqyrtimit Strategjik të Mjedisit dhe Analizës së Kërcënimeve të Sigurisë) të Shqyrtimit të Sektorit të Brendshëm të Sigurisë së Kosovës (SHSBS) dhe është i përgatitur nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED). Është i përbërë nga dy pjesë: nga Shqyrtimi Strategjik i Mjedisit dhe Analiza e Kërcënimeve të Sigurisë. Ky raport bazohet në hulumtimin e bërë nga ekipi i KIPRED-it dhe është i argumentuar nga informacionet e grumbulluara nga 32 takime konsultative të nivelit komunal me përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve të organizuara nga OSBE gjatë shkurtit dhe marsit 2006. Pjesëmarrësit në takimet konsultative kanë qenë shërbyes civil të niveleve komunale dhe gjithashtu ka pasur edhe përfaqësues të SHPK-së dhe të organizatave tjera të sigurisë, OJQ-ve dhe të popullatës së gjerë. Ftesat për pjesëmarrje në takime si dhe prioritetet kryesore për tu hulumtuar kanë qenë të bazuara në kriteret e caktuara nga takimi i parë Konsultativ i SHSBS-së i mbajtur me 10 nëntor 2005 dhe takimi i Komitetit Drejtues të SHSBS, përfshirë këtu edhe inputet e dhëna nga KIPRED dhe OSBE-ja.

Qëllimi i këtij raporti është identifikimi i kërcënimeve kryesore për sigurinë publike në Kosovë e gjithashtu edhe mjedisin nga i cili burojnë këto kërcënime dhe të identifikoj përparësitë dhe dobësitë e sektorit të brendshëm që ekziston në Kosovë. Raporti i qaset sigurisë në mënyrë gjithëpërfshirëse duke përfshirë një numër të madh të çështjeve të cilat kontribuojnë në perceptimet e sigurisë së brendshme në Kosovë. Duke marrë parasysh të dhënat e këtij raporti, sekretariati i SHSBS do të vazhdoj më tej punën e tij duke identifikuar prioritetet për procesin e SHSBS dhe të vazhdoj konsultimet me popullatën e Kosovës me qëllim që të këshillohet për kornizën e ardhshme të sigurisë së brendshme në Kosovë.

SHQYRTIMI STRATEGJIK I MJEDISIT

1. SIGURIA E PËRGJITHSHME POLITIKE

1. HYRJE

Kosova është duke përjetuar një rimëkëmbje të ngadalshme nga lufta e viteve 1998 dhe 1999 e cila si pasoj kishte rezultuar me vuajtje të mëdha, vrasje dhe persona të zhdukur, shkatërrim të pronës, mjerim dhe dëshirim të thellë në popullatë. Populli dhe institucionet e Kosovës aktualisht janë duke bërë përpjekje që këto shkatërrime dhe konfliktin ta lënë prapa. Ato janë duke bërë përpjekje që të krijojnë një shoqëri në të cilën çdo njeri dhe të gjitha komunitetet mund të shpresojnë për një jetë normale dhe të ardhme me të mirë. Situata e përgjithshme e sigurisë është përmirësuar dukshëm dhe si rezultat i kësaj edhe situata e tanishme është relativisht stabile, në rënd të parë për shkak të pranisë së KFOR-it dhe UNMIK-ut.

2. PASQYRA E AKTERËVE INSTITUCIONAL

Korniza ligjore e qeverisë së Kosovës nga ana e bashkësisë ndërkombëtare është e përcaktuar në kuadër të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB nën autoritetin e Kapitullit të VII të Kartës së KB. Nga kjo (RKSKB 1244) komuniteti ndërkombëtar është përcaktuar të jetë autoriteti e cili e ka fuqinë që zbatoj ligjin dhe përdorë shtesë në Kosovë për implementimin e tyre.

Ashtu siç është përcaktuar në RKSKB 1244, mekanizmi më i fuqishëm politik, në siguri dhe çështjet tjera relevante është Misioni i Përkohshëm i Administratës së KB në Kosovë (UNMIK) dhe në veçanti zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Edhe pse është bërë transferimi i një numri të konsiderueshëm të kompetencave tek institucionet e Kosovës, UNMIK-u akoma mbetet entiteti kryesor vendimmarrës dhe duket se do të vazhdoj ta mbaj këtë rol deri në përfundim të procesit të statusit dhe për një periudhë të shkurtër transitorë pastaj¹. Në këtë kuadër, ai do të vazhdoj të ushtroj rol mbikëqyrës mbi institucionet e Kosovës edhe në fushat që tashmë janë përgjegjësi të transferuara.

Po ashtu, KFOR-i është i mandatar me rolin e tij për sigurimin e paqes dhe ruajtjen e sigurisë nga jashtë. KFOR-i ka mandat për zbatimin e ligjit dhe ky rol përmbushet në bashkëpunim me Policinë Civile të UNMIK-ut dhe në masë të theksuar edhe me Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK). Që nga fillimi, KFOR-i i ka dhen llogari Shtabit të Përgjithshëm të

¹ UNMIK është i kategorizuar si akter primar për shkak të natyrës dhe përmasave të misionit të tij dhe përgjegjësi që ai ka. Për më shumë informata lidhur me kompetencat e UNMIK-ut lexoni UNSCR 1244 në: (<http://www.unmikonline.org/press/reports/N9917289.pdf>, vizituar me: 11 janar 2006)

NATO-s dhe jo UNMIK-ut. Për më tepër, për disa çështje, njësitë e caktuara të KFOR-it u drejtohen edhe ministrive së tyre përkatëse nacionale të mbrojtës për udhëzime.

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) përbejnë strukturën e dytë qeverisëse në Kosovë. Në nivelin qendror dhe atë lokal, IPVQ-të janë krijuar si rezultat i katër palë zgjedhjeve të lira dhe të ndershme të mbajtura nga viti 2000 deri 2004. Megjithëkëtë, krijimi i institucioneve demokratike në Kosovë është në një fazë fillestare dhe strukturat e përgjegjshme dhe llogaridhënëse në të gjitha nivelet, kërkojnë më shumë kohë që të arrijnë shkallën e pjekurisë. Që nga fillimi i zgjedhjes së institucioneve demokratike në Kosovë, IPVQ-të janë ballafaquar me mungesën e kapaciteteve përkatëse. Duke mos nënvlerësuar këtë, progresi i bërë drejt implementimit të standardeve ka dëshmuar se institucionet e Kosovës janë zhvilluar gjatë pesë viteve të fundit dhe e kanë kuptuar nevojën për të përmbushur zotimet në raport me popullatën.

Dinamikat politike në Kosovë kanë sjellë ndryshime të rëndësishme që nga themelimi i IPVQ-ve. Përderisa në zgjedhjet e vitit 2000 sollën zgjedhjet e para të lira dhe të ndershme, zgjedhjet e vitit 2004 krijuan opozitën në nivelin të kuvendit të Kosovës. Prania e një opozite i ka ndihmuar në mënyrë pozitive pluralitetit ndërmjet partive politike.

Me intensifikimin e bisedave për statusin përfundimtar, UNMIK është duke lëvizur me shpejtësi drejt bartjes së kompetencave tek IPVQ-të. Në fund të viti 2005, UNMIK i lejoj IPVQ-ve që të themelojnë dy ministri të reja, atë të punëve të brendshme dhe të drejtësisë. Kjo nënkupton faktin se Qeveria e Kosovës do të marrë përgjegjësitë për zbatimin e rendit dhe implementimin e ligjeve për herë të parë².

Institucionet politike serbe janë akterët e fundit të mëdhenj në kuadër të procesit politik në Kosovë. Arkitektura politike serbe përbëhet nga partitë politike, strukturat paralele, OJQ-të dhe nga "Qendra Koordinuese për Kosovë dhe Metohi" (QKKM). Këto institucionet kanë një marrëdhënie të brendshme të komplikuar dhe raportet e tyre me UNMIK-un dhe IPVQ-të janë paqarta. Qendra Koordinuese është institucioni më i madh në Serbi i cili merret me Kosovën dhe përfaqëson qeverinë e Republikës së Serbisë. Megjithëkëtë, sfida kryesore për UNMIK-un dhe IPVQ-në është ekzistenca e strukturave paralele sepse prania e tyre ka ndikime në siguri, gjykata, të drejtat pronësore, edukim, përkujdesjen shëndetësore dhe regjistrimin civil. Analistët dhe diplomatët kanë argumentuar se mungesa e integritetit të komunitetit serb në rend të parë është pasojë e ekzistencës së këtyre strukturave. Megjithëkëtë, është gjithashtu e vërtetë se në përgjithësi serbët nuk kanë besim në IPVQ-të³. Përderisa institucionet paralele kanë qenë pengesë zbatimin e rendit dhe ligjit e gjithashtu edhe për integrim, ato me siguri se kanë shërbyer në mbarëvajtjen e disa gjerave në segmente të caktuara të komunitetit serb. Partitë politike serbe janë aktive në Kosovë dhe në vitet e fundit janë themeluar një numër i konsideruar i partive të reja të cilat kanë arritur të fitojnë

² Për më shumë informata lidhur me krijimin e dy ministrive të reja shikoni në: [http://www.unmikonline.org/dpi/pressrelease.nsf/0/B5D23DE799453CF8C12570DD005AADFB/\\$FILE/pr1469.pdf](http://www.unmikonline.org/dpi/pressrelease.nsf/0/B5D23DE799453CF8C12570DD005AADFB/$FILE/pr1469.pdf), (vizituar: 12 Janar 2005).

³ Është e rëndësishme të thuhet se strukturat paralele janë të instaluar në të gjitha enklavat serbe dhe sigurojnë shërbime të ndryshme për komunitetin serb. Për më tepër lidhur me ekzistencën e strukturave paralele dhe ndikimin e tyre në situatën e përgjithshme në Kosovë, lexoni raportin e OSBE-së për Strukturat Paralele në Kosovë - Parallel Structures Kosovo, http://www.osce.org/documents/mik/2003/10/698_en.pdf (vizituar: 12 Janar, 2006).

numër të konsiderueshëm të votave në zgjedhjet lokale të vitit 2002 siç është rasti me komunën e Shtërpcës.

UNMIK-u në mënyrë të vazhduar ka bashkëpunuar me strukturat politike të komunitetit serb. Sfida kryesore vazhdon të jetë integrimi i tyre në jetën institucionale të Kosovës. Arsyet për mungesë të suksesit janë të ndryshme, por mund të argumentohet se ekzistenca e strukturave paralele është shkaku kryesor për këtë situatë. Derisa, disa analist dhe zyrtarë e lidhin ekzistencën e këtyre strukturave me mosbesimin që ka komuniteti serb ndaj institucioneve të Kosovës; të tjetër argumentojnë se kjo është duke ndodhur për shkak të statusit të pazgjidhur politik të Kosovës. Sido që të jetë, është pothuajse krejtësisht e qartë se ekzistenca e këtyre strukturave paralele ka qenë pengesa kryesore për integrimin e komunitetit serb.

Me largimin e KFOR-it dhe UNMIK-ut, dhe vazhdimin e veprimtarisë së strukturave paralele në Kosovë, dhe IPVQ-të si autoritet ligjor, në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë në tërë territorin, Kosova do të përputhet plotësisht me karakteristikat e të ashtuquajturave shtete të dështuara.

3. Stabiliteti politik dhe institucional

A) Mandati i paqartë për “ndërtimin e shtetit”

Siguria politike është seriozisht e mangët për shkak të mandatit të paqartë të administratës ndërkombëtare e cila ndodhet midis qëllimeve kundërtënëse për një autonomi substanciale bazuar në RKSKB 1244 dhe aspiratave për ndërtimin e shtetit të përkrahura nga elita kosovare dhe shumica e popullatës.

Kosova vazhdon të administrohet sipas autoritetit që buron nga Kapitulli i VII i Kartës së KB në emër të qetësisë të një kërcënimi për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, dhe shumë më pak duke pasur si qëllim shtet-formimin.

Prandaj, stabilizimi i menjëhershëm ka ndalur përpjekjet e mirëfillta për ndërtimin e institucioneve dhe fuqizimin e qytetarisë vendore.

“Pasiguria politike vjen si pasojë e mosrespektimit të vlerave demokratike”

(Pejë)

B) Pushteti karshi dualitetit në qeverisje

Kosova ballafaqohet me sfida serioze në kuadër të qeverisjes së saj. Përgjegjësitë janë të ndara ndërmjet institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Dualiteti në qeverisje ndërmjet organeve lokale dhe atyre ndërkombëtarë sjell një ndarje të përgjegjësive ndërmjet tyre dhe krijon një gjendje konfuze për sa i përket llogaridhënies. Kjo në veçanti është problematike sepse këto marrëdhënie janë

subjekt i ndryshimeve të vazhdueshme, dhe ky ndryshim do të vazhdoj edhe në të ardhmen e afërt.

Qeverisja e paqartë nuk shihet si diçka e mirë nga qytetarët sepse ata thjesht duan të kenë një adresë për nevojat e tyre. (Istog)

Aktualisht, dega e ekzekutivit të IPVQ-ve, pra qeveria, konsiderohet si jo-stabile. Angazhimet e saj me shumë janë të drejtuara në raport me kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare sesa ndaj popullatës shumicë. Mbështetja e qytetarëve për qeverinë kryesisht është i bazuar në pritjet për rezultatet e statusit përfundimtar dhe më pak në mënyrën se si funksionojnë institucionet dhe sa janë ato në gjendje të ofrojnë shërbime.

Përveç kësaj, në vend që të organizoj debate të gjera dhe të rregullta, Kuvendi i Kosovës rrallë mblidhet dhe nuk arrin të nxjerrë reflektime të dobishme që do të mund të lehtësonte ndonjë nga problemet e mëdha të grupeve shoqërore. Sistemi zgjedhor me një zonë të vetme dhe me lista të mbyllura e bën Kuvendin e Kosovës të jetë më pak përfaqësues i popullatës dhe më i vëmendshëm ndaj presioneve brenda-partiake. Edhe pse deri më tani bartja e përgjegjësisë nuk është shoqëruar me ndonjë vështirësi, transferi i përgjegjësisë tjera me krijimin e dy ministrive të reja me siguri se do të stimuloj ambiciet brenda partiake në dëm të stabilitetit dhe përgjegjësisë institucionale. Përgjegjësitë e qeverisjes ashtu siç qëndrojnë tani, janë të ndara ndërmjet institucioneve lokale dhe ndërkombëtare dhe puna relativisht e dobët e të djave krijon në imazh konfuz të përfaqësimit dhe sjell papërgjegjshmëri.

C) Qeverisja e dobët

Qeverisja e dobët pothuajse në mënyrë të njëtrajtshme është e kontestuar nga pjesa më e madhe e popullsisë.

Ofrimi i shërbimeve të dobëta (qoftë në energjetikë, shërbime sociale, higjiena sanitare, siguri) e shkatërron mbështetjen në strukturat zyrtare për sigurimin e shërbimeve elementare. Për më tepër, disa serbë të Kosovës vazhdojnë ti shohin me mëdyshje të thellë institucionet e Kosovës, dhe kjo është një shtytje tjetër për ta që të mbështetën në “strukturat paralele”.

“Vetëm strukturat lokale përfaqësojnë interesat tona”
shqiptar i Kosovës
“Askush nuk përfaqëson interesat tona”
serb i Kosovës
(Fushë Kosovë)

Ndonëse përpjekjet për ta tejkaluar këtë zbrazëti janë të pranishme dhe do të vazhdojnë, nuk pritjet që ato të ketë ndonjë efekt të rëndësishëm para përfundimit të statusit përfundimtar.

D) Kapacitetet koordinuese dhe administrative të organeve qeveritare

Kapaciteti monitorues dhe koordinues i qeverisë qendrore është i dobët⁴, dhe kjo bën që të krijohet edhe mendimi se mekanizmat qeveritar janë gjithashtu të dobët. Kjo nuk është befusuese për shkak se administrata publike në Kosovë është pothuajse e re dhe e papërvojë⁵. Prapëseprapë, nevoja për të aprovuar ligje të reja është theksuar në mënyrë të vazhdueshme nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe përfaqësuesve të administratës ndërkombëtare me qëllim të tejkalimit të vakuumeve ekzistuese në mes sistemit ligjor të trashëguar nga Jugosllavia dhe realitetit të ri social, ekonomik dhe politik⁶. Dhe kështu, duke shtuar përpjekjet e përqendruara në përpilimin dhe aprovimin e ligjeve (për shkak të kërkesave të standardeve dhe të tjera) iu është kushtuar shumë pak vëmendje implementimit të tyre⁷.

“Institucionet e sigurisë qofshin ato vendore apo ndërkombëtare nuk iu përgjigjën në mënyrë adekuate nevojave të qytetarëve”. Kjo ndodhë për shkak të përzierjes së kompetencave, korrupsionit, familjarizimit, mungesës së informacioneve gjatë hulumtimit të krimeve etj.” (Gjilan)

Shumica e treguesve tregojnë për punën e dobët në implementimin e ligjeve dhe rëndit në përgjithësi, duke pasur kundërthënie të ndryshme të ligjeve që nga momenti kur ato miratohen dhe deri tek një qasje e përzgjedhur kur vije në pyetje zbatimi i tyre.

F) Legjitimiteti

Legjitimiteti i institucioneve të Kosovës është i kufizuar në masë të madhe tek shqiptarët e Kosovës dhe tek komunitetet jo serbe. Qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthortë, serbët e Kosovës nuk iu kanë dhënë legjitimitet IPVQ-ve/UNMIK-ut dhe si rrjedhojë shumica e serbëve veprojnë brenda enklavave të tyre.

Këto të fundit konsiderohen si kërcënim për sigurinë nga pjesa dërmuese e popullsisë dhe si një formë e regjimit të Beogradit. Serbet e Kosovës, megjithëkëtë, i konsiderojnë enklavat si një formë mbrojtëse dhe mjet për të siguruar shërbimet elementare. Sidoqoftë, situata e tanishme ushqen mendimin tek shqiptarët dhe serbët, se ata paraqesin kërcënim për njëri-tjetrin dhe konfliktin si rrjedhojë e lojës së tillë zero ku përfitimi i njëres palë nënkupton humbje për palën tjetër.

⁴ Faqja zyrtare e OSBE-së, DOKUMENTI: Implementimi i Ligjeve të Kuvendit të Kosovës, Raporti II - Implementation of Kosovo Assembly Laws Report II, http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/17515_en.pdf (vizituar: 20 dhjetor 2005).

⁵ UNDP, Vlerësimi i Kapaciteteve të Administratës - *Assessment of Administrative Capacity*, mars 2005, f.8.

⁶ Faqja zyrtare e OSBE-së, DOKUMENTI: Implementimi i Ligjeve të Kuvendit të Kosovës, Raporti II - Implementation of Kosovo Assembly Laws Report II, http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/17515_en.pdf (vizituar: 20 dhjetor 2005). f.7

⁷ Faqja zyrtare e OSBE-së, DOKUMENTI: Implementimi i Ligjeve të Kuvendit të Kosovës, Raporti II - Implementation of Kosovo Assembly Laws Report II, http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/17515_en.pdf (vizituar: 20 dhjetor 2005). f.7

Çështja e bëhet akoma më e rrezikshme për shkak të dy strategjive diametralisht të kundërta. Në njërin anë, ka pasur një përpjekje nga IPVQ-të që ti integrojnë ata në kornizën ligjore dhe sociale të Kosovës, dhe në anën tjetër ne jemi dëshmitarë të politikës së Beogradit e cila si qëllim ka ndarjen e Kosovës.

Edhe brenda shoqërive legjitime, gjithmonë ka probleme të thella; por kur është pyetje legjitimiteti i institucioneve të Kosovës duhet thënë se popullariteti është në rënie. Trendët tregojnë për një pakënaqësi të theksuar e cila mund të nxis lehtë revolta serioze.

Sfida e cila mbetet është se si të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme puna e institucioneve (dhe përmirësimi i përkrahjes) dhe rritja e mundësive që të gjitha pakënaqësitë të shprehen përmes mjeteve ligjore, legjitime dhe konstruktive.

***“Mos funksionimi i kuvendeve komunale nënkupton se autoritetet lokale nuk iu përgjigjën nevojave të qytetarëve” (Malishevë
“Anëtarët e Kuvendeve Lokale dhe Qendrore nuk konsultohen me njerëzit që ata përfaqësojnë gjatë procesit të vendimarrjes”
(Kamenicë)***

Përveç të dhënave relevante, edhe të dhënat tjera konfirmojnë trendin e sipërpërmendura. Mungesa e qartë dhe identifikuese e përgjegjshmërisë e ushqen ndjenjën e të qenurit i huaj në raport me sistemin tek një numër në rritje i qytetarëve. Kjo pastaj rrit mundësinë për shprehjen në forma negative të pakënaqësisë në vend të pjesëmarrjes konstruktive. Statistikat tregojnë se ka një shkallë 4 herë më të madhe të pjesëmarrjes destruktive, siç janë protestat publike, krahasuar me pjesëmarrjet pozitive siç mund të jetë anëtarësimi në sindikata apo edhe implementimi i projekteve të ndonjë OJQ-je⁸.

“Sistemi zgjedhor duhet të ndryshohet dhe ai duhet të jetë me lista të hapura” (Shtime)

Entuziazmi i pasluftës i shprehur me një pjesëmarrje shumë të lartë të qytetarëve (fillimisht në zgjedhje dhe format tjera të pjesëmarrjes politike) dhe pastaj rënia serioze në pjesëmarrje menjëherë fillimit të zhvillimit të demokracisë, paraqet një skenar shumë të rrezikshëm. Sistemi i tanishëm duket se nuk mund të mbijetoj më gjatë sepse konsiderohet se ka më shumë arsye për t’iu shmangur apo luftuar atë se sa për ta përdorur atë në mënyrë konstruktive për t’iu përgjigjur nevojave të ndokujt apo për të realizuar mundësitë përmes pjesëmarrjes aktive në jetën politike⁹. Thënë shkurt, vërehet mungesë e ndjenjës së identifikimit me çështjet publike.

⁸ UNDP Kosovë. 2004. *Raporti i Zhvillimit Njerëzor i Kosovës 2004 Ngritja e Qytetarëve: Sfidat dhe Zgjidhjet - Human Development Report Kosovo 2004 The Rise of the Citizen: Challenges and Choices*, Prishtinë: UNDP Kosovë.

⁹ KIPRED *Trendët Elektorale dhe Sjelljet e Votuesve në Kosovë* (së shpejti); KIPRED, *Reformimi i Sistemit Zgjedhor në Kosovë - Electoral Trends and Voting Behavior in Kosovo* (Forthcoming); *Reforming the Elector System of Kosovo*, 2005; <http://www.kipred.net/UserFiles/File/4A%20Web.pdf> (qasur me 10 janar 2006)
KIPRED, *Reformimi i Sistemit Zgjedhor në Kosovë - Reforming the Elector System of Kosovo*, 2005;

Sistemi zgjedhor aktual nuk ia del të përfitoj besimin e qytetarëve për përzgjedhjen e përfaqësuesve në nivelin qendror dhe lokal, apo të siguroj nxitës të qëndrueshëm për llogaridhënie ndaj votuesve në rast të ardhjes në pushtet.

Përderisa përfaqësuesit e zgjedhur zgjidhen proporcionalisht, llogaridhënia e tyre ndaj atyre që i kanë zgjedhur ata mbetet, në rastin më të mirë, e kufizuar. Për më tepër, sistemi zgjedhor aktual ka efekte negative, si vështirësimin e marrëdhënieve ndërmjet përfaqësuesve dhe të përfaqësuarve, rritjen e mundësive për qeverisje të dobët, pengimin e llogaridhënies dhe dekurajimin e daljes në votime¹⁰. Çdo pritje për përgjegjësi demokratike duhet që në mënyrë thelbësore të përfshij ndryshimet në sistemin zgjedhor si hap kryesor për stimulimin e udhëheqjes me të përgjegjshme në të gjitha nivelet, udhëheqjen demokratike të partive, përfaqësimin dinjitoz të interesave të ndryshme, deputet të cilët sjellin ligjshmëri në institucione dhe një qeveri të qëndrueshme dhe përgjegjshme. Qëllimi duhet të jetë zëvendësimi i “dialogut” destruktiv në rrugë me dialogun konstruktiv në institucione¹¹.

Trendët e votimit tregojnë se vakuumi i legjitimitetit është duke u rritur. Vetëm në katër vite, numri i pjesëmarrësve në zgjedhje ka rënë nga 90% në më pak se 50%. Tani, ata që “nuk votojnë” e përbëjnë pjesën më të madhe të elektoratit krahasuar me numrin e përbashkët të votave të fituara nga tri partitë më të mëdha¹².

G) Njohja rajonale dhe ndërkombëtare e institucioneve të Kosovës

Kosova ndodhet në një situatë unike për vet faktin se ka të instaluar një administratë ndërkombëtare dhe në të njëjtën kohë është duke pritur që të zgjidhet statusi i saj. Pozicioni i të qenurit de facto protektorat ndikon në njohjen rajonale dhe ndërkombëtare.

“UNMIK-u duhet ta vëzhgoj situatën –e jo të qeveris.”
(Obiliq)

Dy qasje kontradiktore në raport me legjitimitetin ndërkombëtar dhe rajonal të IPVQ/UNMIK-ut bashkëjetojnë në mënyrë paralele.

- a) **qasja ligjore ndërkombëtare, e manifestuar përmes njohjes së sovranitetit të Unionit të Serbisë dhe Malit të Zi mbi Kosovën, edhe pse kjo e fundit që nga qershori i vitit 1999 është *de facto* është përtej çdo mundësie për tu qeverisur në ndonjë mënyrë nga e para; dhe**
- b) **qasja praktike, njohja e UNMIK/IPVQ-së si faktor të pavarur ndërkombëtar (akterë ne vete).**

¹⁰ KIPRED, *Reformimi i Sistemit Zgjedhor në Kosovë - Reforming the Electoral System of Kosovo*, 2005; <http://www.kipred.net/UserFiles/File/4A%20Web.pdf> (qasur: 10 janar 2006)

¹¹ KIPRED, *Trendët Elektorale dhe Sjelljet e Votuesve në Kosovë 2000-2004* (së shpejti) - *Voting Trends and Electoral Behavior in Kosovo 2000-2004* (Forthcoming), f.2.

¹² KIPRED, *Trendët Elektorale dhe Sjelljet e Votuesve në Kosovë 2000-2004* (së shpejti) - *Voting Trends and Electoral Behavior in Kosovo 2000-2004* (Forthcoming), f.5.

Në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar, institucionet e Kosovës (që të dyja UNMIK-u dhe IPVQ-ja) gëzojnë një njohje në rritje edhe pse të kufizuar. Akoma ka hezitime të konsiderueshme në rajon dhe përtej qoftë në qasjen ndaj autoriteteve të Kosovës apo adresimit të iniciativave që ndërmerren nga to. Shtyrjet dhe pengesat joracionale ekonomike për nënshkrimin e MTL e ilustrjnë këtë opinion ndërsa një mori tjetër e pengesave duke përfshirë edhe ato që lidhen me dokumentet e udhëtimit, targat e makinave etj në mënyrë serioze ndikojnë në jetën e përditshme tek shumica e kosovarëve.

Qeveria e Serbisë ka tendencë që ta mohoj legjitimitetin e institucioneve të Kosovës duke provuar që ti trajtoi ato thjesht si institucione që përfaqësojnë vetëm shqiptarët e Kosovës. Kjo në vetvete, nxit jo stabilitet dhe pasiguri politike në Kosovë dhe rajon.

Mungesa e njohjes politike është një faktor që vazhdon ta shoqëroj jo stabilitetin dhe pasigurinë rajonale.

H) Sundimi i ligjit¹³

Është e kuptueshme që policia e Kosovës dhe drejtësia janë institucione të brishta¹⁴. **Ka një përkrahje të gjerë publike për KFOR-in dhe SHPK-në si institucione kryesore përgjegjëse për sigurinë përkundër që sundimi i ligjit perceptohet si i dobët.**

Numri i lartë i rasteve të pazgjidhura kriminale, një grumbull serioz i rasteve që presin të merren në shqyrtim janë ato që e rrisin edhe më shumë mosbesimin në gjykata dhe në sistemin e drejtësisë në tersi¹⁵. Pothuajse gjysma e shqiptareve të Kosovës (46%) pohojnë se nuk kanë besim në sistemin e drejtësisë¹⁶.

Ajo çarë në mënyrë serioze e ka kufizuar potencialin për fuqizimin e sundimit të ligjit janë shembujt e dobët që ka krijuar administrata ndërkombëtare. Akademikët dhe praktikuesit e kanë bërë të qartë që është esenciale që të ketë kod të mirësjelljes për administratorët ndërkombëtar apo këshilltarët dhe një mekanizëm adekuat që do ti bënte ata të përgjegjshëm¹⁷. UNMIK-u për shembull, është treguar shumë i ngurtë për të pranuar

¹³ Në përgjithësi është përdorur për të përfshirë policinë efektive, gjykatat, burgjet/ që merren me shkeljet e të drejtave njerëzore dhe krimet e bëra.

¹⁴ Ambasadori Kai Eide. Situata në Kosovë, Raport për Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara - The Situation in Kosovo Report to the Secretary-General of the United Nations, Tetor. 2005. Raporti, f.5

¹⁵ "Një tjetër konkluzion i përgjithshëm i cili i ndan mes për mes të gjitha fushat e sistemit ligjor, i ndërtuar në një formë paralele nga burime të ndryshme i mungon koherenca dhe konsistenca. Ka rrezik në rritje se sistemi do të mund të fragmentizohet, kontradiktor, dhe jo gjithë përfshirës përderisa nuk ka ndonjë përpjekje për ta kodifikuar atë, dhe përderisa ekspertet e huaj nuk përfundojnë së përpiluar legjislacionin dhe të marrin kryesisht role këshilluese. Ky rrezik nuk duhet nënvlerësuar. Mos përputhshmëritë në sistemin juridik kanë tendencë që të rriten dhe kështu ato mund ta kërcënojnë sundimin e ligjit dhe administratën e drejtësisë. Ss më gjatë që lejohet të vazhdoj ky proces, aq më vështirë do të bëhet ndalja e tij sepse koha kalon." UNDP, Vlerësimi i Kapaciteteve të Administratës - Assessing Administrative Capacities, f.9

¹⁶ KosovaLive, CDRSEE dhe Medijski Centar Beta "Kosovo-Kosova, Ballafaqimi me Problemet e Kosovës: Pikëpamjet e njerëzve nga Kosova dhe Serbia" - Kosovo-Kosova, Coming to Terms with the Problem of Kosovo: The Peoples' Views from Kosovo and Serbia. 2005, f.10

¹⁷ Akademia Ndërkombëtare për Paqe, Ju, Populli: Administrata Transitore, Ndërtimi i Shtetit dhe Kombet e Bashkuara - You, the People: Transitional Administration, State-Building and the United Nations. http://www.ipacademy.org/PDF_Reports/YOU_THE_PEOPLE.pdf (qasur:12 janar 2006) f. 9.

juridiksionin e Zyrës së Ombudspersonit duke dëmtuar kështu jo vetëm imazhin e kësaj zyre por edhe përpjekjet për të ofruar një model normal për kosovarët. Situata është keqësuar edhe nga fakti se KFOR-i që përbën pjesën e prezencës ushtarake të NATO-s në Kosovë-gjithashtu është jashtë juridiksionit të Ombudspersonit.

“Institucionet e Kosovës janë të ngadalshme, joefikase dhe qytetarët e Leposaviqit nuk përfitojnë nga puna e tyre... gjykatat e UNMIK-ut janë gjithashtu joefikase” (Leposaviq)

Krijimi i institucioneve në përputhshmëri me sundimin e ligjit, padyshim se do të vazhdoj të mbetet një nga çështjet që kërkon zgjidhje. Në anën tjetër, ka shkelje të mëdha të rregullave themelore, për shembull, në fushën e të drejtave pronësore (pronësinë, posedimin, uzurpimin), konkurrencën, të drejtat pronësore të intelektualëve, mbrojtjen e mjedisit dhe çështje tjera që ndërlihdura, dhe kryerësit e këtyre shkeljeve mbesin të pandëshkuar dhe kështu rritet ndjenja e pandeshkueshmërisë¹⁸.

a) Kultura e dobët ligjore

Kultura ligjore luan një rol negativ në konsolidimin e besimit në sistemin e rregullave në fuqi. Në përgjithësi ka pak besim në sistemin ligjor, që është rezultat kryesisht i ligjeve nga periudha e regjimit komunist, dhe kështu krijohet mungesë besimi në fushën e sistemeve ligjore. Aplikimi i rregullave diskriminuese gjatë viteve 1990 dhe përdorimi i mekanizmave ligjor dhe juridik kundër shumicës së kosovarëve e ka përkeqësuar edhe më shumë besimin në sistem.

Akoma ekziston një shkallë e ulët e identifikimit të popullatës së Kosovës me rregullat, jo vetëm të atyre që aprovohen nga UNMIK-u, por një mënyrë të barabartë edhe ndaj legjislacionit të aprovuar nga IPVQ-të.

Politizimi është duke dëmtuar thellë institucionet e Kosovës. Ne duhet ta depolitizojmë drejtësinë dhe sigurinë.
(Obiliq)

Gjykuar nga legjislacioni plotësues, atëherë duhet theksuar se qeveria i kushton vëmendje të pamjaftueshme implementimit të ligjeve të aprovuara nga Kuvendi¹⁹. Tendencia për t’iu shmangur rregullave të procedurës është një tregues tjetër për vëmendjen e ulët që iu kushtohet aplikimit të ligjeve.

¹⁸ Ambasador Kai Eide. Situata në Kosovë, Raport për Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Tetor. 2005. Raporti, http://www.kosovo.com/news/archive/2005/October_08/4.html (qasur: 15 dhjetor 2005). f.5.

¹⁹ Faqja zyrtare e OSBE-së, DOCUMENTI: Implementimi i Ligjeve të Kuvendit të Kosovës, Raporti: II, http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/17515_en.pdf (qasur: 20 dhjetor 2005). f.6.

b) Ushtrimi i punës gjyqësore

Puna gjyqësore mbetet jo e kënaqshme dhe nuk vërehet se ajo mund të përmirësohet në të ardhmen e afërt.

“Unë nuk i besoj gjyqësisë, disa nga ata që punojnë aty do të duhej të ishin në burg në vend që të punojnë si gjykatës”

(Fushë Kosovë)

Gjykatat janë në masë të madh pa personel të mjaftueshëm si për gjykatës dhe prokuror. Gjithashtu ka mospërputhje serioze në aspekte të dhënies së dokumentacioneve, vendimeve gjyqësore, mos dhënien në kohe të duhur të urdhëresave qoftë për lirim apo arrestim, dhe ka mungesë të sigurisë për gjyqtarët vendor. Efikasiteti është i dobët dhe gjatësia e procedurave mbetet një problem serioz. Të gjitha këto defekte luajnë rol në minimin e besimit të qytetarëve në sundimin e rendit dhe ligjit, duke e perceptuar atë më tepër si përzgjedhës, jo të drejtë dhe pjesë e lidhjeve të ngushta familjare dhe korrektësisë politike se sa si të paanshëm dhe të vendosur në vendimmarrje.

“Derisa është faj i policisë dhe gjykatave për ekzistencën e një klime të mosndëshkimit dhe se krimi i organizuar është në rritje kjo gjithashtu ndodhë edhe për shkak të pasivitetit të popullatës (për shkak të frikës)...pjesëmarrja dhe bashkëpunimi i popullsisë [në siguri] është thelbësor” *(Pejë)*

Nëse duhet të presim përmbushjen e standardit të paanshmërisë dhe pavarësisë, anëtarët vendor të gjykatave duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë me homologët e tyre ndërkombëtar kur është në pyetje siguria²⁰.

Korrupsioni, lidhjet, mungesa e standardeve profesionale dhe edukimi joadekuat gjithashtu kanë ndikim negativ në punën e gjykatave.

c) Strukturat paralele

Strukturat paralele, duke përfshirë gjykatat dhe pjesët tjera të sistemit të qeverisë së Beogradit të cilat veprojnë në Kosovë pa ndonjë pengesë, në masë të theksuar e minojnë identifikimin e popullsisë me sundimin e ligjit por edhe besimin në sistem. Kjo vlen në rend të parë për komunitetin serb i cili mbështetet një këto struktura kur është në pyetje edhe tek qasja në shërbimet elementare. Ka pasur një zotim të vazhduar politik nga ana e administratës ndërkombëtare që çështja e strukturave paralele të zgjidhet. Megjithëkëtë, përkundër këtyre

²⁰ Faqja zyrtare e OSBE-së, DOCUMENTI: Implementimi i Ligjeve të Kuvendit të Kosovës, Raporti: II - Implementation of Kosovo Assembly Laws Report II, http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/17515_en.pdf (qasur: 20 dhjetor 2005). f.19.

përpjekjeve realiteti në terren e dëshmon të kundërtën²¹. “Mitrovica veriore dhe të tri komunat e populluara me shumicë serbe në veri kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë bastione të administratës paralele të përkrahura nga Beogradi qysh nga konsolidimi i vijës ndarëse përgjatë lumit Ibër të vendosur nga KFOR-i nën presionin e serbëve të Kosovës në verë të vitit 1999”²².

Vazhdimi i ekzistencës së strukturave paralele në përgjithësi konsiderohet si një demonstrim i pranisë serbe në Kosovë dhe gjithashtu një reflektim i mosbesimit ndërmjet dy komuniteteve më të mëdha etnike, gjë që seriozisht minon zbatimin e sundimit të ligjit në tërë territorin e Kosovës²³.

I. Arsimi

Dispozitat për nivelin e shkollimit fillor dhe atij të mesëm duket të jenë joadekuate. Ekzistenca e shkollave fillore nuk është shqetësim për shumicën e popullsisë së Kosovës. Sipas një Hulumtimi të Zhvillimit Njerëzor, rreth 60% e familjeve posedojnë shkollë fillore në më pak se 1 km larg shtëpive të tyre dhe me shumë se 95% kanë shkollë fillore në më pak se 3 km larg. Megjithatë, ekzistimi i kopshteve parashkollore dhe i shkollave të mesme është një çështje e rëndësishme pasi që në gusht të 2001 Kosova ka pasur vetëm 34 kopshte parashkollore në të cilat ishin angazhuar 402 mësues²⁴. Shumica e këtyre institucioneve kanë qenë në rajonin e Prishtinës dhe rrjedhimisht në zona urbane. Ndërsa sa i përket shkollave të mesme, në vitin 2003 vetëm 24% e familjeve kanë pasur një shkollë të mesme brenda 1 km dhe 28% kanë pasur një shollë të mesme të lokalizuar brenda 5 km apo më shumë²⁵.

“Shkollat janë të vjetra dhe keq të mirëmbajtura”
(Shtime)

Në sektorin e arsimit, shumica e raporteve shprehin shqetësimin rreth kualitetit të shkollimit i cili në masë të theksuar është rezultat i kualifikimeve jo përkatëse të mësuesve në të gjitha nivelet.

²¹ Faqja zyrtare e OSBE-së, DOCUMENTI: Implementimi i Ligjeve të Kuvendit të Kosovës, Raporti: II - Implementation of Kosovo Assembly Laws Report II,

http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/17515_en.pdf (qasur: 20 dhjetor 2005). f.8.

²² Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Kolapsi në Kosovë - International Crisis Group, Collapse in Kosovo, 22 Prill 2004.

http://www.crisisgroup.org/library/documents/europe/balkans/155_collapse_in_kosovo_revised.pdf (qasur: 15 shkurt 2006). f.12.

²³ Ambasador Kai Eide. Situata në Kosovë, Raport për Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. tetor. 2005. Raporti; http://www.kosovo.com/news/archive/2005/October_08/4.html (qasur: 15 dhjetor 2005) f.5

²⁴ Banka Botërore në Kosovë 2005. Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë: Promovimi i Mundësive, Sigurisë dhe Pjesëmarrja për të Gjithë - Kosovo Poverty Assessment: Promoting Opportunity, Security, and Participation for All, Prishtinë, Qershor 16, 2005: Banka Botërore në Kosovë, f. 69

²⁵ Hulumtim i Zhvillimit Njerëzor - Human Development Survey

Çështja kryesore lidhur me cilësinë e shkollimit në Kosovë, dhe si rjedhojë edhe ofrimi i shërbimeve edukative për popullsinë, është kualiteti i mësuesve më tepër se sa numri i mësuesve.

Raporti nxënës-mësues, që është një nga treguesit për kualitetin e shkollimit është e krahasueshme me pjesën tjetër të rajonit: 20 në shkolla fillore, dhe 19 në shkolla të mesme²⁶. Megjithatë, një pyetësor bërë në vitin 2003 ka zbuluar se 22.2% e të gjithë mësuesve kanë pasur kualifikime të niveleve jo përkatëse në shkolla fillore, dhe 28.1% në shkolla të mesme²⁷. Të tjera arsye që lidhen më kushtet vendore, siç janë ekzistenca e vogël e shkollave fillore në zona rurale etj, janë instrumentale për mbajtjen e shkollës së lartë të vijueshmërisë në edukimin fillor krahasuar me nevojat e komuniteteve etnike²⁸.

Numri total i të përfshirëve në sistemin arsimor në vitin 2000/01 ishte 308,940, që paraqet një rritje prej rreth 20,000 për çdo vit shkollor. Nga numri total i 962 shkollave fillore, 87% janë me mësim në gjuhën shqipe, 9.5% në atë serbe, dhe 3.5% në gjuhët e minoriteteve tjera.

Fëmijët e minoriteti serb vijnë në sistemin paralel të arsimit të organizuar në enklava ku mësimi bëhet akoma sipas programeve të Serbisë²⁹. Transportimi jo i sigurt dhe joadekuat dhe shqetësimet e përgjithshme për sigurinë e përcjellin edhe më tutje sistemin paralel të arsimit në shumicën e zonave serbe në Kosovë³⁰.

Për shkak të perceptimit të prindërve të serbëve të Kosovës se shkollat fillore të përziera brenda komunave të tyre, janë jo të sigurta dhe të përshtatshme për fëmijët e tyre, shkollat fillore në disa raste janë ndërtuar në prona private dhe në disa raste edhe në shtëpi private dhe tjera objekte të standardit më të ulët. Pjesa më e madhe në mos të gjitha shkollat fillore dhe të mesme që i shërbejnë popullatës serbe, përdorin planprogramet mësimore të Ministrisë serbe të arsimit dhe sportit (MSAS). MSAS i pajis këto shkolla me libra, diploma dhe vula. Stafit mësimor dhe ai mbështetës mbikëqyren nga MSAS dhe marrin paga mujore nga kjo e fundit dhe nga Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë së Kosovës (MASHT). Për më tepër, MSAS jep paga me të larta se ato që open në Serbi me arsyetimin e kushteve të jashtëzakonshme në të cilat veprojnë shkollat në Kosovë.

Për serbët të cilët refuzojnë të dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla të përziera rreziqet rriten për shkak të zgjatjes së udhëtimit që duhet bërë me qëllim të vijimit të shkollave të mesme që ndodhen brenda enklavave serbe në Kosovë. Kësaj i shtohen edhe shpenzimet financiare në ato raste kur nxënësit duhet të sigurojnë akomodim gjatë tërë javës. Që nga përfundimi i konfliktit, nuk ka pasur asnjë shenjë të tolerancës apo përpjekjes për të gjetur ndonjë mirëkuptim ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe komunitetit serb në Kosovë për konsolidimin e sistemit të edukimit në Kosovë³¹.

²⁶ Hulumtim i Zhvillimit Njerëzor - Human Development Survey, Për krahasim, shkalla nxënës-mësues në vitin 2000 ishte 40 në vendet me të ardhura të ulta; 22 në vendet me të ardhura të mesme dhe 21 në vendet me të ardhura më të larta.

²⁷ Hulumtim i Zhvillimit Njerëzor - Human Development Survey.

²⁸ Hulumtim i Zhvillimit Njerëzor - Human Development Survey.

²⁹ ZSK / UNICEF / DEST (Zyra e Statistikave të Kosovës / Fondi i Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara). Statistikat në Arsimin e Kosovës - Statistics on Education in Kosovo. 2001.

³⁰ OSCE, UNHCR, Raporti për Minoritete-Minority Report, dhjetor 2003

³¹ OSCE, Strukturat Paralele në Kosovë - Parallel structures in Kosovo, 2003

ii. Shëndeti

Dispozitat e përgjithshme për shërbimet e kujdesit shëndetësor janë joadekuate me standardet e BE-së dhe jo efikasiteti dhe korrupsioni bëjnë që shpenzimet financiare të jenë të larta të cilat pastaj në mënyrë disproporcionale godasin të varfrit. Në fund të vitit 2003, sistemi i shëndet publik në Kosovë përbëhet nga 6 spitale kryesore, 365 objekte themelore të kujdesit shëndetësor. 10 qendra të trajtimit të tuberkulozit, 5 institucioneve shëndetësore dhe 7 qendrave shëndetësore për trajtimin e të sëmurëve mental.

Rrjeti i spitaleve përbëhet përafërsisht nga 5000 shtretër pacientësh ose 2.6 shtretër për 1000 në popullatë, e cila gjithashtu është nën mesataren e BE-së, që është 4³².

Mungesa e cilësisë në shëndetësi ndikon në disa fusha vendimtare, veçanërisht përkujdesja gjatë periudhës së shtatzënisë. Në Kosovë, mossa në intervenime është problem. Qasja në përgjithësi është e kënaqshme por cilësia – e matur sipas përqindjes së vizitave që përfshijnë procedura të konsideruara si të domosdoshme për cilësi të mirë – është e dobët, për klientët e shërbimeve publike si dhe atyre private³³.

E drejta për të pasur një përkujdesje adekuate shëndetësore është çështje fundamentale për pakicat, të cilat, për një numër arsyesh, vazhdojnë të kenë probleme në qasjen e objekteve të kujdesit shëndetësor³⁴.

Një arsye shtesë për mosbesim të komunitetit serb në institucionet shëndetësore të Kosovës, të menaxhuara nga shqiptarët e Kosovës, është mungesa e personelit serb. Kjo pasqyrohet midis komuniteteve jo serbe në veriun e Kosovës ku institucionet shëndetësore janë të udhëhequra nga serbët. Perceptimet e tilla do shkaktojnë sfida domethënëse për sigurinë në rast të ndonjë epidemie apo fatkeqësie natyrore.

iii. Sociale

Shpërndarja e ndihmës sociale në Kosovë ende është shumë e kufizuar. Skema e ndihmës sociale në Kosovë, e prezantuar në 2000 dhe e korigjuar në 2003, mbetet skemë e kategorizuar, e kufizuar në para që shënjon familjet e varfra, ndërsa synon qëndrueshmërinë fiskale dhe thjeshtësinë administrative me kategori lehtë të identifikueshme.

Në vitin 2003, mesatarisht në muaj, vetëm 51,000 familje kanë marrë ndihmë sociale që në total është 32.3 milion euro, ose 7% e shpenzimeve buxhetore dhe 2.5 % të GDP³⁵.

³² Banka Botërore në Kosovë 2005. Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë: Promovimi i Mundësive, Sigurisë dhe Pjesëmarrja për të Gjithë - Kosovo Poverty Assessment: Promoting Opportunity, Security, and Participation for All, Prishtinë, 16 qershor, 2005: Banka Botërore në Kosovë

³³ Një hulumtim i kujdesit antenatal i zhvilluar nga UNICEF-i në vitin 2003 që përfshinte 382 respondentë, 66% nga zonat rurale dhe 34% nga ato urbane, 69% klientët të shërbimeve private dhe 31% të shërbimeve publike ka treguar se qasja/shfrytëzimi shihej si i kënaqshëm mirëpo kualiteti si i shërbimeve private ashtu dhe atyre publike shihej si i pak kënaqshëm.

³⁴ OSCE, UNHCR, Raporti për Minoritetet - Minority Report, dhjetor. 2003, f.41.

³⁵ Banka Botërore në Kosovë 2005. Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë: Promovimi i Mundësive, Sigurisë dhe Pjesëmarrja për të Gjithë - Kosovo Poverty Assessment: Promoting Opportunity, Security, and Participation for All, Prishtinë, 16 qershor, 2005: Banka Botërore në Kosovë.

“40 Euro nuk numërohet pension i vërtetë – 40 Euro është të luash me njerëzit ... ndihma sociale në Kosovë nuk është rrugë.” (Obiliq)

Përfitimet e ndihmës sociale, janë mesatarisht efektive, vetëm në arritjen e popullatës së varfër dhe asaj skajshmërisht të varfër. Vetëm 22 % nga popullata skajshmërisht e varfër deklarojnë të kenë marruar ndihmë sociale, dhe 16 % nga popullata e varfër.³⁶ Megjithatë, çështjet më të mëdha janë të lidhura me implementimin e dobët të skemës së ndihmës sociale. Në të njëjtën kohë, mbulesa e familjeve me të ardhura të ulëta, është ende më e ulët - vetëm 4% marrin ndihmë sociale.

Të tjerat grupe etnike (jo shqiptarët dhe jo serbët) paraqesin nivele edhe më të larta të varfërisë, dhe pjesa e ndihmës sociale që familjet e varfra dhe ato skajshmërisht të varfra përfitojnë, e tejkalon mesataren kombëtare.

Pjesa që familjet e varfra dhe ato skajshmërisht të varfra marrin nga ndihma sociale është mbi mesatare. Veçanërisht serbët duket të jenë në situatë të pafavorshme. Vetëm 5% e serbëve të varfër dhe 4% e serbëve skajshmërisht të varfër marrin ndihmë sociale.³⁷ Komunitetet e tjera janë më së paku të arsimuara, ndërsa serbët më shumë dhe shqiptarët mesatarisht që marrin një vit arsimimi më pak se serbët³⁸.

- Mungesa e përgatitjes për qeverisjen e mirë të Kosovës ka rezultuar në zbrazësi serioze të kapaciteteve.
- Qeverisja e dobët dhe politizimi i administratës publike i shkaktuar pjesërisht nga situata e tanishme politike, zvogëlon kapacitetin e qeverisë për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të popullatës dhe të adresojë çështjet e sigurisë.
- Kuvendi nuk është duke e përmbushur, në nivelin e përshtatshëm, rolin e vet legjislativ dhe të mbikëqyrjes. Kuvendi do të duhej të fuqizohet nëse do të përmbushë në mënyrë efektive rolin mbikëqyrës në kuptimin e sigurisë. Duhet të konsiderohet ndryshimi i sistemit zgjedhor në mënyrë që deputetët të jenë më të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe zgjedhësve të tyre.


³⁶ *Ibid.*

³⁷ UNDP Kosovë. 2004. *Raporti i Zhvillimit Njerëzor të Kosovës 2004: Ngritja e Qytetarëve: Sfidat dhe Zgjidhjet -Human Development Report Kosovo2004 The Rise of the Citizen: Challenges and Choices.* Prishtinë: UNDP Kosovë

³⁸ UNDP Kosovë. 2004. *Raporti i Zhvillimit Njerëzor të Kosovës 2004: Ngritja e Qytetarëve: Sfidat dhe Zgjidhjet -Human Development Report Kosovo2004 The Rise of the Citizen: Challenges and Choices.* Prishtinë: UNDP Kosovë

- Mungesa e koordinimit të qeverisë brenda dhe midis IPVQ-ve dhe UNMIK-ut rezulton në duplikim dhe dështim në përgjigjen ndaj situatave emergjente e komplekse si shqetësimet sociale ose emergjencat ambientale
- Rritja e zhgënjimit dhe mungesa e besimit në institucionet e IPVQ-së dhe UNMIK-ut do të thotë që legjitimiteti në Kosovë është një problem në rritje, kjo në vetvete paraqet një kërcënim të rëndësishëm për sigurinë. Komuniteti serb ka vazhduar të refuzojë njohjen dhe legjitimitetin e institucioneve të Kosovës. Ky trend është një nga kërcënimet më alarmuese afatgjate ndaj mundësisë për të qeverisur në mënyrë efektive Kosovën.
- Puna e pakënaqshme e gjyqeve dhe sistemi penal jo adekuat janë duke dobësuar sundimin e ligjit dhe mundësinë që policia të funksionojë. Vazhdimi i ekzistimit të strukturave paralele të drejtësisë rifuqizon edhe më tej mungesën e respektit në organet e drejtësisë. Ekziston një identifikim i vogël nga ana e qytetareve të Kosovës me kornizën ligjore ekzistuese.
- Zyra e Ombudsperson-it është duke u ballafaquar me mungesën e kredibilitetit dhe vendimi i fundit i UNMIK-ut që institucionet ndërkombëtare nuk janë më subjekt i shqyrtimit, nuk i ka ndihmuar fare.
- Shërbimi i Mirëqenies Sociale është funksion thelbësor i shtetit, dhe mos efikasiteti në shërbime dhe furnizim ka zvogëluar besimin e njerëzve në institucionet shtetërore. Njëanshmëria në disa nivele, duke përfshirë këtu edhe partitë politike dhe ndikimet etnike, mbi atë se kush do të përfitojë, e ka rënduar edhe më tej situatën.
- Mungesa e sigurisë politike është një faktor i përhershëm i pasigurisë dhe jo stabilitetin rajonal.

Në synim të efektshmërisë; përqindja e të varfërve, të varfërve të skajshëm dhe atyre që nuk janë të varfër por që pranojnë ndihma sociale (shprehur në përqindje sipas amvisërive)



Burimi: HBS 2002/2003

2. SIGURIA SOCIALE

1. (DIS) PROPORCIONI I SHTIMIT TË POPULLSISË DHE RITJES EKONOMIKE

Sot, në Kosovë edhe statistikat themelore si numri i popullatës janë tema për t'u debatuar³⁹. Regjistrimi i fundit i popullatës është bërë në vitin 1981. Lëvizjet masive të popullatës në të 90-at deri gjatë konfliktit dhe pas kanë ndryshuar të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm dhe janë pothuajse të papërdorshme. Kjo ka sjellë deri te mungesa e të dhënave të nevojshme për bërësit e politikave. Tani në Kosovë, sipas vlerësimeve, numri i popullatës është rreth 1.9 milion⁴⁰. Kjo është shifra për të cilën shumica e organizatave të specializuara në drejtimin e sondazheve të opinionit publik janë pajtuar që të përdoret në përpilimin e mostrave të anketimit.

Në vitin 2000 në Kosovë është vlerësuar se shkalla e lindjes është 19 në 1000 banorë, më e larta në Evropë, me mbi 50% të popullatës deri në moshën 25 vjeç.

Kosova pa dyshim ka ekonominë më të varfër në Evropë, me ta ardhurat e llogaritura për capita €964 për vit, dhe e shumta e kësaj nuk mund të qëndrojë për arsye të dërgimit të parave nga diaspora dhe shpenzimeve të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Shkalla e rritjes ekonomike në Kosovë ka lëvizur nga 1.2% (2002), 3.1% (2003). Në anën tjetër, bilanci i buxhetit të qeverisë është zvogëluar prej 6.2% (2002), to 2.5% (2003) dhe -3.8% (2004).

Rritja e ekonomisë nuk i përmbush kërkesat e popullatës dhe të shtimit të saj.

Për më tepër, krahasuar me rajonet tjera, Kosova ka shkallën më të lartë të papunësisë (të regjistruar dhe të paregjistruar) dhe nivelin më të ultë të arsimimit nga të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë⁴¹.

Rritja e ngadalshme e ekonomisë, së bashku me fuqinë punëtore jo të kualifikuar dhe ritjen demografike e cila është mbi potencialin ekonomik, paraqesin një kërcënim të sigurisë. Me këtë pikënisje është vështirë të vërehet se sa mundet ekonomia e Kosovës të integrohet në atë rajonale dhe Evropiane.

³⁹ Raporti i Zhvillimit Njerëzor të Kosovës 2002 - Kosovo Human Development Report 2002, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi - United Nations Population Fund (UNFPA)/Organizata Ndërkombëtare për Migrim - International Organization for Migration (IOM) vlerëson një numër prej pp 104, 1,614,548 deri 1,919,948, ndërsa Banka Botrore -World Bank vlerëson një numër prej 1,778,377 deri 1,958,034.

⁴⁰ www.sok-Kosovo.org

⁴¹ Banka Botërore -World Bank, KOSOVË-Fondi për Zhvillimin e Komunitetit - Community Development Fund II Project. (Project Information Document). Prishtinë, tetor 2003.

2) NIVELI I ARSIMIT (ANALFABETIZMI)

Sipas të dhënave, gjysma e popullatës është nën moshën 25 vjeç⁴², andaj arsimimi është një aspekt mjaft i veçantë i shoqërisë.

Indikatorët e arsimimit⁴³ matin nivelin e resurseve që u nevojiten niveleve të ndryshme të arsimimit dhe shkallën e cila paraqet nivelin e pranueshëm për vijueshmërinë në arsimim përgjatë grupeve të popullsisë.

Trendët e përgjithshme tregojnë shenja përmirësimi sa i përket regjistrimit në shkolla fillore, të mesme dhe shkrim leximit. Viteve të fundit në Kosovë, në përgjithësi, shkalla e regjistrimit është përmirësuar, sidomos në shkollat e mesme. Përjashtim bën vetëm edukimi terciar ku ka disa dëshmi për zbritje në shkallën e regjistrimit⁴⁴.

Fuqia punëtore e arsimuar është kyçe për sistemin fitimprurës dhe njohjen e ekonomisë. Megjithatë, numri i madh i popullsisë së re e cila është më pak e arsimuar se bashkëmoshatarët e tyre në rajon, e papunësuar dhe e pakënaqur, mund të shndërrohet në kërcënim.

Shkalla e regjistrimit në arsimin e lartë ⁴⁵ .		
Viti shkollor	Numri i studentëve	Regjistrimi në arsimin universitar (%)
1970/1971	10.368	15.2
1980/1981	43.321	20.6
1990/1991	29.016	10.9
1995/1996	21.632	11.6
2000/2001	20.277	7.5
2002/2003	23.175	5.0

Sistemi i arsimimit ishte mirë i themeluar, por ngjarjet e dekadës së fundit kanë zvogëluar vlerat dhe kualitetin e shkollave. Arritja arsimore gjithashtu dallon edhe për nga përkatësia gjinore, gratë qëndrojnë më keq në këtë aspekt dhe janë më pak të përfaqësuara në arsimim dhe shkrim lexim. Shkollimi fillor në Kosovë trajtohet si e drejtë universale për secilin fëmijë. Sipas ligjit, arsimimi fillor nga 6 vjeç deri në 15 është i detyrueshëm dhe mos vijimi rezulton

⁴² Popullsia e Kosovës është njëra ndër më të rejtat në Evropë me 52% të banorëve nën moshën 25 vjeçe ndërsa 30% nën 15 vjeç sipas kalkulimeve të Hulumtimit të Zhvillimit Njerëzor 2004.

⁴³ Indeksi i Arsimit i përbërë nga shkalla e të rriturve të arsimuar dhe shkalla e vijueshmërisë në shkolla fillore dhe të mesme është nxjerr me qëllim të përpilimit të Raportit të Zhvillimit Njerëzor për Kosovën 2004- Human Development Report for Kosovo 2004.

⁴⁴ Për shembull, Universiteti i Prishtinës ka shënuar një rënie në vijueshmërinë e studentëve të moshës 18 deri 24 vjeç në vitin 2003. ZSK " Statistika Sociale: Arsimimi i Lartë në Kosovë 2003" - SOK, "Social Statistics: Higher Education in Kosovo 2003" prill 2004.

⁴⁵ Burimi: të dhënat nga 1970 deri 2001 janë marrë nga KEC, "Disa Aspekte të Efektshmërisë në Arsimin e Kosovës - Some Aspects of Efficiency of Kosovo Education," 2002 të dhënat nga 2002/2003 janë nga ZSK-SOK, " Arsimimi i Lartë në Kosovë - Social Statistics: Higher Education in Kosovo," 2003

në pasoja për prindërit. Në vitin shkollor 2000/2001, shkollimi i detyrueshëm është zgatur prej klasës së 8 deri në të 9-të. Kjo e ka sjellë sistemin arsimor të Kosovës në pëlqim me sistemin e shumicës së shteteve të BE-së, të cilat përbëhen nga 5 vjet të shkollë fillore, 4 vjet të ciklit të ulët, dhe 3 vjet ciklin e lartë të shkollimit sekondar.

Në shkollat fillore publike në Kosovë, klasat realizohen në 5 gjuhë: shqip, serbisht, boshnjakisht, turqisht dhe kroatisht. Prej 962 shkollave fillore, 87% mësojnë në gjuhën shqipe, 9.5% në gjuhën serbe, dhe 3.5% në gjuhë tjera. Fëmijët e minoritetit serb vijojnë mësimin në sistemin arsimor paralel të organizuar në enklava sipas plan-programeve serbe.⁴⁶ Shkalla e braktisjes së shkollimit nga nxënësit prej klasës së 1 – 5 është minimale. Sipas një studimi të vitit 2002, 73% e fëmijëve që regjistrohen në klasën e 1-rë vazhdojnë me sukses deri në klasën e 8-të⁴⁷.

Sipas të dhënave zyrtare, vijimi i shkollimit në vitin 2001 ishte gati universal, me 97% të fëmijëve të regjistruar në moshë në shkollimin e detyrueshëm. Megjithatë është vështirë të gjykohet për shkallën e regjistrimit në të kaluarën e afërt. Midis viteve 1992 dhe 1999 kanë ekzistuar dy sisteme arsimimi, një (zyrtare) për fëmijët serbë të Kosovës, dhe tjetri (jo zyrtare ose paralele) për fëmijët shqiptarë të Kosovës, prandaj nuk ka të dhëna statistikore për të vlerësuar progresin e shifrave të regjistrimit gjatë kësaj periudhe.

Në Kosovë, ekziston një dallim i madh midis përgatitjes arsimore të njerëzve. Mesatarisht, një Kosovar ka 10 vjet arsimim, por popullata rurale ka ngecur prapa asaj urbane, gratë kanë ngecur prapa burrave dhe minoritetet tjera jo serbe janë prapa shqiptarëve dhe serbëve.

Në vitin 2000, niveli i analfabetizmit të popullatës në Kosovë ka qenë 6.5, e që ishte njëra nga nivelet më të larta në Evropë. Në vitin 2004⁴⁸ të dhënat zbulojnë se shkrimi leximi i të rriturve në Kosovë është 94.2%, i cili është përafërsisht 1% më i lartë se ajo e raportuar në vitin 2002⁴⁹.

Kjo tregon një ndikim pozitiv të organizatave vendore dhe ndërkombëtare, veçanërisht në raport me kurset për shkrim lexim për më të moshuarit dhe gratë.

Gati 14% e grave që jetojnë në zonat rurale janë përcaktuar si analfabete, përderisa përqindja e burrave analfabet është 4 %⁵⁰.

⁴⁶ AGJENCITË E KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË, mars 2004. *Ku do të jemi ne në vitin 2015? Raporti i Bazave të Zhvillimit të Qellimeve për Kosovën në Milenium* - UNITED NATIONS AGENCIES IN KOSOVO March 2004. *Where Will We Be in 2015? Millennium Development Goals Baseline Report for Kosovo* March 2004: UNITED NATIONS AGENCIES IN KOSOVO

⁴⁷ AGJENCITË E KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË, mars 2004. *Ku do të jemi ne në vitin 2015? Raporti i Bazave të Zhvillimit të Qellimeve për Kosovën në Milenium* - UNITED NATIONS AGENCIES IN KOSOVO March 2004. *Where Will We Be in 2015? Millennium Development Goals Baseline Report for Kosovo* March 2004: UNITED NATIONS AGENCIES IN KOSOVO

⁴⁸ UNDP Kosovë. 2004. *Zhillimi i Raportit Njerëzor në Kosovë* - Human Development Report Kosovo2004 *The Rise of the Citizen: Challenges and Choices*. Prishtina: UNDP Kosovo

⁴⁹ UNDP Kosovë. 2004. *Zhillimi i Raportit Njerëzor në Kosovë* - Human Development Report Kosovo2004 *The Rise of the Citizen: Challenges and Choices*. Prishtina: UNDP Kosovo

⁵⁰ ZSK-SOK / UNICEF / DEST (Zyra e Statistikave të Kosovës -Statistical Office of Kosovo / United Nations Children's Fund). *Statistikat e Arsimit në Kosovë* - Statistics on Education in Kosovo. 2001.

Brengë janë fëmijët romë të moshës shkollore, ku sipas të dhënave nga Zveçani, Leposaviqi, dhe Mitrovica (zona të banuara me serbë) në vitin 2002 shkalla e analfabetizmit ishte mbi 85%⁵¹.

Përveç shkallës së pjesëmarrjes, gjithashtu do duhej të matej edhe cilësia e arsimit. Kualifikimet e personelit mësimdhënës të nivelit fillor janë brengosëse. Sipas disa studimeve, shumë mësues nuk janë me kualifikim të duhur për punën e tyre. Po ashtu, ka mungesë të librave shkollore dhe materialeve e pajisjeve tjera mësimore. Megjithatë, sistemi i arsimit është duke u reformuar, përfshirë këtu adoptimin e ligjit e ri për arsimin fillor dhe të mesëm, në pëlqim me standardet Evropiane, si dhe një program të ri trajnimit për mësuesit.

Ekziston një mungesë serioze e informatave të publikuara për sistemin e arsimit në Kosovë si dhe për mënyrën se si po përparon ai.

Për shqiptarët e Kosovës, standardet e edukimit në Kosovë radhiten në rendin e pestë në listën e prioriteteve dhe 70% të respondentëve e vejnë në listë si shumë të rëndësishëm⁵². Dikush mund të mendojë se kësaj çështjeje nuk është duke iu kushtuar vëmendje e mjaftueshme sa i përket përmirësimit të cilësisë së arsimit. Kjo nënkupton mungesë të stimulimit nga ana e politikanëve për të investuar në ato fusha ku rrallë mund të kenë sukses.

3) EMIGRIMI I PAKONTROLLUAR

Kosova ka kaluar nëpër dy valë të emigrimit. **Me fillimin e shpërbërjes së Jugosllavisë, përgjatë viteve '90, përafërsisht gjysmë milioni shqiptarë të Kosovës kanë lëshuar Kosovën. Përfundimi i luftës në 1999 gjithashtu ka shënuar disa ndryshime tjera në strukturën etnike të Kosovës. Ekzistojnë të dhëna kundërthënëse, duke vlerësuar nga 60, 000 – 250, 000 Serbë kanë lëshuar Kosovën, përderisa gjithashtu kanë ndodhur edhe zhvendosjet brenda Kosovës. Përveç në pjesën veriore të Mitrovicës, serbët kanë braktisur shumicën e zonave urbane. Shumica e serbëve nga pjesët rurale nuk kanë përjetuar lëvizje të dhunshme. Kjo ka ndryshuar shumë demografinë etnike të qendrave urbane në Kosovë në dëm të serbëve të Kosovës.**

Në anën tjetër, shumë pak nga të zhvendosurit janë kthyer, 11,411 prej vitit 2000 deri në 2004. Arsyet e mos kthimit janë si pasojë e shumë faktorëve, si për shembull, çështjet e pagjdhura të pronës, sundimi i ligjit, sigurisë dhe mungesa e mundësive ekonomike. Kosovarët me përkatësi etnike serbe, theksojnë se problemi kryesor është mungesa e punësimit si dhe mungesa e sigurisë personale dhe publike, varfëria dhe relacionet ndër-etnike.⁵³ Për shqiptarët çështja më rëndësishme është punësimi, pasiguritë lidhur me statusin e Kosovës dhe varfëria⁵⁴.

“Komunitetet e përziera janë shumë jo stabile, është më mirë të lëvizim së bashku

⁵¹ UNICEF (Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara - United Nations Children's Fund), Promovimi i Kujdesit Efektiv Perinatal në Kosovë, Raport Vlerësues - Promoting Effective Perinatal Care in Kosovo. Evaluation Report 2002. 2003

⁵² “KosovaLive, CDRSEE and Medijski Centar Beta “Kosovo-Kosova, Ballafaqimi me Problemet e Kosovës: Pikëpamjet e Njerëzve nga Kosova dhe Serbia - Coming to Terms With the Problem of Kosovo: The Peoples' Views from Kosovo and Serbia”. 2005, f.36

⁵³ Raporti i Paralajmërimit të Hershëm -RPH #11, korrik - shtator 2005, f.35.

⁵⁴ Raporti i Paralajmërimit të Hershëm -RPH #11, korrik - shtator 2005, f.35

4) VARFËRIA DHE SHËNDETI I DOBËT

Varfëria është një nga çështjet më të vështira me të cilën po ballafaqohet Kosova sot. Aktualisht, Kosova ka ekonominë më të varfër në Evropë, me të ardhurat për kokë banori €964 për vit.⁵⁵

Për Kosovën

Popullata: është vlerësuar se është rreth 2 milion

GDP për capita: €964 për vit

Popullata është nën vijën e varfërisë (nën €1.42 për një të rritur ekuivalent për një ditë): 37%

Popullata në varfëri ekstreme (nën €0.93 për të rritur ekuivalent për ditë): 15%

Burimi: Banka Botërore në Kosovë 2005. Vlerësimi i Varfërisë së Kosovës: Promovimi i Mundësive, Sigurisë dhe Pjesëmarrjes për të Gjithë - Kosovo Poverty Assessment: Promoting Opportunity, Security, and Participation for All, Prishtinë, qershor 16, 2005: Banka Botërore në Kosovë

Konkluzioni i përgjithshëm është se në Kosovë varfëria është gjithëpërfshirëse por jo varfëri e thellë.⁵⁶ Në vitin 2001, rreth 12% të njerëzve jetojnë në varfëri ekstreme.⁵⁷ Në Kosovë, vija ekstreme e varfërisë është llogaritur të jetë rreth 0.85 për person për ditë. Matja tjetër është vija e varfërisë complete, e definuar si mundësi për nevojat e familjes të konsumojë edhe mallra tjera, 1.60 dollar për person për një ditë. Rreth 50% të popullatës së Kosovës jeton nën vijën e varfërisë.⁵⁸

Përqindja e njerëzve të cilët kanë vuajtur nga uria në Kosovë në vitin 2001 është rreth 12%. Sipas studimeve të Bankës Botërore të vitit 2001, ky grup i njerëzve është shumë i veçantë. Zakonisht, këto janë familje të etnisë shqiptar që kanë rreth 7 anëtar dhe kanë një varshmëri të lartë të proporcionit për shkak të fëmijëve. Gjatë konflikti së paku njëherë kanë qenë të zhvendosur.

Fëmijët, të moshuarit, gratë kryefamiljare, personat me aftësi të kufizuar, të papunët, ata që kanë një punë me rrezik, banorët e qyteteve të vogla, dhe minoritetet jo serbe (romët dhe boshnjakët) janë grupet të cilat janë më të rrezikuara në kuptimin e varfërisë.

⁵⁵ Banka Botërore në Kosovë 2005. Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë: Promovimi i Mundësive, Sigurisë dhe Pjesëmarrja për të Gjithë - World Bank Kosovo 2005. Kosovo Poverty Assessment: Promoting Opportunity, Security, and Participation for All, Prishtinë, qershor 16, 2005:

⁵⁶ Banka Botërore në Kosovë 2005. Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë; dhjetor 2001

⁵⁷ Përcaktuar nga Banka Botërore se njerëz të cilët nuk mund t'ia dalin të sigurojnë shpenzimet që kërkohen për të blerë shportën minimale ushqimore e cila përmban 2,100 kalori për një person të rritur.

⁵⁸ Banka Botërore në Kosovë 2005. Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë; dhjetor 2001

Kur është fjala te varfëria, Kosova nuk krahasohet me rajonet e tjera. Me 12% të popullatës nën vijën ekstreme të varfërisë, Kosova është më afër Armenisë dhe Turkmenistanit sesa me rajonet më të afërta (shifrat radhiten nga 2% deri në 5%)⁵⁹.

5) (JO) INTEGRIMI SOCIAL

Një nga problemet që lidhet ngushtë me integrimin social në Kosovës është besimi në strukturat paralele, në veçanti për ofrimin e shërbimeve administrative dhe të sigurisë. Sa i përket institucioneve ligjore kosovare dhe ndërkombëtare, popullata serbe nuk ka besim të mjaftueshëm në to.

Pothuajse në të gjitha anketat e bëra me serbët e Kosovës, çështja e sigurisë duket të jetë dominuese. Siguria është brenga kryesore e popullatës serbe, e treguar kjo sipas anketës së Policisë, RPH, anketës për korrupsion si dhe raportet tjera relevante si ajo nga Banka Botërore. Pasiguria dhe perceptimi për të, zakonisht është i artikuluar nëpërmes lëvizjes së kufizuar apo pamundësisë që të lëvizet lirshëm brenda Kosovës, mungesa e sigurisë personale dhe në përgjithësi mungesa e sundimit të ligjit. Megjithatë, gjendja ndryshon kur kemi të bëjmë me minoritetet tjera etnike jo serbe për të cilat mund të thuhet që deri diku janë të integruara në shoqërinë kosovare.

Siç është cekur edhe më lartë, popullata serbe e Kosovës do që t'i edukojë fëmijët serb vetëm në shkollat serbe të cilat pavarësisht nga rreziku përgjatë udhëtimit për në shkollë. Ky trend veç mund të zmadhojë ndjenjën e ndarjes dhe mos përfshirjes që komuniteti ndërkombëtar është orvatur shumë për të tejkaluar.

Për shkak të perceptimit të prindërve serb të Kosovës që shkollat fillore të përziera, edhe pse brenda komunave të tyre, janë të pasigurta dhe të papërshtatshme për fëmijët e tyre, shkollat fillore nganjëherë funksionojnë në objekte private, si shtëpi private dhe objekte të tjera të rëndomta. Shumica, nëse jo të gjitha shkollat fillore dhe të mesme ku nxënësit serbë vijojnë mësimin, përdorin planprogramet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të Serbisë (MASS). MASS i furnizon këto shkolla me libra shkollor, diploma dhe vula. Mësuesit dhe stafi ndihmës janë të mbikëqyrur nga MASS dhe marrin rrogat nga kjo e fundit si dhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë (MASHT). Madje, MASS u jep rroga më të larta se në Serbi me arsyetimin e rrethanave të jashtëzakonshme në të cilat ata veprojnë.

Me fjalë tjera përderisa mësuesit shqiptarë marrin maksimum 200 euro në muaj, një mësues serb i Kosovës që punon për MASS dhe MASHT mund të fitoj deri 500 euro në muaj. Mësuesit serb marrin më pak të ardhura për kokë të banorit se sa shqiptarët⁶⁰. Pavarësisht nga fakti që ata marrin më shumë, ende ekziston perceptimi për mungesë të trajtimit dinjitoz dhe të barabartë ndaj tyre. Kjo ndodhë, kryesisht, për shkak se serbët kanë

⁵⁹ Banka Botërore, Fondi për Zhvillimin e Komuniteteve në Kosovë, Projekti II - World Bank, KOSOVO-Community Development Fund II Project. (Project Information Document). Prishtinë, tetor 2003

⁶⁰ Faqja zyrtare e KIPRED-it, Qeveria Lokale dhe Administrata në Kosovë - Local Government and Administration in Kosovo, <http://www.kipred.net/UserFiles/File/Libri%201%20ËEB%20RGB%2072.pdf> (qasur: 23 dhjetor 2005). f.16

më shumë staf të punësuar meqë kanë refuzuar të përjashtojnë njerëzit, kështu që i kanë shpërndarë fondet për “rroga dhe paga” me numër të tyre, e që është shumë më i lartë se që kanë komunat tjera me madhësi të njëjtë. Si rezultat, paratë u janë shpërndarë më shumë njerëzve, kështu ata paguhen më pak në baza personale.

Përfundimet kryesore për Sigurinë Sociale

- Shpërputhja midis trendëve demografike dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë, përbën kërcënim struktural të sigurisë në kuptimin afatgjatë në Kosovë. Shërbimet jo-adekuate të arsimit dhe shëndetësisë, të shtetit, nuk mund t'i adresojnë në mënyre efektive nevojat e popullatës në rritje në Kosovë dhe pa ndonjë zhvillim të rëndësishëm shoqëror dhe ekonomik ato do të përkeqësohen edhe më tej. Një numër i madh i popullatës së re, e zhgënjyer dhe e jo mirë e arsimuar, do të jetë një nxitje kryesore për trazira kriminale dhe sociale.
- Rritja e analfabetizmit në Kosovë, veçanërisht midis grave rurale, është barrierë për zhvillimin afatgjatë social dhe ekonomike, punësim e si pasojë edhe sigurisë.
- Arsimimi mbet një çështje për tu brengosur përderisa vazhdon të fuqizojë ndarjet nëpërmes vazhdimësisë së ndarjes të komuniteteve, fizikisht dhe nëpërmes planprogrameve që mësohen në shkollat shqip dhe serbisht. Për më tepër, përderisa komunitetet vazhdojnë të frikësohen për t'i dërguar fëmijët në shkollat e njëjta, ata mbesin indikatorët kryesor të tensioneve në relacionet ndër etnike.
- Në Kosovë, varfëria ekstreme do të mbes për një kohë të gjatë gjenerator i trazirave sociale dhe kriminale meqë njerëzit ose e shfryjnë mllëfin kundër shtetit dhe shoqërisë ose e adoptojnë kriminalitetin si strategji mbijetese.
- Kosova mbetet një shoqëri e ndarë me një ndërveprim të vogël në mes të shumicës shqiptare dhe minoritetit serb. Kjo ndarje, një pjesë e madhe është për shkak të trashëgimisë nga e kaluara dhe ndjenjave aktuale të pasigurisë që serbët kanë në Kosovë dhe në këtë mënyrë, mungesa e sigurisë rezulton në rrethin vicioz që ka për pasojë rritjen e pasigurisë nga të krijuar nga komunitetet e ndara.

3. SIGURIA EKONOMIKE

Ndonëse një përparim i konsiderueshëm i zhvillimit ekonomik është bërë në Kosovë gjatë gjashtë viteve të fundit, ende shumë mbetet për tu bërë. Bazuar në vlerësimet e pavarura dhe ndërkombëtare, Kosova është ekonomikisht e qëndrueshme bazuar në resurset e saja natyrore.⁶¹ Prapë se prapë situata është e një nder ekonomive më të varfra në Evropë.

Ekonomia e Kosovës aktualisht llogarite për afërsisht 90% deficit të logorise rrjedhëse. Në njëmbëdhjeta muajt e kaluar, bilanci tregtare i Kosovës ka qene minus € 1,028 miliard. Kjo ka qene si rezultat e marrëdhënies tregtare me botën e cila qëndron në nivel të € 1,113 miliardë, prej të cilave € 42.5 milion janë eksporte ndërsa të tjerat janë importe, e cila ka rezultuar në deficit të lartë të llogarisë rrjedhëse. Ky deficit si kompensim financohet nga parat e dërguara nga diaspora, si dhe direkt dhe indirekt nga harxhimet e komunitetit ndërkombëtare.

1. STABILITETI FISKAL DHE MONETAR

Kosova ka realizuar arritje substanciale në politikat fiskale dhe monetare duke regjistruar stabilitet buxhetor dhe inflacion të ulët.

Kjo arritje e shquar është bere kryesisht për dy arsye: (1) rritja e të hyrave dhe zgjerim i ulët i harxhimeve; dhe (2) përdorimi i Euros që ka imponuar disipline monetare.

Tendencat fiskale në Kosovë karakterizohen me një rritje graduale në të hyra. Që nga fillimi në 1999 buxheti i Kosovës ka treguar rritje të qëndrueshme në të hyra. Kjo tendence si kundërpërgjigje ka shpjer në bilanc pozitivë buxhetor në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BBK) deri në vitin buxhetor të 2004. Teprica me e madhe buxhetore e regjistruar në Kosovë ishte në vitin 2003 me mbi 2.5% të PBV-së⁶² e cila ishte kryesisht për shkak të rritjes pese shifrore të të hyrave nga taksat dhe zotimeve financiare të ulëta të këtyre të hyrave, përveç në sistemin e rrogave dhe harxhimeve kapitale, në ekonominë e Kosovës.

Bazuar në këtë, politikat fiskale në Kosovë kanë treguar një rritje në zbatimin e sistemit të taksimit, por nuk kanë treguar shenja të përdorimit të këtyre të hyrave për stimulim të ekonomisë në përgjithësi.

Ky trend u ndryshua me buxhetin e viteve 2005 dhe 2006. Në vitin 2005, sipas të dhënave paraprake të FMN-së, BKK do të llogarisë në afërsisht 143 milion euro deficit, kurse në vitin 2006 do të llogarisë 181 milion euro. Qeveria është shumë optimiste duke parashikuar të

⁶¹ Sipas Marti Ahtisarit, "Aliu, Fatmir. 2005. Qymyri i Kosoves, sipas Ahtisaarit, Faktor Percaktues i Statusit të Kosoves, *Koha Ditore*, 22 dhjetor. 2005.

⁶² Moalla-Fetini, R., Hatanpaa, H., Hussain, Sh., and Koliadina, N. në: Kosovo: "Gearing Policies Toward Growth and Development". International Monetary Fund, <http://www.imf.org/external/pubs/ft/kosovo/2005/gpgd.pdf> (qasur: 10 dhjetor 2005).f. 17.

hyra sikurse në vitet e pas-luftës, përderisa është me pak kursimtare kur janë në pyetje shpenzimet⁶³.

Ne kornizën buxhetore afatmesme MEF-i ka vendosur bazat për një buxhet më të mirë dhe më të qëndrueshëm. Një element shumë i rëndësishëm ne sektorin e deficitit buxhetor është përmirësimi në menaxhimin e politikave fiskale. MEF ka lëvizur nga buxheti tradicional (i mbështetur ne harxhimet e zotuara që parasheh vazhdimësi të harxhimeve të zotuara në vitin pasues buxhetor), në buxhet me para të gatshme duke i ulur parashikimet deficitare për vitet e projektuara ne “Kornizën Afatmesme Buxhetore (2006-2008)”. Bazuar në këtë lëvizje “Strategjia Buxhetore 2006-2008” ka ulur deficitin e projektuar për 2006. Kjo lëvizje i lejon Qeverisë të ketë një buxhet më të qëndrueshëm.

Stabiliteti fiskal si dhe ai monetar mund të jenë uvertyrë për vënie në lëvizje të politikave për rritje dhe zvogëlim te varfërisë, por ato nuk janë zëvendësim për vetë politikat e tilla.

Përdorimi i euros në Kosovë ka pasur një ndikim të madh në stabilitetin monetar dhe disiplinën financiare në Kosovë. Në vitet e para pas vënies në përdorim të euros inflacioni ka qene dyshifror⁶⁴, për shkak të ndihmave të shumta ndërkombëtare dhe të hyrave private. Ky inflacion pësoi rënie në vitin 2002 dhe më pas. Tani Kosova llogaritet në inflacion më të ulët se mesatarja e euro-zonës. Futja në qarkullim e euros gjithashtu ka sjellë stabilitet monetar për faktin se as BPK (e cila luan rolin e agjentit fiskal) dhe as ekonomia e Kosovës në përgjithësi, nuk ballafaqohen me rreziqe të shkëmbimit valutor.

Sa i përket shkallës së inflacionit Kosova, siç u theksua me lartë, ka pasur inflacion dyshifror menjëher pas luftës. Ky trend i inflacionit është ulur me ‘euroizimin’ e ekonomisë se Kosovës dhe miratimin e një kornize monetare stabile te ankoruar ne përdorimin e Euros e cila ka qene thelbësore ne mbajtjen e stabilitetit monetar dhe ka luajtur një rol parësor ne mirëmbajtjen e shkalles se inflacionit me ulet se mesatarja e euro-Zonës.

Gjithashtu, Kosova e ka trefishuar mbledhjen e taksave në kufij që nga fillimi i mbledhjes së taksave. Mbledhja e lartë tregon punën shembullore në këtë plan, por ne te njëjtën kohë tregon çekuilibr të lartë tregtar. Një rritje e tillë në mbledhje të taksave duket të jetë, se paku pjesërisht, e shtyrë nga tendencat për të mbledhur taksat aty ku është me së lehti, domethënë në kufij në vend brenda Kosovës.

Megjithëse taksat doganore më 2004 kanë rënë në 70% të gjithë buxhetit dhe Qeveria parasheh ulje të mëtotjeshme⁶⁵ në vitin 2005, mbështetja në taksat doganore vazhdon të jetë shume e lartë për çfarëdo zhvillimi të qëndrueshëm. Arsyet e lartpërmendura për stabilitetin fiskal dhe monetarë në Kosovë kanë vendosur themelet për politika ekonomike të qëndrueshme.

⁶³ Kujtimet e Aides -Aide Memoire, të Stafit të FMN Misioni në Kosovë, Gusht 14-25, 2005, <http://www.imf.org/external/pubind.htm> (qasur: 20 Dhjetor, 2005) f. 2-3.

⁶⁴ Burim nga faqja Zyrtare e ABP-se, <http://www.bpk-kos.org/English/Press%20Release.htm> (qasur: 8 janar, 2006).

⁶⁵ Burim nga faqja Zyrtare: Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Korniza Afatmesme e Buxhetit, Strategjia e Buxhetit- Budget Strategy, <http://www.mfe-ks.org/English/index.html> (qasur: 18 dhjetor, 2005). f. 6.

2. POLITIKAT MAKROEKONOMIKE

Kosova ka trashëguar ekonomi të shkatërruar e cila sapo ka lënë prapa periudhën e politikave ekonomike të dobta ose e mungesës së tyre të plotë dhe të shkatërtimeve nga lufta. Që nga viti 1999 është shënuar një lëvizje drejt politikave më liberale të tregut. Politikat makro-ekonomike të Kosovës duhet të shikohen në pikëpamje të faktit që makro-ekonomia paraqet nivelet e investimeve, prodhimit, eksportit dhe punësimit.

Në një studim të bërë nga Indeksi i Kushteve të Biznesit (Business Conditions Index) Kosova është radhitur si vendi më i favorshëm për investime në Evropën Jug-lindore⁶⁶. Megjithatë ky qëndrim optimist bëhet me pak tërheqës me shikimin e gjendjes në terren. Ritmi i investimeve në Kosovë gjatë periudhës së gjashtë viteve të fundit ka qenë shumë i ulët në krahasim me standardet rajonale ose ndërkombëtare⁶⁷. Sipas FMN-së, investimet në Kosovë në vitin 2004 kanë pësuar një rritje prej 0.5% në krahasim me 22.3% në vitin 2003⁶⁸. Ky trend i investimeve të ulta ka rrjedhur si pasojë e shumë elementeve të cilat, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, i kanë penguar investimet, qofshin ato nacionale apo edhe Investimet e Huaja Direkte (IHD). Nga këto, elementi me më rendësi i investimeve të ulta është krijuar nga moszgjidhja e statusit final të Kosovës, faktor ky që vlenë për IHD. Ndërsa në anën tjetër, sipërmarrësit nacional nuk posedojnë kapacitete të mjaftueshme për investime më të larta.

Zhvillimi në Kosovë mbetet shumë i varur nga ndihma e donatorëve. Megjithatë, ndihma e donatoreve të jashtëm është në rënie, mirëpo prapëseprapë ajo ka kontribuar në 23% të PBV-së në vitin 2004, në krahasim me 36% në vitin 2002 dhe 28% në vitin 2003⁶⁹.

Derisa vlerësimi i të dhënave të PBV-së ndryshon në mënyre përmbajtësore ga institucioni në institucion rritja e PBV-së në Kosovën e pas-uftës ka qenë mëse minimale sipas ABPK-së⁷⁰ në 2004 është ngritur në mënyre domethënëse në masën prej 3.7%, si rezultat i rritjeve

⁶⁶ USAID ka përkrahur një studim për Kushtet e Biznesit në Kosovë, faqja zyrtare e USAID. Business Development / Zhvillimi i Biznesit, http://www.usaid.gov/missions/kosovo/Publications/Enews/Enews_15_October_3.pdf (qasur: 25 janar, 2006).

⁶⁷ Wittkowski, A., Bajraktari, E., Niksic, O. "Fuelling Kosovo's Growth Engine" Zyra për Politika Ekonomike, UNMIK Shtylla e BE-se. Qershor, 2005. <http://www.euinkosovo.org> (qasur: 10 janar, 2006) faqe.4.

⁶⁸ Moalla-Fetini, R., Hatanpaa, H., Hussain, Sh., and Koliadina, N. në: Kosovo: "Gearing Policies Toward Growth and Development". Fondi Monetar Ndërkombëtar, <http://www.imf.org/external/pubs/ft/kosovo/2005/gpgd.pdf> (qasur: 10 dhjetor, 2005). f. 17.

⁶⁹ Raporti i Progresit në Kosove në 2005, Komisioni Evropian, 2005. http://europa.eu.int/comm/enlargement/report_2005/ (qasur: 25 nëntor, 2005) f. 29.

⁷⁰ Raporti Vjetor i ABPK të vitit 2004, f. 28 <http://www.bpk-kos.org/downloads/BPK%20Annual%20Report%202004.pdf> (qasur: 19 shkurt, 2006)

përmajtësore të shpenzimeve publike nga fundi i vitit. PBV-ja në vitin 2004 është llogaritur të jetë afërsisht në 1.85 miliard euro.

Prej përfundimit të luftës më 1999, Kosova ka pësuar deficit të madh të bilansit tregtar. Neto eksporti kundrejt shumës së importit është në favor të thellë të importit në periudhën e kaluar gjashtëvjeçare. Nga zbërthimi i të dhënave të regjistruara shihet se Kosova, në çdo vit ka pasur një deficit tregtar prej afërsisht 800 milion euro, me deficitin më të madh të pësuar në vitin 2001 me 900 milion euro⁷¹.

Punësimi është sfida me urgjente me të cilën përballen politik-bërësit e Kosovës dhe kjo ka qenë problem i vazhdueshëm gjatë gjithë viteve të fundit në Kosovë. Duke pasur një force punëtore të rë në dispozicion (p.sh. 14-64) dhe shtimit të vazhdueshëm të popullsisë, Kosova ballafaqohet me një papunësi në rritje e cila është e papërballueshme. Bazuar në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, shkalla e papunësisë është 42.3%⁷². Ky nivel i papunësisë ka qëndruar pothuajse i njëjtë për disa vite. Donacionet e larta të futura në ekonominë e Kosovës kanë prodhuar efekte lehtësuese dhe afat-shkurtra që pasqyrohen në të dhënat statistikore. Privatizimi i vazhdueshëm dhe kundërthënës i ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe ndërmarrjeve publike i cili ka filluar në vitin 2002 i ka vënë themelet për një punësim privat. Si pasojë, punësimi në sektorin privat ka pësuar një rritje të lehtë, krahasuar me sektorin publik i cili, sipas MEF-it, është i stërngarkuar. Tani për tani qeveria mbetet gjeneruesi kryesor i punësimit, pa mundësi të dukshme të ndryshimit të kësaj gjendjeje në një të ardhme të afërt.

“Papunësia është faktor kryesor i jostabilitetit” (Mitrovicë)

“Papunësia është burim kryesor i pasigurisë. Mungesa e kushteve të mirëfillta ekonomike i detyron njerëzit të gjejnë mënyra të tjera të jetesës (akte kriminale)” (Klinë)

“Papunësia dhe pagat e vogla në krahasim me çmimet e larta për shërbime (p.sh. energji elektrike) rezultojnë në vjedhje të vogla dhe grabitje” (Shtime)

Punësimi zyrtarisht është rritur për pothuajse 4% gjatë periudhës 2004 dhe ky trend prite të vazhdojë edhe gjatë periudhës afatmesme.

“Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë me pak mundësi ekonomike se sa shumica” (Suharekë)

⁷¹ Biografi Ndihmëse, e stafit të FMN-së në Kosovë, korrik 14-25, 2005.
<http://www.imf.org/external/pubind.htm> (qasur 20 dhjetor 2005) f. 9.

⁷² Të dhëna nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

3. RITJA EKONOMIKE

Tanimë është përmendur se ekonomia e Kosovës ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë viteve të fundit. Bumi ekonomik që ka përfshirë Kosovën menjëherë pas lufte ka siguruar ngushëllim për popullatën e varfëruar të Kosovës. Përafërsisht 20.000 shtëpi janë rindërtuar nga Agjencia për Rindërtim dhe Zhvillim, përderisa nga një numër agjencish donatore është dhënë ndihmë edhe në sektorin e blegtorisë.

Duke u bazuar në donacione të shumta dhe ndihmat nga diaspora, ekonomia pas vitit 1999 është rritur për 10% me rritjen më të lartë të pësuar me 2001 (11%). Megjithatë ekonomia e Kosovës ka pësuar një kthesë negative që nga viti 2001 dhe gjatë njëmbëdhjetë muajve të kaluar bilanci tregtar i Kosovës ka qenë minus 1,028 miliard euro. Duke u bazuar në donacione të shumta dhe ndihma nga diaspora, ekonomia e Kosovës është rritur në nivelet e 10% me rritjen më të madhe të pësuar më 2001 me mbi 11%. Mirëpo, kjo rritje kishte prirje për ngadalësim dhe ulje përderisa donacionet dhe ndihmat nga diaspora u gradualisht u zvogëluar. Duke pasur parasysh suficitin buxhetor fillestar Qeveria parashikonte një rritje ekonomike më të madhe, mirëpo menaxhimi i keq në shpenzime publike, vazhdimi i vonësave në privatizim dhe problemet me NPSH dhe NPP (të cilat kishin nevojë për ndihma të mëdha nga qeveria, si KEK-u p.sh.) përmbysën parashikimet qeveritare dhe prodhuan niveleë rritjes ekonomike të përmasave 4.7% në 2003 dhe 3.7% në 2004⁷³.

Projeksionet për vitin 2006 parashohin që ky trend të vazhdoj si rezultat i zvogëlimit të ndihmave nga diaspora dhe donacioneve të huaja në BKK.

Ky trend është si rezultat i vazhdimësisë së bilancit tregtar negativ, p.sh. diferenca tregtare ndermjet eksportit dhe importit. Edhe pse eksportet kanë pësuar një rritje prej 14% sipas ZSK-së, bilanci tregtar ngativ mbetet shumë i madh pasi pika fillestare e eksportit ka qenë tejte e ulët.

Kjo rritje negative e ka futur Qeverinë në një pozitë shumë të vështirë drejt shtimit të shpenzimeve publike dhe kështu ka sjellë deri në deficit buxhetor prej 5.9% të PBV-së në 2004 dhe 95 milion euro të tjera në vitin 2005. Ky deficit do t'a rraskapitë balancin qeveritar nëse vazhdohet me kete trend të nxitjes së rritjes ekonomike përmes përmes hargjimeve buxhetore.

4. MARRËDHËNIET E EKONOMISË ME SEKTORIN E SIGURISË

Implikimet buxhetore ndikojnë drejtpërsëdrejti në mbështetjen dhe efektshmërinë e institucioneve të sigurisë.

SHPK dhe TMK marrin një pjesë të konsiderueshme të BKK-së, duke llogaritur se bashku në afërsisht 10% të gjithë buxhetit ose 70 milion euro të BKK-së.

⁷³ Biografi Ndhimëse, e stafit të FMN-së në Kosovë, korrik 14-25, 2005, <http://www.imf.org/external/pubind.htm> (qasur: 20 dhjetor 2005) f. 8.

Buxheti i SHPK-së është më shumë se 52 milion euro në vit dhe projeksionet buxhetore për 2005/6⁷⁴ vlerësojnë se do të ketë një rritje prej afërsisht 10% për ristruktimin e SHPK-së⁷⁵. TMK kishte buxhet prej 15 milion euro në 2005 dhe një shumë prej 400 mijë euro iu shtua si donacion nge Miqtë e TMK-së. Buxheti i 2006 parasheh një rritje prej afërsishte 3 milion euro nga BKK-ja.

“Zhvillimi ekonomik është jetik për përmirësimin e mandhënieve ndëretnike”
(Rahovec)

Donacionet kanë qenë pjesë e madhe e financimit të TMK-së; ndër donatorët më aktivë ka qenë qeveria e SHBA-ve. Fakti që ekziston një mbështetje e konsiderueshme në donacione për institucionet e sigurisë është shqetësues, sepse kjo bie ndesh me qëndrueshmerinë e tyre afatgjate dhe me zhvillimin e nevojshëm.

5. ENER GjIA

Pavarësisht nga përparimet kriza energjetike mbetet një nga pengesat e zhvillimit dhe të sigurisë në Kosovë. Gjashtë vite pas luftës furnizimi me energji elektrike është me ndërprerje, ndërsa pagesa për të në masë të madhe mbështetet në subvencione nga qeveria e Kosovës. Sistemi i furnizimit me energji në Kosovë ka mangësi të shumta, përfshirë mirëmbajtjen jo-adekuate, faturimin e ulët dhe menaxhimin joadekuat. Sektori mbizotërohet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), ndërmarrje kjo me shtrirje vertikale dhe në pronësi publike që funksionon në bazë të dy blloqeve. Një nga këto blloqe (Kosova A) është në fund të ciklit të vet jetësor, me vetem një nga pesë njësitë e tij në funksion.

“Ekzistojnë probleme serioze në sigurimin e furnizimeve të ujit të pijshëm dhe të energjisë elektrike kur ndërmarrje të mëdha nuk paguajnë faturat dhe si pasojë bashkësitë në tërësi dënohen” (Klinë)

“Në jemi te diskriminuar nga KEK-u. Ata duhet të ndërprejnë rrymën në baza individuale dhe jo t'i ndëshkojnë edhe ata që e paguajnë” (Dragash)

Sipas Ministrisë për Energjetikë dhe Miniera nga maji i vitit 2005 kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë (B1+B2, A1+A5 dhe Hidrocentrali i Ujmanit) qëndron në 585-745 MW, derisa konsumi qëndron në 796MW me rritje të kërkesës maksimale është në 900MW⁷⁶.

Pjesa tjetër e energjisë elektrike që konsumohet në Kosovë importohet nga vendet fqinje.

⁷⁴ MEF ka publikuar të gjitha projeksionet buxhetore dhe në bazë të këtyre projeksioneve, SHPK-ja sikurse dhe TMK-ja do të kenë një rritje në buxhetet e tyre për afërsisht 10%

⁷⁵ SHPK duhet të pesoj ndryshime në menyre që të përmirësoj efikasitetin e vet, gjithashtu nën REG/UNMIK/2005/54 SHPK është prerogative i PSSH-se por keto kompetenca ngadalë do ti kalohen Ministrise se Brendeshme. Keshtu që ky proces do të ngërthej SHPK-në në ndryshime substanciale.

⁷⁶ Ministria e Enërgjisë dhe Minierave. Strategjia e Enërgjisë e Kosovës 2005/2015. <http://www.ks.gov.net/mem/> (vizituar: 24 dhjetor 2005). f.23.

Sektori energjetik është esencial për një zhvillim ekonomik te përsheptuar dhe për krijimin e kushteve për investime ekonomike.

Problemet kryesore me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës janë ndalesat e kohëpaskohshme të erezisë elektrike. Për këte arsye faturat elektrike shpeshherë nuk paguhen dhe borgjet kanë arritur në mbi 250 milion euro. Përveç kësaj këto janë barrë e subvencioneve ndaj BKK-së dhe donacionet vjetore. Nëse ky sektor konsolidohet këto shpenzime si nga BKK-së po ashtu edhe nga donatorët mund të ishin përdorur për prioritete të tjera më emergjente (sikurse infrastruktura rrugore, arsimit, shëndetsia etj.).

Hulumtimet për kushtet e biznesit në Kosovë kanë treguar se furnizimet e kufizuara me energji elektrike kanë krijuar barrierë ndaj qëndrueshmërinë dhe rritjen ekonomike. Gjithashtu, kjo gjendje ka krijuar një ambient negativ për investime të huaja potenciale⁷⁷.

Përdorimi i furnizimit alternativ me energji është i kushtueshëm gjë që e bën Kosovën jo-konkurrense në rajon. Fakt brengosës është se nëse sektori energjetik do të ishte menaxhuar me mire dhe blloqet e vjetra të ndërroreshin në vend se të mirëmbahen dhe te lihen në funksion me investime te larta, Kosova to të mund të kishte prodhuar tepëricë prej 300-500 MW ose 90-150 milion euro, gjë që do të kishte efekt të konsiderueshme në zbutjen e deficitit tregtar të Kosovës.

Kosova ka tri basene të thëngjillit ku eksploatohet lënda djegëse për blloqet ekzistuese dhe gjithashtu ka tri basene të tjera potenciale. Aktualisht ekzistojnë tri burime për te prodhuar afersishte 1000MW në ditë për një periudhe prej 40 viteve⁷⁸. Këto rezerva rrisin potencialin e zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve energjetike në Kosovë.

Sektori i energjetikës mund të tërheqë investime përmbajtësore nga shumë palë të interesuara, e mbi të gjitha nga investues të rëndësishëm e me kredibilitet botëror. Sipas MEM sektori energjetik mund të joshë një shumë prej €1.5 miliard në vit.

Përfundimet kryesore për sigurinë ekonomike

- Mbështetja e madhe e Buxhetit të Kosovës në taksat doganore (70%) reflekton deficitin e tanishëm tregtar dhe po ashtu ekonominë jo të shëndoshë. Megjithatë, në planin afatgjatë kërcënimin më i madh që lidhet me sigurinë do të mund të jetë korrupsioni eventuale në shërbimet doganore. Në kuadër të kësaj duhet theksuar edhe faktin se buxheti i Kosovës dhe politikat fiskale do të ndikohen negativisht nga aplikimi i mundshëm i Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë.
- Mungesa e ekonomisë së qëndrueshme minon çdo mundësi zhvillimi në planin afatgjatë për Kosovën dhe sjell papunësinë e lartë, që ndoshta është kërcënimin më i madh për sigurinë në planin afatgjatë.

⁷⁷ Po aty

⁷⁸ Po aty

- Vazhdimësia e gjendjes së tillë ekonomike, e karakterizuar nga përkrahja e donatorëve, mund të qoj në zvogëlimin e mundësive të Kosovës për t'iu përgjigjur kërcënimeve të sigurisë.
- Pamundësia për të ofruar energji elektrike në mënyrë të pandërprerë është një faktor tjetër shkatërrues i investimeve në Kosovë. Për më tepër, mungesa e ndriçimit në zonat e urbanizuara krijon përshtypjen e pasigurisë dhe gjithashtu demonstroi paaftësinë e qeverisë dhe ndihmon në zbehjen e legjitimitetit të saj.

4. SIGURIA E AMBIENTIT

Siguria e ambientit ka filluar të gëzojë një vëmendje të veçantë në dekadën e fundit. Krahasuar me sipërfaqen e saj relativisht të vogël, Kosova është shumë e pasur me bimë dhe lloje të ndryshme bimore. Janë trembëdhjetë lloje bimore që rriten vetëm në Kosovë dhe afersisht 200 lloje të cilat rriten vetëm në Ballkan. Shumëllojshmëria e bimëve në Kosovë është rezultat i bashkëveprimit kompleks të faktorëve fizikë që krijojnë kushte mjedisore të shumëllojshme për rritjen e bimëve. Pyjet mbulojnë rreth 40% të sipërfaqes së Kosovës, por vetëm një e treta konsiderohet ekologjikisht e shëndetshme dhe ekonomikisht produktive. Shumica e dy të tretave përbehet nga lisa të pazhvilluar dhe pyje me shkurre të cilat periodikisht priten për dru zjarri.

Ritmi i prerjeve të drujve të zjarrit është rritur gjatë dhe pas luftës, por Kosova ende importon më shumë se gjysmën e drunjve për lende djegëse dhe shumicën e drujve për ndërtim.

“Pyjet janë të rrezikuara për shkak të prerjeve ilegale ndërsa administrimi i pyjeve nga niveli rajonal e jo ai komunal vetëm sa e ka përkeqësuar këtë problem” (Istog)

Gjuetia ka qenë shumë e theksuar gjatë viteve 1990-të, por aktualisht ajo është e ndaluar dhe ka njoftime për shumë pak gjueti të paligjshme. Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e shtazëve që ekzistojnë në Kosovë.

Ekosistemi ujor i lumenjve është i rrezikuar si rezultat i ndotjes së ujit nga burime familjare dhe industriale si dhe nga mihjet e pakontrolluara të rërës dhe zhavorrit në shtratet e lumenjve.

Shumica e shumëllojshmërisë së bimëve dhe kafshëve të mbetura gjenden në bjeshkët e larta të rajoneve jugore dhe perëndimore të Kosovës. E gjithë Kosova ka përafërsisht 10% të hapësirës tokësore të mbrojtur dhe kjo është në përputhje me objektivat e pranushme ndërkombëtare⁷⁹.

1. ASPEKTE LIGJORE DHE INSTITUCIONALE TË MBROJTJES SË BIODIVERSITETIT

Janë ndërmarrur hapa domethenës në krijimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e biodiversitetit. Ligji për Mbrojtjen e Ambientit është miratuar në Kuvendin e Kosovës (janar 2003) dhe aty garantohet korniza e domosdoshme ligjore për ruajtjen e ambientit dhe të

⁷⁹ Agjen cioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Kosovo Biodiversity Assessment, <http://www.usaid.gov/missions/kosovo/Publications/Evaluations/Kosovo%20Biodiversity%20Report.pdf> (qasur: 16 janar 2006). Parku Nacional i Bjeshkëve të Sharrit në jug mbulon 39,000 ha dhe Alpet Shqiptare në perëndim të Pejës mbi 50,000 ha. Zonat e tjera të mbrojtura përfshijnë dy pejsazhe të mbrojtura dhe 38 monumente natyrore.

biodiversitetit. Dispozitat e këtij ligji do të detajohen më tutje nga legjislacioni sekondar, përfshirë akte nënligjore që duhet të adresojnë ruajtjen e natyrës dhe planifikimin hapësinor, që të dyja relevante për ruajtjen e biodiversitetit.

Ligji për Pyjet është miratuar në mars të vitit 2003. Ky ligj paraqet bazën ligjore për vënien e menaxhimit të pyjeve mbi themele më racionale, duke përfshirë dispozitat për menaxhimin e pyjeve në drejtim të mbrojtjes së biodiversitetit, por implementimi i këtij ligji përballet me pengesa serioze⁸⁰.

2. NDIKIMI NJERËZOR

“ Ndërtimet ilegale kanë sjellë deri tek ngushtimi i lumenjëve ” (Rahovec)

Ndikimi njerëzor në vegjetacion në mënyrë të konsiderueshme kanë ndikuar te kafshët e egra në Kosovë, pasi që kafshët janë të varura nga bimët për ushqim dhe strehë. Prerja klasike e pyjeve të hapura padyshim se ka sjellë deri te një ulje e konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të kafshëve në Kosovë dhe me gjasë deri te zhdukja e disa llojeve. Degradimet e menjëhershme të pyjeve të mbetura kanë efekte negative në botën shtazore. Shumë lloje tokësore ekzistojnë vetëm nëse janë në gjendje të jetojnë në bjeshkët e thella. Disa lloje të zogjve që jetojnë në moqale dhe në rrafshina nuk janë më të pranishëm në Kosovë. Rrjedhat industriale si dhe mbetjet nga mbeturinat industriale dhe ndotjet e ajrit nga objektet elektroenergjetike kanë ndotur seriozisht shtretërit e disa lumenjve në Kosovë.

Një pjesë e rrjedhës së lumit Sitnica afër Prishtinës është biologjikisht i vdekur si rezultat i rrjedhjes së fenolëve në lum nga termocentrali me lëndë djegëse të thëngjillit⁸¹. Niveli i përgjithshëm i ndotjes ka pësuar ulje gjatë viteve të 1990-s kur RFJ-ja ka qenë ekonomikisht e izoluar dhe shume fabrika ishin të detyruara të mbyllen. Në Kosovë nuk ka qendra për përpunimin e ujrave të zeza, prandaj ujrave të zeza të papërpunuara hidhen në lumenj duke krijuar sasi të larta të oksigjenit biologjik i cili eliminon disa lloje të peshqve, si troftat.

Pakurizorët janë gjithashtu të prekur nga ndotja dhe janë duke u përdorur në një studim nga një student i universitetit si indikator i nivelit të ndotjes. Zhavori dhe rëra të nxjerrura nga lumenjtë është një problem serioz, veçanërisht në lumin Drini i Bardhë dhe lumenjtë e Lumbardhit. Përdorimi i pajisjeve të rënda për nxjerrjen e këtyre materialeve shkatërron hapësirën jetësore për peshqë dhe pakurizorë dhe e mbushë lumin me sedimente të mënjanuara që është faktorë përcaktues i peshqve dhe jetës ujore.

⁸⁰ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, <http://www.mafrd-ks.org/english/pages/legal.php> (qasur: 30 janar 2006)

⁸¹ Kosovo Biodiversity Assessment, <http://www.usaid.gov/missions/kosovo/Publications/Evaluations/Kosovo%20Biodiversity%20Report.pdf> (qasur: 16 janar 2006).

Prerja e pyjeve është duke u bërë problem serioz. Individ të papërgjegjshëm janë të pamëshirshëm në prerjen e drunjve dhe nuk brengosen për pasojat nga kjo. Ka pasur raste të shumta kur dheu ka rrëshqitur dhe ka rrezikuar jetën e qytetarëve⁸².

Përfundimet kryesore për sigurinë e ambientit

- Gjendja e tanishme e mosndëshkimit ka ndikuar shumë edhe në ambientin e Kosovës i cili është nën kërcënim të vazhdueshëm për shkak të ndërtimeve ilegale, menaxhimit të dobët të mbeturinave, ndotjes dhe veprimeve të cilat shkaktojnë erozionin e tokës dhe vërshime. Kjo gjendje pengon investimet dhe për më tepër vështirëson edhe me shumë gjendjen problematike të ambientit me të cilën ballafaqohet popullata në rritje në Kosovë e që për rrjedhojë ka shtimin e sëmundjeve.

⁸² Rasti më i vonshëm i shembjes së dheut në rrugën magjistrale Prishtinë-Kaçanik paraqet më së miri kërcënimet e mundshme si rezultat i sjelljes ndaj ambientin. Të gjitha gazetat ditore, si b.f. Zëri 2005, Magjistrali Prishtinë-Shkup vazhdon të mbetet e bllokuar, 19, dhjetor 2005. f.8.

5. SIGURIA E KOMUNITETEVE ETNIKE

1. ZHVILLIMI I IDENTITETIT DHE KOMUNITETEVE

Komunitetet etnike paraqesin një ndër kushtet më serioze të stabilitetit afatgjatë të Kosovës. Komuniteti serb është në një pozitë shumë të vështirë për shkak të qëndrimeve kontradiktore për statusin e Kosovës. Komuniteti rom përballet me përjashtim ksenofobik që është i lidhur me dyshimet se gjatë luftës kanë kryer krime se bashku me forcat serbe. Komunitetet tjera kanë qenë më të suksesshme në integrimin me komunitetin shqiptar, përfshirë këtu edhe disa komunitete që më herët nuk veçoheshin nga romët. Si rezultat, nuk ka dhunë kundër boshnjakëve, turqve, ashkalive, egjiptianëve dhe goranëve. Ky qëndrim më përfshirës mund të jetë ndikuar edhe nga feja e njëjtë, edhe pse duhet përmendur se feja nuk radhitet shumë lartë si faktor përçarës në Kosovë.

Boshnjakët dhe goranët, sikurse serbët, ballafaqohen me vështirësi në arsimim dhe përdorim publik të gjuhës, kryesisht për shkak të gjuhës së tyre që ndryshon nga ajo e shumicës. Ashkalinjët dhe egjiptianët janë me pak të ndikuar nga kjo pasi ata përdorin gjuhën shqipe si gjuhë amtare. Romët dhe turqit, duke qenë komunitete të vogla në numër, ballafaqohen me probleme të natyrës se pamundësisë për të bërë libra shkollorë në gjuhët e tyre.

Këto komunitete janë përpjekur të zbusin gjendjen e tyre të palakmueshme përmes krijimit të entiteteve kulturore. Sikurse të rinjtë shqiptarë nga Maqedonia të cilët gjatë viteve shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë vinin në Prishtinë për arsimim, të rinjtë boshnjakë tani në masë të madhe emigrojnë në Sarajevë, sikurse të rinjtë serbë që shkojnë në Beograd ndërsa të rinjtë turq në Stamboll.

Përveç një gazete serbe që botohet në pjesën veriore të Mitrovicës, media në të cilat komunitetet jo-shqiptare kanë qasje janë disa revista javore dhe radio stacione lokale. Megjithatë, të dhënat tregojnë se pasi shumica e këtyre radiove janë të financuara nga donatorët ato lehtë mund të përballen me mbyllje. Kjo është një çështje e pranishme veçanërisht tek komunitetet e vogla të cilat nuk janë në gjendje të mbledhin fonde.

Të gjitha komunitetet kanë të drejtën e arsimimit në gjuhën e tyre. Megjithatë, problemet paraqiten në mungesën e librave shkollorë, fakt ky nga i cili edhe popullata shumicë është e ndikuar. Kjo çështje është duke tërhequr vëmendje të pamjaftueshme nga ana e zyrtarëve. Arsimi i lartë është i pranishëm vetëm për shqiptarët dhe serbët. Boshnjakët janë të ndarë ndërmjet alternativave për shkuarje në Prishtinë, ku përballen me problemin e gjuhës, dhe shkuarjes në Mitrovicë, me problemet e përjashtimit nga udhëheqësia e atjeshme radikale serbe dhe posaçërisht me udhëheqësin famëkeq të universitetit, z. Papoviq.

Popullsia	
Numri i përgjithshëm i popullsisë	1,900 000 vlerësim i vitit 2002
Dendësia e Popullsisë	175 për km ²
Grupet Etnike	
Shqiptarë të Kosovës	88%

Serbë të Kosovës	7%
Grupe tjera Etnike	5%
Kategorizimi sipas moshës, gjithsej	
0-14 vjeç	33%
15-64 vjeç	61%
65 vjeç dhe më të vjetër	6%

Figura 1. **Burimi: Kosova dhe popullsia e saj, (Zyra e Statistikave të Kosovës)**

2. (MOS) INTEGRIMI ETNIK

Përfundimi i konfliktit më 1999 ka sjellë një ndryshim rrënjësor në strukturën sociale, politike dhe ekonomike të Kosovës. Serbët e Kosovës u gjetën para një realiteti i cili për ta ishte i vështirë për t'u pranuar.

Administrata e re e krijuar (UNMIK-u) në fillim nuk u njoh nga serbët. **Pas vitit 1999 gjendja për minoritetin serb u përkeqësua duke qar në krijimin e enklavave si zona të sigurta, një ndjenje të përgjithshme të pasigurisë dhe në mungesë të lirisë së lëvizjes.**

Për gjashtë vitet e fundit shqetësimet e sigurisë e kanë bërë të vështirë për serbët e Kosovës dhe minoritetet tjera që të lëvizin jashtë enklavave të tyre. Ata që jetonin në komunat e dominuar nga serbët në veri, Leposaviq, Zveqan, Zubin Potok dhe në pjesën veriore të komunës së Mitrovicës, shumë rrallë kanë guxuar të lëvizin në pjesët e tjera të Kosovës. Në këto enklava administrata serbe: gjykatat, shkollat, spitalet etj. i përgjigjen drejtpërdrejt Beogradit. Edhe pse UNMIK-u nuk i ka pranuar kurrë zyrtarisht këto struktura të kontrolluara nga serbët, nuk ka bërë ndonjë përpjekje për t'i dhënë fund funksionimit të tyre. Këto institucione paralele mund të konsiderohen si arsyeja kryesore e nivelit të ulët të integritetit të komunitetit serb në shoqërinë e Kosovës pas mbarimit të konfliktit.

“Liria e lëvizjes, si dhe të drejtat e tjera në të gjitha aspektet duhet të respektohen me shumë” (Ferizaj)
“Në Leposaviq kemi liri të lëvizjes. Ne, megjithatë, nuk kemi qasje në monumentet fetare” (Leposaviq)

Lëmitë kryesore në të cilat strukturat paralele mund të grupohen janë tri: strukturat administrative, shkollat dhe institucionet shëndetësore, dhe strukturat e sigurisë. **Edhe pse prania e strukturave paralele të sigurisë është faktor me potencial destabilizues, dy faktorët kryesorë që mund të pengojnë integrimin e popullatës serbe në shoqërinë kosovare janë arsimit dhe shëndetësia. Mungesa e përgjithshme e njohurive, keqkuptimet e shumta si dhe ngurimi i IPVQ-ve për të tejkaluar këto pengesa kanë rezultuar në izolim të mëtutjeshëm të komunitetit serb.**

Gjendja me minoritetet e tjera është diçka më ndryshe pasi që asnjë prej tyre nuk jeton në zona të izoluar, por në vendbanime të përziera me komunitetin shqiptar. Në këtë mënyrë nga përvojat e tyre të përditshme janë shmangur disa nga keqkuptimet e mundshme.

Në deklaratimet e komunitetit serb mungesa e sigurisë del si arsyeja kryesorë pse ata nuk mund të imagjinojnë në një të ardhme të afërt shkollat e tyre të integruara me shkollat e shumicës. Incidentet serioze të sigurisë kundër pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë kanë pësuar rënie gjatë viteve të fundit. Ngjarjet e marsit të vitit 2004, megjithatë, kanë vënë në pah se armiqësia vazhdon të jetë e pranishme.

Pavarësisht faktit se bashkësia ndërkombëtare shpeshherë ka deklaruar se mbrojtja e të gjitha komuniteteve është parakusht për zgjidhjen përfundimtare politike, as MASHT-i e as organet arsimore nëpër komuna nuk kanë përgatitur ndonjë plan të thellë që do të siguronte integrimin në sistemin arsimor të MASHT-it të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në përgjithësi ose të anëtarëve të komunitetit serb në veçanti. Në të njëjtën kohë çështjet si e drejta për të mësuar një lëndë të veçante në gjuhën amtare dhe mësimi i historisë janë lëmit të cilave ende nuk u janë qasur as arsimtarët serbë e as ata shqiptarë në të gjitha nivelet e arsimimit.

Për arsye se MASS dhe MASHT-i nuk kanë marrëveshje për programin mësimor të Kosovës, studentet ballafaqohen me programe mësimore të ndryshme varësisht nga sistemi që ata zgjedhin ta përcjellin. Këto ndryshime mund të përcaktojnëse a munden nxënësit ta shfrytëzojnë të drejtën për të mësiar gjuhën e tyre amtare, të arsimohen në lëmi të caktuar në gjuhën e tyre amtare, dhe ta studiojnë historinë dhe kulturën e grupit të tyre etnik.

Në veçanti prindërit e serbëve të Kosovës janë të brengosur se fëmijët e tyre do të detyrohen të mësojnë atë që është në perceptimin e tyre si pasqyrime të shtrembëruara historisë dhe gjeografisë në shkolla të përziera të drejtuara nga MASHT-i.

Diplomat e shqiptarëve të Kosovës dhe certifikatat nga shkollat fillore dhe të mesme nuk njihen nga MASS-i. Studentët potencialë janë të obliguar nga MASS që të paraqesin certifikata serbe të shkollës fillore. MASS argumenton se nëse pranon programin shkollor të UNMIK-ut në Kosovë, nxënësit serbë të zhvendosur dhe refugjatë në Serbi nuk do të kthehen në Kosovë. Gjithashtu, MASS deklaroi se ajo mban programin shkollor me qëllim të garantimit se serbët e Kosovës dhe studentët e minoriteteve tjera kualifikohen për arsim të lartë në Serbi.

Pasi që MASS nuk mund t'i mbikëqyrë në mënyrë efektive shkollat në Kosovë kjo ndikon në kualitetin e arsimit në shkollat nën kontrollin nominal të MASS. Ka shumë raste ku qartazi dalin në pah mospërfilljet e vendimeve (administrative e jo atyre rreth plan-programit) të MASHT-it. Kualiteti i edukimit ndikohet gjithashtu edhe nga mungesa e trajnimit të mësuesve serbë të Kosovës edhe pse trajnime profesionale u ofrohen nga MASHT-i. Kjo ka për pasojë izolim të mëtejshëm të tërë komunitetit nga shoqëria, ndërsa për shkak të këtij qëndrimi janë fëmijët ata të cilët do ta paguajnë çmimin më të lartë.

3. SIGURIA PERSONALE DHE PUBLIKE

Në Kosovë çështjet e sigurisë personale gjithmonë kanë qenë me peshë në jetën e përditshme të qytetarëve. Sipas perceptimeve të shqiptarëve shteti serb nuk ka garantuar siguri por kanë qenë burim i pasigurisë, shtypjes dhe dhunës. Që nga viti 1999, serbët e

Kosovës konsiderojnë se nuk ekziston një përkrahje e pakusht nga udhëheqësit politik shqiptarë për të përmirësuar sigurinë e tyre⁸³.

Pas luftës dimensionin etnik i sigurisë publike dhe personale ka ndryshuar në masë të konsiderueshme, shikuar nga këndvështrimet e komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Siguria publike dhe personale është problemi kryesor me të cilin ballafaqohet komuniteti serb⁸⁴. Duke u bazuar në këtë 84.2% e serbëve ndihen të pasigurte, kurse 25.8% e Shqiptarëve ndajnë të njëjtën ndjenje⁸⁵. Përdërisa shqiptarët kanë besim në KFOR, SHPK dhe Policinë e UNMIK-ut (rreth 60% deri 90%), besimi serbe është me e ulët, shtrihet prej 5% deri në 25%⁸⁶.

”Krimi mund të luftohet në mënyrë më transparente, emrat e kundërvajtësve duhet të shpallen publikisht” (Klinë)

4. TË DREJTAT NJERËZORE

Çështja e të drejtave njerëzore mbetet problem në Kosovë. Qëndrimet kundërthënëse për sa arritjeve në planin e të drejtave njerëzore ushqehen, së paku pjesërisht, nga informatat e pamjaftueshme për atë se çka është e lejuar dhe çka jo si dhe nga keqkuptimet rreth ligjit të aplikueshëm.

Ekziston pakënaqësi për sa i përket publikimit të ligjeve, kohën e përkthimit të tyre dhe shpërndarjen e tyre si çështje të lidhura. Të ndikuara nga politika dhe dallimet etnike, të drejtat njerëzore aktualisht mbesin çështje negative e sigurisë. Ndonëse institucionet qeveritare nuk trengojnë tendenca serioze për shkelje sistematike të të drejtave njerëzore, ato janë të pafuqishme dhe nganjëherë edhe jo të gatshme për t'i mbrojtur të drejtat njerëzore universale.

Rrjedhimisht, shkeljet e të drejtave njerëzore ende nuk trajtohen si duhet. Edhe pse niveli i kriminalitetit mbetet relativisht i ulët⁸⁷, ekzistojnë raste të shpeshta të pa raportuara të krimeve, dhunës ndër-etnike, dhe incidenteve të shkallës së ultë⁸⁸.

Edhe pse është vendosur një sistem relativisht mirë i strukturuar (me institucionin e Zyrës së Ombudspersonit, komitete të komuniteteve, etj.) rekomandimet e disa prej këtyre organeve

⁸³ “KosovaLive, CDRSEE dhe Qendra Mediale Beta “Kosovo-Kosova, Afrimi në Kushtet e Problemit të Kosovës: Popullata ‘Qëndrime nga Kosova dhe Serbia”. 2005. f. 36.

⁸⁴ Raporti i Paralajmërimit të Hershëm RPH-Early Warning Report #11, Korrik-Shtator 2005, http://www.kosovo.undp.org/publications/ews11/ewr11_engl.pdf (qasur: 20 dhjetor, 2005) f. 35.

⁸⁵ *Po aty* f. 38

⁸⁶ *Po aty*

⁸⁷ Ambasador Kai Eide. Situata në Kosovë, Raport Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Tetor 2005. Raport, f.5.

⁸⁸ *Po aty*, f. 5

(veçanërisht Ombudspersonit) ende nuk merren seriozisht. Disa ndryshime, përfshirë transferin gradual të përgjegjësive tek IPVQ-të, kanë pasur ndikim psikologjik tek serbet e Kosovës⁸⁹. Serbët i shohin këto institucione me dyshim dhe kanë zgjedhur të qëndrojnë jashtë tyre, duke ruajtur strukturat paralele⁹⁰.

Përfundimet kryesore të sigurisë së komuniteteve etnike

- Vazhdimi i perceptimit të pasigurisë në mesin e komuniteteve, e në veçanti tek komuniteti serb, e gjithashtu edhe mos integrimi i komuniteteve paraqesin një problem kërcënues afatgjatë për stabilitetin dhe sigurinë.
- Pasiguria politike dhe ekonomike është forca kryesore e cila nxit migrimin jashtë Kosovës. Sa i përket popullatës serbe kryesisht janë arsytet politike ato të cilat nxisin këtë fenomen, ndërsa për popullatën shqiptare duket se mungesa e mundësive ekonomike është shkaku kryesor.
- Përkundër kornizës ligjore e cila garanton barazinë ndërmjet grupeve etnike dhe të drejtën për kthim, mundësitë për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin e komuniteteve ndërmjet minoriteteve është e kufizuar.

6. INSTITUCIONET E SIGURISË

1. HYRJE

Pa marrë parasysh statusin final të Kosovës, vendi nuk mund të qeveriset pa ligje dhe rend dhe pa të gjitha institucionet e domosdoshme për garantimin e sigurisë së brendshme. Kështu që e ardhmja e Shërbimit Policor të Kosovës është e garantuar.

SHPK, deri me tani, ka qenë një organizatë e cila ka funksionuar mbi një bazë ligjore të paidentifikuar dhe jo të qartë. Rezoluta e KSKB 1244 udhëzon UNMIK-un që të punoj në krijimin e Institucioneve Vetëqeverisëse dhe të punoj për mirëmbajtjen e sigurisë, ligjit dhe rendit.

Sipas nenit 8.1 të *Kornizës Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme vet-qeverisëse* PSSP-ja ka pushtet ekskluziv mbi të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit përfshirë edhe personelin e tyre vendor. Më 1999 UNMIK-u krijoi SHPK-në, me gupin e parë të personelit të SHPK-së si pjesë e strukturave të CIVPOL-it të UNMIK-ut. Edhe pas shpalljes së rregullore, SHPK-ja trajtohet si pjesë e shtyllës së I-rë të UNMIK-ut, përgjegjëse për Policinë dhe Drejtësinë. Ajo udhëhiqet nga Komisionari Civil i Policisë (i emëruar nga UNMIK-u) i cili i përgjigjet Zëvendësit të PSSP-së, gjegjësisht udhëheqësit të Shtyllës së I-rë. SHPK-ja është forcë

⁸⁹ Po aty faqe 9.

⁹⁰ Po aty faqe 4.

policore me të gjitha kompetencat relevante të policisë, por autoriteti i SHPK-së tejkalohet nga personeli i Policisë Ndërkombëtare.

Rregullorja e tanishme e UNMIK-ut 2005/54 i jep bazën ligjore shumë të nevojshme SHPK-së. Përkundër faktit se ajo e trajton SHPK-në nën autoritetin e UNMIK-ut, rregullorja pasqyron mundësinë e transferimit të kompetencave tek Ministria e Brendshme.

Policia e UNMIK-ut përkufizohet nga dy qëllime të UNMIK-ut. E para, të garantoj rend dhe ligj dhe e dyta për të zhvilluar një SHPK të besueshme, profesionale dhe të paanshme. Policia e UNMIK-ut në bashkëpunim me OSBE-ne kanë trajnuar 8,830 pjesëtarë të SHPK-së⁹¹. Deri në fund të 2004, 7,021 personel shërbenin në SHPK me një pjesëmarrje të minoriteteve përafërsisht 15% të personelit, përfshi këtu 8% oficer serbë, dhe gjithashtu 15% femra. Ky personel është i shpërndarë si vijon: 1,224 në Prishtinë, 1,007 në Gjiilan, 859 në Prizren, 813 në Pejë, 780 në Mitrovicë, 639 në zyrat qendrore, 83 në Shkollën e Shërbimit Policore të Kosovës, 120 Oficer të Policisë së Trajnimit në Terren dhe 955 në Policinë Kufitare⁹².

I gjithë ky personel i punësuar nga SHPK-ja është i ndarë në dy njësi kryesore: Shërbimi Policor (SHPK) dhe Divizioni i Shërbimit të Sigurisë (DSHC). E para përmbushë detyrat e zbatimit të ligjit dhe detyrat e sigurisë publike, ndërsa DSHC ka detyra për sigurinë e brendshme të ndërtesave qeveritare. Derisa oficeret e SHPK-së janë policë me detyra të plota të ngarkuar me të gjitha kompetencat për të arrestuar, për mbajtjen në arrest dhe kryerjen e detyrave të tyre gjatë kohës sa janë nën armë, DSHC-ja është e trajnuar në përgjithësi për të siguruar ndërtesat e rëndësishme nacionale. Ata nuk janë të armatosur dhe nuk janë të pajisur me autorizime për të arrestuar, për të mbajtur në arrest, por ata e bëjnë këtë në bashkëpunim dhe nën mbikëqyrjen e SHPK-së.

SHPK-ja është e strukturuar në formën e një force prestigjioze. Kjo është bere për të siguruar që zhvillimi i organizatës së SHPK-se është në proporcion me përgjegjësitë të cilat i mban dhe përgjegjësitë në rritje të cilat pritjet t'i marrë. Për të mundësuar këtë zhvillim, gradat janë caktuar, dhe gradimet janë caktuar në bazë të provimeve konkurruese. Ky zhvillim i SHPK-së ka rezultuar në një force e cila është e gatshme të marrë përgjegjësi nga CIVPOL i UNMIK-ut dhe të kryej detyra përkrah CIVPOL-it të UNMIK-ut. Përgjegjësitë në rritje dhe detyrat që SHPK-ja mund t'i kryej janë si vijon:

- Patrulla rrugore;
- Menaxhim të stacioneve;
- Shërbime të trafikut;
- Njësi të mbrojtjes së afërt;
- Shërbime të sigurisë;
- Njësitë e policisë së armëve speciale;

⁹¹ Trajnimi i klasës së parë të oficerëve të SHPK-se ka filluar në shtator të vitit 1999 në Shkollën e Shërbimit Policorë të Kosovës në Vushtri.

⁹² Bazuar në Raportin e Gjendjes Ditore të 29 dhjetorit, 2004 të Komponentit Civil të Policisë së UNMIK-ut. E cituar në: UNDP Interim Report, "Assessment of Administrative Capacity in Kosovo" (qasje vetëm me kërkesë dhe me autorizim të zyrtarëve të UNDP-së).

- Shërbime të inteligjencës;
- Njësi speciale të hulumtimit dhe luftimit të narkotikëve, prostitucionit dhe trafikimit njerëzor, shpëlarjen e parave dhe formave të tjera të krimit të organizuar;
- Kapacitete hulumtuese të mjekësisë ligjore dhe hulumtime të vendngjarjeve të krimit;
- Mbikëqyrje të kufirit;
- Administratë policore dhe trajnime;

Duke u bazuar në detyrat e lartpërmendura që ata i kryejnë, SHPK-ja është e angazhuar në të gjitha detyrat e specializuara, edhe pse nevojiten më shumë trajnime për disa funksione speciale dhe për sistemin e gradimit.

Buxheti i SHPK-se prej 53 milion euro ka mundësuar sigurimin e të avansuara që nevojiten për operacione shtesë. SHPK-ja është policia me e kompletuar në regjion, megjithatë me rritje të numrit të personelit të SHPK-së dhe me bartje shtesë të përgjegjësive, tani të rezervuara për CIVPOL-in e UNMIK-ut, SHPK-ja duhet të përmirësoj pajisjet e veta.

Aspiratat

Mbajtja e rendit dhe ligjit është e rëndësishme fundamentale për të gjithë popullin e Kosovës. Kontributi i SHPK-së në realizimin e këtyre objektivave është thelbësor nëpërmjet rolit të saj përkrahës në parandalimin e krimit, mbrojtjen dhe sigurinë publike.

Me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare, kapacitetet e SHPK-se në parandalimin e krimit, mbledhjen e informatave për kriminalitetin, hulumtimet e krimit dhe lufta kundër kriminalitetit janë duke u shtuar, por ende mbetet shumë për tu bere.

Kjo paraqet një precedent të mirë për përgjegjësi shtesë që gradualisht duhet t'i marrë SHPK-ja. Megjithatë, SHPK-ja ka hasur në disa mangësi të cilat në masë të madhe kanë kontribuar në uljen e imazhit të saj sytë e qytetarëve.

“Serbët kanë më shumë besim në policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-ja si e tillë nuk është sa duhet profesionale” (Gjilan)
“Komunitetet minoritare tani kanë me shume besim në SHPK-ne sepse ata janë të përfaqësuar në SHPK” (Kamenicë)

Kosova dhe popullsia e saj historikisht kanë pasur perceptim negative për strukturat e policisë. Deri më tani në Kosovë nuk ka pasur traditë e policisë demokratike dhe e policisë së komunitetit.

Gjatë viteve 1990 strukturat e policisë serbe kanë kontribuar në shtypjen dhe abuzimet e rënda të të drejtave njerëzore. Kjo trashëgimi ka kontribuar në trajtimin e SHPK-së me një optimizëm të matur. Gjatë gjashtë viteve të kaluara, besimi i qytetarëve në SHPK-në është rritur në masë të konsiderueshme dhe kjo është një shenjë që flet për punën profesionale të SHPK-së.

2. MODELIMI I SË ARDHMES SË TRUPAVE TË MBROJTJES SË KOSOVES

Roli i Trupave të Mbrojtjes së Kosovës në të ardhmen do të jetë i një rëndësie të veçantë për shkak të aspiratave të pjesëtareve të saj, por gjithashtu për shqiptaret e Kosovës të cilët e shohin TMK-në si bërthamën e armatës së tyre të ardhshme. Në këtë kontekst është me rëndësi të shpjegohen elementet qenësore të kësaj organizate në mënyrë që të kuptohen implikimet e saj për sektorin e sigurisë.

Për të kuptuar rrënjët e TMK-së duhet të shikohet prapa në origjinën e UÇK-së⁹³, e cila në fund të viteve nëntëdhjetë ka luftuar kundër forcave të sigurisë të Serbisë. Pas përfundimit të konfliktit, komuniteti ndërkombëtar kërkoi demilitarizimin e UÇK-së. Ky proces ka qenë shumë i vështirë dhe ndodhi vetëm pas disa koncesioneve që iu bënë kosovarëve. Një nga këto koncesione të paqarta ishte premtimi se në të ardhmën ajo do të bëhet një “armatë e ngjashme me Gardën Kombëtare të SHBA-ve” për Kosovën⁹⁴. Kjo i ka lejuar UÇK-së të çarmatoset dhe të transformohet në TMK. TMK-ja u themelua sipas Rregullores 1999/8 të UNMIK-ut, që e përkufizon TMK-në si “agjenci civile e shërbimeve emergjente, detyrat e së cilës do të jenë: siguroj shërbime të reagimit të fatkeqësive, kryen kërkim dhe shpëtim, siguron kapacitete për asistencë humanitare në zona të izoluar, asiston në deminim, kontribuon në rindërtimin e infrastrukturës dhe komuniteteve”. Korniza Kushtetuese gjithashtu e ngarkon TMK-në me kompetenca të njëjta⁹⁵.

Edhe pse mandati i TMK-së është i qartë, keqkuptimet kanë ndodhur dhe shpesh TMK është parë si një formë e organizatës paramilitare. Ky perceptim ka origjinën në gjenezën ushtarake të TMK-së dhe gjithashtu sepse anëtarët e TMK-së veshin uniforma të stilit ushtarak, dhe një numër i caktuar i tyre është i lejuar të mbajë armë. Gjithashtu, tani është e qartë se TMK-ja do të jetë një çështje e rëndësishme për tu diskutuar brenda kornizës së diskutimeve për statusin final.

Udhëheqësit e TMK-se kanë shpalosur vizionin e tyre për të ardhmën e organizatës. Sipas këtij vizioni, TMK duhet të bëhet armata e ardhshme e Kosovës në mënyrë që të “luaj një rol të rëndësishëm për të ndihmuar në zhvillimin e shtetit në krijim”. Përveç kontributit në operacione të sigurisë, ajo do të ndihmojë në udhëheqjen e vendit gjatë kohërave të vështira të tranzicionit duke dhënë shembull për unitet, integritim, bashkëpunim”⁹⁶.

Ky propozim argumenton që “armata e Kosovës” është një shprehje e rëndësishme e sovranitetit dhe pavarësisë...ajo siguron mënyrën dhe metodat që do të kontribuojnë në paqen dhe integritetin e një shteti demokratik, përkrah politikën e jashtme dhe synimet e sigurisë,

⁹³ UÇK është shkurtesa shqipe për “Ushtria Çlirimtare e Kosovës”

⁹⁴ Më shumë detaje në tërë procesin mund të gjendet gjithashtu në raportin e Qendrës për Studime të Sigurisë Evropiane, The Kosovo Protection Corps in Search of a Future, <http://www.iss-eu.org> (qasur: 20 Dhjetor, 2005)

⁹⁵ Kapitulli i 7 i Kornizës Kushtetuese: Trupat Mbrojtëse të Kosovës është organizatë civile e emergjencës, e formuar me ligj, e cila kryen detyra të reagimit të shpejt gjatë fatkeqësive në Kosovë për sigurinë publike në kohë të emergjencave dhe asistencës humanitare. Faqja Zyrtare e UNMIK, Korniza Kushtetuese e Kosovës, <http://www.unmikonline.org/constframework.htm> (qasur: 29 Dhjetor, 2005).

⁹⁶ Më shumë në prospektet e se ardhmes së TMK-se shih dokumentin e TMK-se “ Armata e Kosovës”, (e gatshme vetëm me kërkesë dhe me lejen e zyrtareve të TMK-se).

dhe premtën komunitetin ndërkombëtar për kontributin e Kosovës në një partneritet me të gjere”⁹⁷.

Ky propozim vendos theksin në brishtësinë e sigurisë së mjedisit të tanishëm dhe sugjeron që krijimi i armatës së Kosovës do të kontribuoj në përmirësimin e përgjithshëm të situatës së sigurisë brenda Kosovës.

- **Propozimi merr në shqyrtim një seri të kërcënimeve të sigurisë së Kosovës. Në shqyrtimin e kërcënimeve të sigurisë së brendshme dokumenti sugjeron që strukturat politike të Kosovës mbesin të dobëta dhe janë të brishta karshi aksioneve agresive nga ekstremizmi politik dhe terrorizmi.** Këto struktura ende duhet të forcohen në një ambient të sigurtë. Ekonomia e Kosovës është gjithashtu e brishtë dhe do të duhen shumë vite në mënyrë që të arrihet një ekonomi të qëndrueshme. Një kolaps i mundshëm i ekonomisë do të mund të destabilizonte regjionin dhe do të rrezikonte realizimin e Kosovës si shtet sovran. Kosova ka kërcënime të brendshme të vazhdueshme që vijnë nga banda të armatosura, krimi i organizuar dhe kontrabandistët, të gjitha këto bëjnë gjendjen më të rëndë në dritën e pranisë së një numri të madh të armeve ilegale. Këto do të duhet të kontrollohet, nëse e nevojshme me forcë, në mënyrë që të mos rrënojnë stabilitetin dhe ekonominë e vendit të ri demokratik⁹⁸.

Mandati i tanishëm i TMK-se duket se ka buron nga udhëheqësit politikë të Kosovës. Kështu, vizioni i udhëheqësve të TMK-së është në përputhje me qëndrimet dhe aspiratat e shumicës shqiptare të Kosovës.

“TMK duhet të transformohet në armatë moderne” (Shtime)
“Serbët përkrahin punën e TMK-së dhe të udhëheqjes komunale, por nuk kanë besim në strukturat e TMK-se dhe nuk duan që ajo të bëhet armata e Kosovës”
(Rahovec)

3. FORCA E KOSOVËS

Forca e Kosovës (KFOR) është forcë ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO-ja që mbanë përgjegjësi për vendosjen dhe ruajtjen e sigurisë në Kosovë. Kjo forcë për forcimin e paqes nën mandatin e Kombeve të Bashkuara ka hyrë në Kosovë më 12 korrik 1999, dy ditë pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në përputhje me Rezolutën 1244 të KSKB, misioni i KFOR-it është:

- Vendosja dhe ruajtja e një ambienti të sigurtë në Kosovë, përfshirë sigurinë publike dhe rendin.

⁹⁷ Po aty

⁹⁸ Të gjitha këto janë elaboruar në me shume detaje në planin projekt propozimit të TMK-se për transferimin në të ardhmën të TMK-se në armatë të re. Ky plan titullohet “Armata e Kosovës”.

- Monitorimi, verifikimi dhe nëse e nevojshme, zbatimi i kushteve të Marrëveshjes Ushtarake Teknike dhe Premtimeve të UÇK-së.
- Siguron asistencë Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK), përfshirë funksione thelbësore civile deri në bartjen e tyre tek UNMIK-u⁹⁹.

Është e qartë se detyra kryesore e KFOR-it është ruajtja e sigurisë, sado që fushëveprimi i angazhimit të tyre të jetë e gjere. Shembuj të angazhimit të KFOR-it mund të gjinden në sektorë të ndryshëm, si punët publike dhe shërbimet komunale, ndërtimtari, transport, operacione hekurudhore, pastrim të minave, sigurinë e kufijve, shërbime zjarrfikëse, mbrojtje të punëtoreve ndërkombëtarë, shpërndarje të ushqimit, heqje të mjeteve të pashpërthyer, arsimit dhe informimit rreth minave, shërbime mjekësore, etj. Megjithatë, KFOR-i tanimë u ka dorëzuar gradualisht agjencive të tjera shumicën e këtyre detyrave. Derisa në korrik të vitit 1999 KFOR-i kishte përafërsisht 50,000 ushtarë, deri sa kushtet kanë ndryshuar ky numër dhe është eulur në mënyrë të konsiderueshme në rreth 17,000 persona në 2003.

Sot, KFOR-i ka tri detyra kryesore: a) mbrojtjen nga jashtë, b) ruajtjen e enklavave dhe objekteve fetare, dhe c) përkrahjen e forcave policore në kushte kur ato nuk mund të përgjigjen në mënyrë adekuate sfidave të sigurisë së brendshme.

Kjo detyrë e fundit (e njohur si “Asistencë Ushtarake Forcave Civile”) është një ndër detyrat më të rëndësishme të KFOR-it. Është e dukshme, megjithatë, se nuk ekziston bazë ligjore që përcakton se si kjo asistencë e rëndësishme, por edhe potencialisht problematike, duhet të kryhet. KFOR-i nuk mbikëqyret nga UNMIK-u, e lëre më nga kosovaret. Në fakt, segmenti ushtarak i administratës ndërkombëtare në Kosovë pranon udhëzime ushtarake dhe politike nga NATO-ja dhe Ministrinë e Mbrojtjes së vendeve gjegjëse¹⁰⁰. Përveç kësaj, KFOR-i dhe UNMIK-u kanë qasje të ndryshme ndaj sigurisë dhe përgjegjësisë gjegjëse për të siguruar atë¹⁰¹. Ngjarjet e fundit në Kosovë konfirmojnë vazhdimësinë shqetësuese të pikave të nxehta të tensioneve etnike në mbarë territorin e Kosovës përkundër pranisë së KFOR-it. Këto pika të nxehta kërkojnë një nivel konstant të vigjilencës në mënyrë që të kontrollohet nga dalja jashtë kontrollit dhe të evitohet një efekt i përhapjes. Gjatë pesë viteve të fundit KFOR-i në mënyrë aktive ka kontribuar në mbajtjen e një ambienti të sigurt në Kosovë, dhe për të gjitha proceset është e domosdoshme që KFOR-i të vazhdojë praninë e tij për një periudhë më të gjatë për shkak të gjendjes së brishtë të sigurisë dhe të paqartësisë rreth statusit të ardhshëm të Kosovës.

⁹⁹ Faqja zyrtare e KFOR-it, <http://www.nato.int/kfor/kfor/objectives.htm>, (qasur: 11 janar, 2006)

¹⁰⁰ Mungesa e legjislacionit të duhur i cili rregullon këto detyra dhe objektiva specifike është qasur se fundi në një dokument të botuar nga KIPRED dhe SaferWorld, “Forcimi i Mbikëqyrjes Civile dhe i Menaxhimit të Sektorit të Sigurisë në Kosovë”. <http://kipred.net/UserFiles/File/SecSectorManagement.pdf> (qasur: 11 janar, 2006)

¹⁰¹ Antonio Donini et al, “Mapping the Security Environment: Understanding the perceptions of lokal communities, peace support operations, and assistance agencies”. Feinstein International Famine Center Korrik 2005. f.25

4. ORGANET E INTELEGJENCËS NË HIJE

Përveç institucioneve të lartpërmendura të sigurisë në Kosovë, veprojnë edhe disa shërbime të inteligjencës në hije. Prania e tyre nga ana e administratës ndërkombëtare dhe institucioneve kosovare është toleruar, në rastin më të mirë, dhe është inkurajuar, në rastin me të keq, me ç'rast organet e pushtetit janë treguar jo të gatshme ose të paaftha që t'i qasen kësaj çështjeje të ndjeshme. Një raport i publikuar kohëve të fundit përshkruan praninë e agjencive të inteligjencës në hije si një nga shume problemet të cilat janë duke u "futur nën çilim në vend se të adresohet"¹⁰². Ky qëndrim haset gjatë gjithë periudhës së administratës ndërkombëtare në Kosovë, pavarësisht nga retorika sporadike kundër këtyre shërbimeve¹⁰³. Megjithatë, derisa shmangia e vendimet për të ardhmën e strukturave partiake të inteligjencës deri me tani ka qenë taktika e preferuar e UNMIK-ut dhe e qeverisë së Kosovës, me "bisedimet e filluara për të ardhmen politike të Kosovës, do të jetë shumë vështirë të që çështje të tilla thelbësore të injorohen"¹⁰⁴. Bashkësisë ndërkombëtare do t'i duhet që të zgjedhë ndërmjet tolerimit, shpalljes së tyre për të paligjshme ose përfshirjen e tyre.

Përfundimet kryesore të institucioneve të sigurisë

Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të SHPK-së do të bëhet problematike në atë moment kur prej tyre do të kërkohet të marrin përsipër rolin që momentalisht e kryen policia ndërkombëtare.

TMK-ja nuk është e pranuar akoma nga minoriteti serb. Ndërkohë që TMK-ja mund ta përmbush këtë, ekziston një problem tjetër që ka të bëjë perceptimin e popullatës se mandati i tanishëm i TMK-së si një organizatë civile emergjente duhet të avancohet në ushtri të ardhshme. Kjo mospërputhje ndërmjet mandatit dhe aspiratave, si nga ana e personelit e po ashtu edhe nga popullata është problematike

KFOR është përgjegjës për sigurinë dhe ofron përkrahje për të gjitha komunitetet në mbarë Kosovën. Si garantuesi i vetëm i sigurisë së jashtme në Kosovë, vazhdimi i rolit të KFOR-it do të jetë faktor thelbësor për të siguruar stabilizim të suksesshëm në Kosovë. Komuniteti ndërkombëtar, megjithëkëtë, në planin afatgjatë duhet të mendoj për ndonjë mekanizëm tjetër adekuat që do ta zë vendin e KFOR kur ai të tërhiqet.

¹⁰² Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova pas Haradinajt', Përmbledhje ekzekutive e disponueshme në: http://www.crisisgroup.org/library/documents/europe/balkans/163_kosovo_after_haradinaj.pdf (qasur 20 Dhjetor, 2005)

¹⁰³ Departamenti i Informimit Publik të UNMIK-ut, Konferencë për shtyp 30 nëntor 2005, Konferencë për shtyp 22 dhjetor 2005.

¹⁰⁴ Jeta Xharra, "Kosovo's Intelligence Services Come In From The Cold". BIRN. Gjetet në: http://www.birn.eu.com/insight_15_6_eng.php (qasur: 27 dhjetor, 2005)

7. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTARË

Siç u theksua edhe më lartë ekzistojnë dy qasje të ndryshme dhe kontradiktore sa i përket legjitimitetit ndërkombëtarë dhe regjional të IPVQ-ve/UNMIK-ut e të cilat bashkëekzistojnë paralelisht. E para është qasja e ngurtë sipas të drejtës ndërkombëtare dhe nga ana tjetër është qasja praktike.

Rezoluta 1244 e KSKB nuk ndanë kompetencat ndërmjet IPVQ-ve dhe UNMIK-ut, por Korniza Kushtetuese qartëson pushtetin dhe përgjegjësitë e rezervuara për PSSP-në. Neni 8.1 (i), (m), (n), (o) përcakton se ushtrimi i pushtetit, përfundimi i marrëveshjeve, mbikëqyrja përbushjes së detyrimeve ndërkombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në përgjithësi janë e drejtë e rezervuar e PSSP-së. Megjithatë, bazuar në kompetencat e bartura tek IPVQ-të sikurse ekonomia, energjia dhe çështje të tjera, IPVQ-të mund të negociojnë dhe të përfundojnë çdo marrëveshje, duke mos tejkaluar kompetencat e tyre, por lidhja e marrëveshjeve bëhet në emër të PSSP-së dhe PSSP-ja është ai që mund të luaj rolin e tij në marrëveshje duke e shpallur ose shfuqizuar atë. Në këtë mënyrë fjala e fundit i mbetet PSSP-së.

UNMIK-u, në përputhje me Rezolutën 1244 dhe sipas Kartës së OKB-së ka pranuar shumë konventa por nuk është palë e asnjë konvente të nënshkruar apo të shpallur gjatë ekzistencës së tij në Kosovë. Natyra e konventave është e tillë që ato mbi të gjitha kanë të bëjnë me shtetet sovraane, kështu që në përputhje me të drejtën ndërkombëtare Kosova e tanishme është ose nuk është pjesë e ndonjë konvente bazuar vetëm në politikat e USM, gjegjësisht nëse ky Union është pjesë e një konvente të tillë. Megjithatë, kjo nuk paraqet anëtarësim dhe kur të barten kompetencat, politikanët mund të zgjedhin ndryshimin e këtyre politikave.

Deri në dhjetor të vitit 2005, sipas Zyrës për Koordinimin të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Dialogut Regjional, Kosova ka hyrë në shumë marrëveshje ndërkombëtare me etnitetë të tjera ndërkombëtare. Në sferën ekonomike, UNMIK/IPVQ ka përfunduar Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me shtetet fqinje, si me Shqipërinë, IRJM-në dhe janë përmbyllur bisedimet me Bosnjë dhe Hercegovinën. Ky hap ka krijuar mundësi që Kosova të bëhet pjesë e zonës së tregtisë së lirë për Evropën Juglindore, që ka për synim liberalizimin e ekonomive të regjionit. Pas nismës nga ministrinë e IPVQ-ve, PSSP më 2003 nënshkroi MTL-në e parë me Shqipërinë. Edhe pse Shqipëria është nga partnerët më të vegjël ekonomik në rajon, prapë se prapë ky hap ka krijuar më shumë kushte për zgjerimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. MTL-ja e fundit u arrit me Maqedoninë në shtator të vitit 2005. Maqedonia është partneri më i madh tregtar i Kosovës. Ajo merr pjesë me 19% në mbarë importet e Kosovës dhe 23% të eksporteve të saj. Duke pasur parasysh pabarazinë e importit përkundëjt eksportit, kjo MTL synon të vendos marrëdhënie ekonomike të mbështetura në mundësi të barabarta ndërmjet IRJM-së dhe Kosovës. Bisedimet për MTL me Bosnje dhe Hercegovinën janë përfunduar, por marrëveshja nuk është formalizuar ende nga dy vendet.

Nje element tjetër me rëndësi i bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar është edhe Traktati i Athinës. Ky është një traktat, i mbështetur nga mbledhjet e Paktit të Stabilitetit, sipas të cilit vendet e Evropës Juglindore angazhohen në krijimin e një tregu regjional të energjisë. Kosova në gjashtë vitet e fundit ka hasur në shumë probleme në sektorin e energjisë dhe sipas Ministrisë të Energjisë dhe Minerave ky hap do të vendosë bazat për stabilizimin e energjisë në Kosovë. Dhjetë anëtarë të EJK-së paraprakisht nënshkruan këtë traktat në Athinë në vitin 2002, kurse Kosova iu bashkua atyre, me rekomandime të PS-së, në vitin 2005.

Me qëllim që të kryej me mirë detyrat dhe përgjegjësitë e veta, UNMIK-u ka hyrë në marrëveshje të ndryshme të sigurisë me një numër vendesh. Siguria, sikurse edhe marrëdhëniet ndërkombëtare, është përgjegjësi e rezervuar. Prandaj, UNMIK-u me iniciativë të veten ka bërë marrëveshje në sferën e sigurisë në përgjithësi me:

1. Republikën Federale të Jugosllavisë në:

- Bashkëpunim policor dhe ndërkufitar;
- Verifikim të përbashkët të personave në arrati;
- Shkëmbim të ekspertizës mjeko-ligjore dhe;
- Riadhesim ndërkufitar të eshtrave të identifikuar.

Gjithashtu, UNMIK-u ka nënshkruar marrëveshje me Shqipërinë, IRJM-në dhe me Malin e Zi (ndarasi nga USM) për bashkëpunim policor. Të gjitha këto marrëveshje kanë shtuar sigurinë në regjion ku krimi i organizuar, terrorizmi, trafikimi i drogës dhe i qenieve njerëzore si dhe shpëlarja e parave paraqesin kërcënime serioze dhe sfida për sigurinë e vendit dhe të regjionit në përgjithësi. Këto marrëveshje synojnë të kenë të njëjtën gjuhë dhe bashkëpunimi është i të njëjtit nivel, por Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet UNMIK-ut dhe Shqipërisë për bashkëpunim policor nuk lidhet me çështjen e kriminelëve të luftës dhe çështjeve të cilat ndërlidhen me luftën pasi që Shqipëria nuk ka qenë e përfshirë në asnjërën nga luftërat jugosllave. Përveç bashkëpunimit policor, UNMIK-u ka nënshkruar marrëveshje me Serbinë në çështje shumë të ndjeshme si për personat e zhdukur dhe të zhvendosurit. Këto dy marrëveshje, së bashku me marrëveshjen për shkëmbim të ekspertizës mjeko-ligjore, janë si rezultat i luftës në Kosovë ku një numër i madh prej përafërsisht 6000 personave janë të zhdukur ndërsa një numër i konsiderueshëm i eshtrave tanimë janë identifikuar në Serbi (varrezat masive famëkeqe të Batajnicës).

Një forum tjetër ku Kosova ka pasur mundësi të jetë pjesë e bashkëpunimit dhe dialogut ndërkombëtar është Pakti i Stabilitetit (PS). PS është një forum multilateral i cili me iniciativë të BE-së në vitin 1999, në Kolognë, është krijuar për EJK, si rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet akterëve kryesor si SHBA, BE, Japoni dhe Rusi, si dhe organizatave të tjera që merren me çështjen e mungesës së sigurisë në Ballkan. Pas ndarjes së përgjaksme të ish- Jugosllavisë, PS u miratua nga BE-ja si mjet për të integruar regjionin në BE mbi themelet e bashkëpunimit regjional. Sipas Erhard Busek, koordinator i PS-së, PS-ja paraqet shteg të shpejtë për hyrje në BE.

Në PS, Kosova ka marrë pjesë fuqishëm në shumicën e mekanizmave të PS-së për rritjen e bashkëpunimit rajonal. Në pozitën e pjesëmarrësit ose vëzhguesit, Qeveria e Kosovës ka marrë pjesë në forumet e PS-së në aspekte që shtrihen nga dialogu ekonomik deri te çështjet

e sigurisë. Për këtë arsye për rritjen dhe koordinimin e pjesëmarrjes në mekanizmat e PS-së, Zyra e Kryeministrit ka themeluar Zyrën e Koordinatorit të Paktit të Stabilitetit dhe për t'i dhënë me shumë rëndësi e ka vendosur atë në nivelin e këshilltarit të kryeministrit. Qeveria e Kosovës ka treguar entuziazëm të madh dhe gatishmëri në pjesëmarrje në skenën ndërkombëtare, ndonëse kjo lëmi mbetet kompetencë e UNMIK-ut.

Duke u përgatitur për zgjidhjen e statusit të ardhshëm, Kosova¹⁰⁵ ka marrë pjesë në procesin e stabilizim-asocimit (PSA) prej vitit 2002, së bashku me vendet e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet mekanizmit përcjellës të BE-së të emërtuar *Mekanizmi Përcjellës i PSA-së (STM)*¹⁰⁶. STM ishte dizajnuar për t'i dhënë UNMIK-ut dhe IPVQ-ve ekspertizë dhe udhëzime nga Komisioni Evropian për marrëdhënie të përforuara të bërjes së politikave brenda kornizës së PSA-së si dhe të ndihmojë autoritetet kosovare që të përfitojnë më shumë nga instrumentet thelbësore të PSA-së që u ofrohen rajonit, si për shembull CARDS, TEMPUS për arsimim të lartë, TAIEX si dhe Tving.

Bashkëpunimi ndërkombëtar përmbajtësor nëpër të cilin ka kaluar Kosova prej fundit të luftës është një indikator i varësisë së ndërsjellë që Kosova është duke e zhvilluar me fqinjët e saj dhe besimin që ata kanë arritur ta krijojnë në njëri-tjetrin. Sa më i madh bashkëpunimi, aq më të vogla mundësitë për konflikte në të ardhmen.

Përfundimet kryesore për institucionet ndërkombëtare

Largimi i UNMIK-ut do të krijoj një zbrastësi të konsiderueshme për sa u përket kapaciteteve dhe institucioneve në çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me sigurinë, prandaj kjo çështje duhet që domosdo të trajtohet para largimit të UNMIK-ut.

¹⁰⁵ Sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

¹⁰⁶ Zyra e ZPSSP-së, Zyra për Integritet Evropian, www.euinkosovo.org/pdefault.asp?id=82&Lung=2 (qasur: 7 janar 2006)

ANALIZA E KËRCËNIMEVE TË SIGURISË

1. KËRCËNIMET E BRENDSHME

Në përgjithësi situata në periudhën e pas luftës në Kosovë ka qenë e shënuar si stabile pavarësisht incidenteve të vazhdueshme në nivele të ndryshme. Raste të izoluara të vrasjeve dhe aktiviteteve të tjera kriminale herë pas here ndodhin dhe policia në të shumtën e rasteve ka dështuar të zgjidh shumë prej këtyre rasteve. Megjithatë, situata në terren ka qenë stabile deri në mars 2004 kur trazirat e kapluan Kosovën. Pasojat e këtyre trazirave kanë qenë shumë tragjike dhe përveç vdekjes së dhjetëra njerëzve, ato sollën shkatërrime të monumenteve religjioze dhe pronës private të komunitetit serb. IPVQ-të janë ende duke u marrë me këto pasoja.

Prandaj, besohet se një shkëndijë e vetme e lidhur me sigurinë mund të ndezë fitilin për destabilizimin e Kosovës.

Ekstremizmi dhe terrorizmi politik

Ekstremizmi dhe terrorizmi politik si kërcënime të drejtpërdrejta të sigurisë së brendshme janë të lidhura me pasigurinë aktuale politike, proces dhe rezultat i statusit final të Kosovës. Ekziston një rrezik potencial për përdorimin e dhunës për të arritur objektiva politike nga grupe ekstremiste, qofshin ata shqiptarë apo serbë. Natyra e një dhune të tillë mund të manifestohet nga aksione terroriste sporadike, kryengritje të izoluara deri të dhuna ndër-etnike gjithëpërfshirëse.

Subverzionet politike dhe mos integrimet etnike

Qeveria e Serbisë mundohet të mohoj legjitimitetin e institucioneve të Kosovës duke u munduar të trajtoj ato vetëm si përfaqësuese të shqiptarëve të Kosovës, dhe nuk përkrah pjesëmarrjen e komunitetit serb të Kosovës në IPVQ. Në anën tjetër, ka pasur taktika të rëndësishme nga IPVQ-të për t'i integruar serbët në kornizën ligjore dhe sociale të enklavave të Kosovës të cilat rrezikojnë të bëhen problem i sigurisë në vete nëse nuk integrohen plotësisht në jetën sociale dhe institucionale të Kosovës. Kjo, në vete, shkakton jo stabilitet dhe pasiguri politike në Kosovë dhe rajon.

Siç u theksua më lartë, në rast të mospranisë së KFOR-it dhe UNMIK-ut, vazhdimi të tolerimit të strukturave paralele që veprojnë në Kosovë dhe me IPVQ-të si autoritet ligjor që nuk mund t'i ushtroj përgjegjësitë e veta në mbarë territorin, Kosovës do t' përshtatej përshkrimi i shtetit të dështuar.

“UNMIK-u dhe KFOR-i duhet të krijojnë kushte për menjanimin e barrierave”
(Mitrovicë)

Mungesa sundimit të ligjit dhe besimit të mjaftueshëm në institucionet qeveritare

Krijimi i institucioneve të qeverisura nga sundimi i ligjit sigurisht se do të vazhdoj të mbetet në krye të listës së çështjeve të nxehta. Derisa ekzistojnë shkelje flagrante të rregullave, p.sh. në aspekte të drejtave në pronë (pronësia, posedimi, zotërimi...), konkurrenca, të drejtat autoriale, mbrojtja e ambientit dhe të ngjashme, kur kryesit e veprave penale mbeten të lirë, mbretëron një ndjenjë e mosndëshkimit¹⁰⁷. Për më tepër, një numër i madh i rasteve penale të pazgjedhura, një numër i konsiderueshëm i rasteve që presin gjykim dhe faktorë të tjerë nxisin mosbesim në gjykata dhe në sistemin ligjor në përgjithësi¹⁰⁸. Kështu që ende ekziston një identifikim i mangët i kosovarëve me rregullat në fuqi, jo vetëm ato të miratuara nga UNMIK-u, por edhe me legjislacionin e miratuar nga vetë IPVQ-të.

Ndonëse faktorët në fjalë si të tillë nuk paraqesin nivel të lartë të potencialit për destabilizim, kur ata shikohen përballë sfondit të krimit të organizuar (që konsiderohet të jetë relativisht i izoluar¹⁰⁹) gjithsesi paraqesin rrezik. Për më tepër, përshtypjet publike për shkallen e lartë të korrupsionit brenda institucioneve ndikojnë negativisht në besimin në institucione. Mosbesimi i qytetarëve në efektshmërinë e institucioneve të Kosovës është duke përjetuar trende të rritjes¹¹⁰. Si rrjedhojë, mungesa e kulturës dhe kapaciteteve për implementimin e sundimit të ligjit si dhe rënia e besimit në institucione rrezikojnë të bëhen problem i madh i sigurisë.

Zhvillimi i ngadalshëm ekonomik dhe shtimi i popullsisë

Edhe “shumica shqiptare edhe pakica serbe janë të shqetësuara për mungesën e progresit sa i përket çështjeve të statusit final dhe zhvillimit ekonomik, që mund të sjellin në një shpërthim të dhunës në shkallë më të madhe se sa ajo e trazirave të marsit të vitit 2004”¹¹¹. Kosova ka shkallën më të lartë të lindjeve në Evropë, përderisa rritja ekonomike është larg nga bashkërendimi me papunësinë. Prandaj, një forcë punëtore relativisht e pakualifikuar në krahasim me regjionin dhe Bashkimin Evropian, shoqëruar me rritje demografike përtej potencialit ekonomik paraqet një rrezik në rritje dhe afatgjatë për sigurinë.

¹⁰⁷ Ambassador Kai Eide. “The Situation in Kosovo Report to the Secretary-General of the United Nations. tetor. 2005. Raport, faqe.5.

¹⁰⁸ “Një konkludim i përgjithshëm që shfaqet në të gjitha aspektet është sistemi ligjor në përgjithësi, i ndërtuar paralelisht nga burime të ndryshme, i mungon lidhja logjike dhe përputhshmëria. Ekziston një rrezik në rritje që sistemi do të bëhet shumë i copëtuar, kontradiktor, dhe i ngathët, përveç nëse ekziston një shtytje e madhe për të kodifikuar atë, dhe përveç nëse ekspertët e huaj largohen nga draftimi i ligjeve në një rol vetëm këshillues. Ky rrezik nuk duhet të nënvlerësohet. Shpërputhjet në sistemin ligjor kanë prirje të zmadhohen në kohë, dhe mund të kërcënojnë sundimin e ligjit dhe administrimin e drejtësisë. Sa më shumë që të lejohet zgjatja e procesit, aq më vështirë bëhet të zgjidhet kjo.” UNDP, Assessing Adm. Cap. <http://www.kosovo.undp.org/index.asp> (qasur: 25 dhjetor 2006) f.9.

¹⁰⁹ “Kosovo 2005 Progress Report, European Commission, 2005”.

http://europa.eu.int/comm/enlargement/report_2005/ (qasur 25, nëntor 2005), f.54.

¹¹⁰ Shih, Early Warning Report #11, July-September 2005.

http://www.kosovo.undp.org/publications/ews11/ewr11_engl.pdf (qasur: 20 dhjetor 2005)

¹¹¹ Antonio Donini et al Mapping the Security Environment: Understanding the perceptions of local communities, peace support operations, and assistance agencies Feinstein. International Famine Center June 2005, f.23.

2. KËRCËNIMET TEJ-REGJIONALE

Krimi i Organizuar

Krimi i organizuar, që përfshin krimin e kontrolluar nga oligarkia kriminale, është një kërcënim afatgjatë për sigurinë. Zbrastësia ligjore në Kosovë për të luftuar krimin e organizuar, veçanërisht sa i përket procedurave të ekstradimit ofron kushte relativisht të mira për kriminelët. Prandaj, lidhjet e mundshme të korrupsionit politik¹¹² me krimin e organizuar, të shoqëruara me sundim të dobët të ligjit, përbëjnë një problem serioz për sigurinë e Kosovës, dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë zvogëlojnë në gjasat për investime dhe ndikojnë në një numër të konsiderueshëm të segmenteve të tjera.

Kërcënimet e jashtme dhe mungesa e kontrollit demokratik të forcave të sigurisë

Sa i përket kërcënimeve të jashtme që lidhen me mungesën e kontrollit demokratik të forcave të sigurisë, Kosova duket të jetë një nga vendet më të sigurta në rajon për shkak të pranisë së madhe ushtarake të NATO-s. KFOR-i është i detyruar që ta vazhdojë praninë, së paku deri sa zgjidhja e statusit final nuk implementohet plotësisht dhe regjioni të mos lëvizet nga konfrontimi drejt bashkëpunimit.

Sidoqoftë, besohet se Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë (MPB) dhe njësitë e inteligjencës besohet se ushtrojnë aktivitete në mbarë territorin e Kosovës, edhe pse kjo do të ishte një shkelje e pastër dhe e drejtpërdrejtë e Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake. Bie fjala, në pjesën veriore të Mitrovicës MPB-ja udhëheqë një stacion policor me një personel prej 70 zyrtarëve civil, përafërsisht aq sa ka personel edhe SHPK-ja në këtë rajon¹¹³. Aktivitetet e inteligjencës dhe shërbimeve të tjera të MPB-së janë të shumëllojshme dhe shkojnë përtej atyre që tradicionalisht lidhen me shërbimet e inteligjencës, duke filluar nga mbledhja e informatave e deri te dhënia e dokumenteve personale dhe tabelave të regjistrimit. Përfshirja në këto fusha është më tepër një demonstrim i fushatës politike të Serbisë për të mbajtur “strukturat paralele” në Kosovë sesa vetëm mbledhja e informatave. Ka pasur edhe pretendime se Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë financon pjesëtarët serbë të SHPK-së, më implikime serioze për integritetin profesional të shërbimit. Ndërhyrja e forcave serbe të sigurisë në Kosovë në mënyrë të dukshme është duke e dëmtuar sigurinë, rendin ligjor dhe kushtetues.

¹¹² KosovaLive, CDRSEE and Medijski Centar Beta “Kosovo-Kosova, Coming to Terms with the Problem of Kosovo: The Peoples’ Views from Kosovo and Serbia”. 2005. Nga lista me 31 elemente shqiptarët e Kosovës e ranguan korrupsionin në vendin e katërt të listës së prioriteteve të përgjithshme.

¹¹³ International Crisis Group, Bridging Kosovo’s Mitrovica Divide, <http://www.crisisgroup.org/home/index.cfm?id=3650&l=1> (qasur: 20 dhjetor 2005). f.26

Trafikimi i armëve të vogla, drogës dhe qenieve njerëzore

Rrugët kryesore të trafikimit që vijnë nga Afganistani dhe Lindja e Largët në Evropë pjesërisht kalojnë nëpër Ballkan dhe, më konkretisht, nëpër Kosovë. Pas vitit 1999, Kosova është bërë konsumuese dhe një prej rrugëve të trafikimit të qenieve njerëzore nga vendet e Evropës Lindore në Evropën Perëndimore.

Efektet e përhapjes së konflikteve të brendshme

Fqinjësia e Kosovës po bëhet më e sigurt sesa kurrë me parë. Së pari, përfshirja e Maqedonisë si një kandidatë për anëtarësim në BE-se ka rritur legjitimitetin e elitës politike në Maqedoni dhe të institucioneve të saj dhe ka ulur edhe me shumë gjasat për konflikt të brendshëm. Mundësitë për konflikt në Serbi/Preshevë janë shumë të lidhura me tranzicionin demokratik në Serbi, reformimin e sektorit të sigurisë aty dhe zhvillimet që kanë të bëjnë me bisedimet për statusin final të Kosovës. Përveç kësaj konflikti në Mal të Zi lidhur me referendumin dhe ndjekja e rrugës drejt pavarësisë nuk mund të lihen pas dore. Ndonëse gjasat për efekte anësore nga kjo ekzistojnë, ato mbesin të pakta, keshtu që efekte të tilla nga i tërë rajoni janë shumë pak të mundshme.

“Serbia dhe gripi i shpezëve janë kërcënime të sigurisë për Kosovën” (Deçan)

3. KËRCËNIMET NDËRKOMBËTARE

Terrorizmi ndërkombëtar, radikalizmi fetar dhe rritja e armëve biologjike dhe kimike

Kërcënimet ndërkombëtare bashkëkohore, si terrorizmi ndërkombëtar dhe radikalizmi fetar, nuk paraqesin kërcënim të drejtpërdrejtë, përveç disa përpjekjeve për të ndërtuar dhe forcuar rrjetin¹¹⁴ Wahhabi në regjion. Por, në aspektin afatgjatë, nëse ekonomia nuk përmissohet një terren i përshtatshëm mund të krijohet për grupet e jashtme fundamentaliste. Vonimet në zgjidhjen e statusit final dhe në rimëkëmbjen e ekonomisë mund të shkojnë në favor të organizatave radikale islamike të jashtme, të cilat po përpiqen të fitojnë hapsirë në Kosovë¹¹⁵.

¹¹⁴ Shiko: “Political Islam Among the Albanians: Are the Taliban Coming to the Balkans?” <http://www.kipred.net/UserFiles/File/2A%20Web.pdf> (qasur: 25 dhjetor 2005).

¹¹⁵ Antonio Donini et al *Mapping the Security Environment: Understanding the perceptions of local communities, peace support operations, and assistance agencies*: Feinstein International Famine Center qershor 2005. f.23

Kërcënimi nga rritja e armëve kimike dhe biologjike mund t'i vijë Kosovës nga shtetet që paraqesin kërcënim për sigurinë ndërkombëtare, që në fqinjësinë e Kosovës nuk ka gjasa të ndodhë.

4. PIKAT E BRISHTA

Kur flasim për pikat e brishta nga epidemitë në Kosovë duhet pasur parasysh karakteristikat e regjionit krahasuar me vendet e tjera.

Edhe pse deri më tani Kosova ka qenë relativisht e mbrojtur nga HIV/AIDS-i, Kosova i pëmbush të gjitha kushtet për rrezik nga përhapja e shpejtë e epidemisë HIV/AIDS¹¹⁶.

Sipas klasifikimit të UNAIDS-it, Kosova është rajon me nivel të ultë të epidemive ku janë të pranishme të gjithë parakushtet për një shpërndarje të shpejtë të HIV/AIDS-it. Një rritje, madje e nivelit alarmues, mund të shfaqet për arsye të faktorëve të ndryshëm si numri i madh i të rinjve, shkalla e madhe e papunësisë së bashku me rritjen e konsumimit të drogës, rritja e tregut të seksit, lëvizshmëria e lartë e kosovarëve dhe e komunitetit ndërkombëtar.

Momentalisht Kosova ka një shkallë të ulët të rasteve të lajmëruara të HIV/AIDS-it. Numri i rasteve është i ultë me më pak se 100 raste të raportuara që nga viti 1986, që është shumë i ulët krahasuar me rastet e raportuara në shtetet e Evropës.

Institucionet kryesore të Kosovës për shëndetin publik si Instituti Publik për Shëndetësi, përkundër shkallës së lartë të vdekshmërisë, nuk e konsiderojnë virusin si një problem të madh për momentin, për shkak të mungesës së trajtimit adekuat dhe ilaçeve antiretrovirale.

“Përveq katastrofave natyrore dhe sëmundjeve epidemike përdorimi i drogës dhe prostitucioni janë çështje që janë seriozisht duke e dëmtuar rininë dhe rrezikuar sigurinë” (Prizren)

Edhe pse nuk ka të dhëna demografike të hollësishme (si gjinia, shtrirja gjeografike apo të ardhurat) për njerëzit e infektuar me HIV/AIDS, ne e dimë që shumica e pacientëve janë të grupmoshës 30-39 vjeç.

¹¹⁶ Banka Botërore, Kosovë 2005. *Kosovo Poverty Assessment: Promoting Opportunity, Security, and Participation for All* Prishtinë, 16 korrik 2005: Banka Botërore, Kosovë.

Tuberkulozi është sëmundje që shkakton shqetësim në Kosovë pasi që Kosova është në mesin e vendeve më shkallën më të lartë të tuberkulozit në Evropë. Që nga konflikti, disa OJQ ndërkombëtare janë përpjekur për të ndihmuar institucionet lokale të shëndetësisë në parandalimin dhe kontrollimin e kësaj sëmundje. Një nga pengesat në trajtimin e hershëm të tuberkulozit ishte se që nga viti 1990 e këtej statistikave nuk tregojnë statusin e Kosovës brenda Jugosllavisë si një entitet në vete por si pjesë e Serbisë duke i bashkuar kështu të dhënat së bashku dhe duke mos treguar numër të madh të rasteve për regjione të vogla. Të dhënat e fundit nga burime të ndryshme japin shifra të ndryshme mbi shkallën e rasteve të tuberkulozit, por shifrat nga të gjitha këto burime janë të larta krahasuar me standardet evropiane. Shkalla e suksesit të trajtimit për vitin 2001 ishte 87%, 49 raste, ndërsa numri i të vdekurve i lidhur me TB është 3.5% ose 43 raste në vitin 2001¹¹⁷. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) po e ndihmon Institutin Kombëtar të Kosovës për Shëndet Publik në zhvillimin e strategjisë në luftimin e kësaj sëmundje.

Eksperiencat e mëhershme me shpërthimin e këtyre sëmundjeve në Kosovë përfshijnë një shpërthim të Tularemisë¹¹⁸ në prill të vitit 2000 dhe etet hemorragjike¹¹⁹ në qershor të vitit 2001. Gjatë shpërthimit të Tularemisë nuk ka pasur raporte për vdekje dhe në kushte normale ditore sëmundja nuk ka qenë drejtpërdrejt e transmetueshme nga personi në person. Janë bërë hulumtime për identifikimin e mënyrës së bartjes dhe burimit të shpërthimit të kësaj sëmundje. Tularemia (*Francisella tularensis*) po ashtu njihet edhe si etet e lepurit. Tularemia mund të bartet tek njerëzit përmes rriqrave, pirjes së ujit të ndotur nga minjtë, ngrënies së mishit të papjekur të kafshëve të infektuara, siç janë lepujt, dhe përmes tokës së ndotur. Në fund të ditës 26 komuna në Kosovë kanë raportuar raste të dyshuara.

Kur Turqia raportoi rastin e parë të gripit të shpezëve H5N1 në mes të tetorit të vitit 2005 ky rast i ishte atribuar kontaktit të shpezëve vendore me zogjtë shtegtarë.

Me shtimin në transportin global dhe komunikim, sikurse me urbanizimin dhe qytete të mbipopulluara, epidemitë, nëse lihen të pakontrolluara, përhapen shpejt përtej rajonit. WHO pret që ndikimi i pandemisë tjetër ka gjasa të jetë më i madh në vendet më të ardhura të ulëta për shkak të karakteristikave të veçanta të popullatës dhe burimeve për kujdes shëndetësor pothuajse të pa mjaftueshme¹²⁰.

Hapja e Kosovës, dendësia e madhe e popullsisë, dendësia e lartë urbane dhe trafiku i rënduar i ndërkombëtarëve dhe emigrantëve janë një rrezik shtesë për Kosovën. Kosova mund të konsiderohet si një rajon i rrezikut mesatar¹²¹ për shpërthimin e gripit të shpezëve dhe epidemive tjera për shkak të arsyeve të lartpërmendura.

¹¹⁷ Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mars 2004. "Where Will We Be in 2015? Millennium Development Goals Baseline Report for Kosovo March 2004". Agjencite e Kombeve te Bashkuara ne Kosove

¹¹⁸ http://www.who.int/csr/don/2000_04_21a/en/ (qasur: 20 dhjetor 2005)

¹¹⁹ http://www.who.int/csr/don/2001_06_20e/en/ (qasur: 20 dhjetor 2005)

¹²⁰ http://www.who.int/csr/don/2006_01_05/en/ (qasur: 20 dhjetor 2005)

¹²¹ <http://maps.maplecroft.com/> (qasur: 10 dhjetor 2005)

PËRFUNDIM

Ky raport ka vënë në pah një numër të kërcënimeve për sigurinë në Kosovë si në aspektin afatshkurtër po ashtu edhe në atë afatgjatë dhe ka nënvizuar faktin që në shumë mënyra arkitektura momentale e sigurisë së brendshme nuk është e aftë të përballet me këto sfida. Institucionet që supozohet të kujdesen për siguri (me përjashtim të gjyqësisë) sidoqoftë janë në mes të institucioneve kosovare më të suksesshme dhe kjo jep një element optimist për këtë raport. Sidoqoftë, gjerësia e çështjeve që qeveria duhet të kujdeset dhe kërcënimi për sundimin e ligjit shërbejnë që potencialisht të nënvlerësojnë fuqinë e këtyre institucioneve.

Në periudhën afatgjatë kërcënimi më i madh i mundshëm për Kosovën shkaktohet nga mungesa e zhvillimit ekonomik së bashku me rritjen demografike e cila shfaq një nga rritjet më të mëdha të popullsisë në Evropë. Papunësia e të rinjve, pabarazitë dhe vështirësitë ekonomike që kjo sjellë kanë kapacitet të destabilizojnë Kosovën në disa mënyra. Nëse njerëzit janë të papunë ekziston një mundësi e madhe që ata të jenë të detyruar të ushtrojnë kriminalitet dhe aktivitete ekonomike ilegale vetëm si strategji për mbijetesë. Me shqetësuese, në shumë mënyra se kjo është perspektiva e trazirave sociale që mund të shkaktohen. Niveli i lartë i papunësisë tek të diplomuarit mund të siguroj leadershipin e nevojshëm për trazira të tilla sociale dhe ekstremizëm nëse ekonomia nuk zhvillohet mjaftueshëm.

Ekzistojnë një numër i shkaktareve të mundshëm të pakënaqësisë që mund të prodhojnë trazira sociale. Pamundësia e shtetit të siguroj nevojat elementare të popullsisë mund të jetë një nga ata shkaktarë. Ekziston pakënaqësi domethënëse me pamundësinë që KEK-u të siguroj energji të mjaftueshme për nevojat e popullatës së Kosovës. Është ironike fakti që mungesa e energjisë është gjithashtu një faktor negativ në investimet ekonomike që janë shumë vitale në zhvillimin e mëtutjeshëm të ekonomisë së Kosovës. Nevoja tjera elementare që nuk janë adresuar në mënyrë adekuate përfshijnë qasjen në shërbimet adekuate të shëndetësisë dhe edukimit dhe që është më e rëndësishme në sistemin e drejtësisë. Respekti publik për institucionet e qeverisë tashmë është i ulët siç u vërejt në të dy konsultimet e organizuara nga OSBE-ja për projektin e SHSSB-së dhe gjithashtu tregues është edhe rënia e pjesëmarrjes në votime në zgjedhjet e fundit parlamentare në vitin 2004.

Në Kosovë ekziston një atmosferë e mosndëshkimit dhe mungesës së respektit për sundimin e ligjit. Pamundësia e sistemit gjyqësor në përbushjen e rolit të tij ulë efektin në shkallë të lartë të pjesës tjetër të sektorit të sigurisë dhe inkurajon mungesën e respektit për institucionet qeveritare dhe veçanërisht sektorin e sigurisë. Problemet e shumta në rritje të korrupsionit dhe familjarizimit brenda strukturave qeveritare kanë siguruar gjithashtu rritje në mospërfilljen publike për strukturat ekzistuese. Një çështje tjetër shqetësuese afatmesme dhe afatgjatë është pamundësia e institucioneve të qeverisë t'i përgjigjet emergjencave komplekse. Kjo mungesë e koordinimit është në masë të madhe për shkak të fragmentimeve në kompetencat e qeverisë ndërmjet UNMIK-ut dhe IPVQ-ve e cila ka krijuar potencialisht një ndarje katastrofike të kompetencave në territorin e Kosovës. Trazirat e mëdha shoqërore të vitit 2004 dhe së fundmi problemet që ndërliken më vërshimet dhe rrëshqitjet e dheut në Kosovë vërtetojnë se ekziston pamundësi e degëve të ndryshme të qeverisë për të komunikuar dhe koordinuar ndërmjet veti. Si pasojë, ku dhe kur ka katastrofa të mëdha ambientale, sikurse frika e tanishme nga gripi i pulave, ose trazira sociale sikurse ato të vitit

2004, pamundësia e qeverisë për t'iu kundërvënë mund të ishte katastrofale për Kosovën sikundër edhe për pjesën tjetër të Evropës.

Përfundimet kryesore te këtij raporti janë:

Siguria politike

- Ka pasur mungesë të përgatitjeve për qeverisje të mirë në Kosovë dhe kjo ka shkaktuar zbrazëtira serioze në kapacitetet e gjithëmbarshme.
- Qeverisja e dobët dhe politizimi i administratës publike i shkaktuar pjesërisht nga situata aktuale politike, zvogëlon kapacitetin e qeverisë për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të popullatës dhe t'iu adresohet çështjeve të sigurisë.
- Kuvendi nuk është duke përmbushur në nivel të duhur rolin e tij mbikëqyrës dhe legjislativ. Kuvendi duhet të forcohet nëse dëshiron që në mënyrë adekuate ta përmbush rolin e tij në kuadër të sigurisë. Duhet ti kushtohet një vëmendje nevojës së ndryshimit të sistemit zgjedhor me qëllim që deputetët të bëhen më të përgjegjshëm për veprimet e tyre kundrejt zgjedhësve.
- Mungesa e koordinimit qeveritar brenda dhe ndërmjet IPVQ-ve dhe UNMIK-ut si në duplikim dhe dështimet për t'iu përgjigjur emergjencave komplekse qofshin ato pakënaqësi sociale apo emergjenca natyrore.
- Rritja e zhgënjimit dhe mungesa e besimit në IPVQ dhe UNMIK nënkupton se legjitimiteti është në masë të madhe problem në Kosovë, dhe kjo në vetvete paraqet një kërcënim të rëndësishëm për sigurinë. Komuniteti serb gjithashtu ka vazhduar që të refuzoj të njoh legjitimitetin e institucioneve të Kosovës. Dyshimi për aftësinë e qeverisjes efektive në Kosovë është njëra ndër dukuritë më shqetësuese në planin e kërcënimeve afatgjata.
- Pakënaqësia me punën e gjyqësisë dhe papërshtatshmëria e sistemit penal janë duke e minuar sundimin e ligjit dhe mundësinë për funksionimin e policisë. Vazhdimësia e ekzistencës së strukturave paralele gjyqësore nxitë edhe më tepër mungesën e respektit për organet gjyqësore të Kosovës. Ende ka identifikim të vogël të popullatës së Kosovës me kornizën e tanishme ligjore.
- Zyra e Ombudspersonit ballafaqohet me një mungesë serioze të kredibilitetit dhe kjo nuk është ndihmuar as pas vendimit të fundit të UNMIK-ut se institucionet ndërkombëtare edhe më tutje nuk mund të jenë objekt i inspektimit të tyre.
- Sigurimi i mirëqenies sociale është një funksion thelbësor i funksionimit të shtetit e që aktualisht nuk është garantuar në mënyrë adekuate dhe kështu dëmton besimin publik në institucionet shtetërore. Favorizimet që bëhen në disa nivele, duke përfshirë ndikimet e partive politike dhe ato në baza etnike lidhur më atë së kush duhet të përfitoj, vetëm sa përkeqësojnë gjendjen.

- Mungesa e sigurisë politike është një faktor tjetër shoqërues që ndikon në jo stabilitetin rajonal dhe pasiguri.

Siguria sociale

- Mospërputhja ndërmjet trendëve demografike dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë përbën një nga kërcënimet strukturore afatgjate të sigurisë në Kosovë. Shërbimet joadekuate të shëndetësisë dhe edukimit nuk janë të mjaftueshme për t'i përmbushur nevojat e popullsisë në rritje të Kosovës dhe kjo gjendje vetëm sa do të përkeqësohet edhe më shumë në mungesë të zhvillimit social dhe ekonomik. Zhgënjimi në shkallë të gjerë dhe mos edukimi i duhur i rinisë do të jetë një stimulues i madh për rritjen e kriminalitetit dhe rasteve sociale.
- Rritja e analfabetizmit në Kosovë, në veçanti në mesin e femrave në vendet rurale, është një pengesë për zhvillimit afatgjatë në planin social dhe ekonomik, punësim dhe si rrjedhojë edhe në siguri.
- Arsimi mbetet një çështje shqetësuese pasi që vazhdon të thelloj ndarjen ndërmjet komuniteteve si në aspektin fizik e gjithashtu edhe nëpërmjet programeve në të cilat mësohen në shkollat e ndara shqiptare dhe serbe. Për më tepër, për aq kohë sa komunitetet janë të frikësuara që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në të njëjtat shkolla, atëherë kjo paraqet edhe një tregues tjetër për gjendjen e tensionuar ndëretnike.
- Varfëria ekstreme në Kosovë për një kohë të gjatë do të vazhdoj të mbetet prodhues i krizave sociale dhe i rritjes së kriminalitetit pasi njerëzit ose do të shprehin mllefën e tyre ndaj shtetit dhe shoqërisë ose do t'i rreken kriminalitetit si strategji për të mbijetuar.
- Kosova mbetet një shoqëri e ndarë me shumë pak ndërveprim ndërmjet shumicës shqiptare dhe minoritetit serb. Kjo ndarje në pjesë të madhe është rezultat i gjendjes së krijuar në të kaluarën por edhe i ndjenjave aktuale të pasigurisë tek serbët e Kosovës që për pasoj sjell krijimin e rrethit vicioz në mungesë të sigurisë dhe thellimin edhe më të madh të gjendjes së pasigurisë si pasojë e ndarjeve etnike.

Siguria ekonomike

- Mbështetja e madhe e Buxhetit të Kosovës (BK) në taksat doganore (70%) pasqyron deficitin e tanishëm tregtar dhe po ashtu edhe ekonominë jo të shëndoshë. Megjithatë, në planin afatgjatë kërcënimi më i madh që lidhet me sigurinë do të mund të jetë korrupsioni eventual në shërbimet doganore. Në kuadër të kësaj duhet theksuar edhe faktin se buxheti i Kosovës dhe politikat fiskale do të ndikohen negativisht nga aplikimi i mundshëm i Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë (MTL).

- Mungesa e ekonomisë së qëndrueshme minon çdo mundësi afatgjate për Kosovën dhe sjell papunësi të lartë, që ndoshta është kërcënimi më i madh për sigurinë në planin afatgjatë.
- Vazhdimësia e gjendjes së tillë ekonomike e karakterizuar nga përkrahja e donatorëve mund të rezultojë edhe më zvogëlimin e mundësive të Kosovës për t'iu përgjigjur kërcënimeve të sigurisë.
- Pamundësia për të pasur burim të pandërprerë të energjisë është një faktor tjetër shkatërrues i investimeve në Kosovë. Për më tepër, mungesa e ndriçimit në zonat e urbanizuara krijon përshtypjen e pasigurisë dhe gjithashtu demonstroi paaftësinë e qeverisë dhe zbehë legjitimitetin e saj.

Siguria e ambientit

- Situata e tanishme e papërgjegjesisë ka ndikuar shumë edhe në ambientin e Kosovës i cili është nën kërcënim të vazhduar për shkak të ndërtimeve ilegale, menaxhimit të dobët të mbeturinave, ndotjes dhe i veprimeve të cilat shkaktojnë erozionin e tokës dhe vërshimet. Kjo gjendje pengon investimet dhe për më tepër vështirëson edhe me shumë gjendjen problematike të ambientit me të cilin ballafaqohet popullata në rritje në Kosovë, dhe për rrjedhojë sjell rritjen e sëmundjeve.

Siguria etnike

- Vazhdimi i perceptimit të pasigurisë në mesin e komuniteteve, e në veçanti tek komuniteti serb, e gjithashtu edhe mos integrimi i komuniteteve paraqesin një problem kërcënues afatgjatë për stabilitetin dhe sigurinë.
- Pasiguria politike dhe ekonomike është forca kryesore e cila nxit migrimin jashtë Kosovës. Sa i përket popullatës serbe kryesisht janë arsyet politike ato të cilat nxisin këtë fenomen ndërsa për popullatën shqiptare duket se mungesa e mundësive ekonomike është shkaku kryesor.
- Përkundër kornizës ligjore e cila garanton barazinë ndërmjet grupeve etnike dhe të drejtën për kthim, mundësitë për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin e komuniteteve ndërmjet minoriteteve janë të kufizuara.

Institucionet e sigurisë

- Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të SHPK-së do të bëhet problematike në atë moment kur atyre do t'iu kërkohet të marrin përsipër rolin që momentalisht e kryen prania e policisë ndërkombëtare.
- TMK-ja nuk është e pranuar akoma nga minoriteti serb. Ndërkohë që TMK-ja mund ta tejkaloj këtë pengesë, ekziston një problem tjetër që ka të bëjë perceptimin e popullatës se mandati i tanishëm i TMK-së si një organizatë civile emergjente duhet

të avancohet në ushtri të ardhshme. Kjo mospërputhje ndërmjet mandatit dhe aspiratave, si nga ana e personelit e po ashtu edhe nga popullata konsiderohet si një çështje problematike.

- KFOR-i është përgjegjës për sigurinë dhe ofron përkrahje për të gjitha komunitetet në tërë Kosovën. Si garantuesi i vetëm i sigurisë së jashtme në Kosovë, vazhdimi i rolit të KFOR-it do të jetë faktor thelbësor për të siguruar stabilitet të vazhdueshëm në Kosovë. Komuniteti ndërkombëtar, megjithëkëtë, në planin afatgjatë duhet të mendoj për ndonjë mekanizëm tjetër adekuat që do ta zë vendin e KFOR-it kur ai të tërhiqet.

Institucionet ndërkombëtare

- Largimi i UNMIK-ut do të krijoj një zbrazëtirë të konsiderueshme të kapaciteteve dhe institucioneve në çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me sigurinë, andaj duhet që ky problem të trajtohet para largimit të tij.

Bibliografia

- A comprehensive review of the situation in Kosovo* (Prepared by Secretary General's Special Envoy, Ambassador Kai Eide), presented to the UN Security Council on October 2005. http://www.kosovo.com/news/archive/2005/October_08/4.html (Last visited 15 December 2005)
- Andrus, Ovel. 29-30 September 2003. *Border Security – Opportunity or Obligation*. Geneva Conference. Geneva: DCAF.
- ARD-BIOFOR IQC Consortium. May 2003. *Kosovo Biodiversity Assessment*. USAID. Prishtina.
- Avagyan, Gagik and Hiscock Duncan. May 2005. *Security Sector Reform in Armenia*. London: Saferworld.
- Bajpai, Kanti. August 2000. *Human Security: Concept and Measurement*. Kroc Institute Occasional Paper #19:OP: 1
- Balsis, Catherine, Marcia Greenberg and Liz McKeon. May 2004. *Building Diversity: An Action Plan for Integrating Gender, Youth and Ethnicity into the USAID/Kosovo Program*. USAID, Kosovo.
- Bryden, Alan, Donais Timothy and Heiner Hänggi. November 2005. *Shaping Security Governance Agenda in Post-Conflict Peacebuilding*. Policy paper no. 11. Geneva: DCAF.
- Buzan, Barry, Ole Weaver and Jaap de Wilde. 1998. *Security: A New Framework for Analysis*. Lynne Rienner Publishers. <http://www.drake.edu/artsci/PolSci/personalwebpage/security.html>. (Last visited 20 February 2006)
- Cami, Arben. *Kosovo Health System*. UNMIK, PISG, Ministry of Health.
- Caparini, Marina. *Security Reform and Post-Conflict Stabilization: The Case of the Western Balkans*. Chapter 7.
- Center for European Security Studies. May 2004. *Security Matters*. Newsletter from the Center for European Studies, Issue 12.
- Center for European Security Studies. November 2004. *Security Matters*. [Newsletter] Center for European Studies, Issue 13
- Center for the Democratic Control of the Armed Forces (DCAF). October 2002. *Managing Chang: The reform and Democratic Control of the Security Sector and International Order*. Occasional paper – no. 1. Geneva.
- Cohen, J. Lenard. *Kosovo: From Interim Status to Enhanced Sovereignty*. Center for Contemporary Conflict. <http://www.ccc.nps.navy.mil/si/2006/Jan/cohenJan06.asp>. (Last visited 16 December 2005)
- DCAF. Intelligence Working Group. July 2003. *Intelligence practice and democratic oversight – a practitioner's view anaging Chang: The reform and Democratic Control of the Security Sector and International Order*. Occasional paper – no. 3. Geneva.
- Democratic Control of Armed Forces. November 2005. *National Security Policy*. DCAF: Geneva.
- Dilemmas of the United Nations Civilian Police* [Document].
- Donini, Antonio, et al. June 2005. *Mapping the Security Environment: Understanding the perceptions of local communities, peace support operations, and assistance agencies*. Feinstein International Famine Center. Friedman School of Nutrition Science and Policy.
- Ebo, Edejeji. December 2005. *The challenges and opportunities of security sector reform in post-conflict Liberia*. Occasional paper no. 9. Geneva: DCAF.

- Economic Strategy and Project Identification Group. August 2004. *Toward a Kosovo Development Plan: The state of the Kosovo economy and possible ways forward*. Policy Paper #1. Prishtina.
- Elbe, Stefan, et al. September 2005. *Disaster, Diseases, Disruption: a new D-drive for the EU*. Institute for Security Studies. European Union. Challiot paper No 84.
- Eriksen Hylland, Thomas. March 2005. *Risking Security, Paradoxes of Social Cohesion*. Inaugural lecture at the Vrije University Amsterdam. <http://folk.uio.no/geirthe/Security.html> (Last visited 12 November 2005)
- European Commission. 2005. *Kosovo (Under UNSCR 12 44) 2005 Progress report*.
- European Commission. 9 November 2005. *Kosovo (under UNSCR 12 44). 2005 Progress Report*. Brussels.
- Evans, Roderick. September 2002. *Donor Perspective on Security Sector Reform as a Governance Issue*.
- Fisher, Jeff. August 2002. *Democratic control of Armed Forces and Kosovo. Security in the Absence of State*. Geneva: DCAF.
- Fitz-Gerald, M. Ann. March 2003. *Linkages between Security Sector Reform and Peacekeeping Intelligence*. Journal of Security Sector Management. No1. Global Facilitation Network for Security Sector Reform. Shrivenham, UK: University of Cranfield.
- Frederking, Brian. 2000. *Constructing Collective Security in Kosovo*. <http://www.beyondintractability.org/essay/security/> (Last visited 16 November 2005)
- Friedrich, Roland. November 2004. *Security Sector Reform in the Occupied Palestinian Territories*. PASSIA Publication. <http://www.passia.org/publications/Security/Security-Sector.htm> (Last visited 12 November 2005)
- Hänggi, Heiner and Fred Tanner. July 2005. *Promoting Security Sector Governance in the EU's neighborhood*. European Union: Institute for Security Studies.
- IMF Mission to Kosovo. July 14- 25 2005. Aide Memoir.
- Institute for Environmental Security. 2004. *Pathways to Environmental Security*. Hague Conference on Environment, Security and Sustainable Development.
- International Crisis Group. April 2004. *Collapse in Kosovo*. Europe Report no. 155. Prishtina/Belgrade/ Brussels.
- International Crisis Group. January 2005. *Kosovo: Toward final status*. Europe Report no. 161.
- International Crisis Group. March 2000. *What happened to KLA? ICG Balkans Report no. 88*. Prishtina/Washington/ Brussels.
- International Crisis Group. May 2005. *Kosovo after Haradinaj*. Europe Report no. 163.
- International Crisis Group. November 2005. *EU Visas and the Western Balkans*. Europe Report no. 168.
- International Crisis Group. September 2002. *Finding the Balance: The scales of justice in Kosovo*. ICG Report no. 134. Prishtina/Brussels.
- International Monetary Fund. December 10, 2004. *Rebuilding Fiscal Institutions in Post –Conflict Countries*.
- International Peace Academy. *The future of UN state building: Strategic and Operational Challenges and the Legacy of Iraq*. [Policy report]. http://www.ipacademy.org/PDF_Reports/FUTURE_OF_UN_STATE_BUILDING.pdf (Last visited: 10 January 2006).
- International Peace Academy. *You, the People: Transitional Administration, State-Building and the United Nations*. [Conference report]

- http://www.ipacademy.org/PDF_Reports/YOU_THE_PEOPLE.pdf (Last visited: 12 January 2006).
- Irwin, Colin. *Kosova – Kosova. Coming to Terms with the Problem of Kosovo: The people's views from Kosovo and Serbia*. Kosova Live, Medijski Centar Beta and Center for Democracy and Reconciliation in Southeastern Europe.
- Jazbec, Milan. April 2005. *Defence Reform in the Western Balkans, The Way Ahead*. Policy paper. Geneva: DCAF.
- Kanji, Omario. October 2003. *Security*. <http://www.beyondintractability.org/essay/security/> (Lst visited 15 December 2005).
- KFOR Weekly CIMIC. 14 December 2005. Report # 1140.
- KFOR Weekly CIMIC. 7 December 2005. Report # 1139.
- KFOR. 30 November 2005. Weekly CIMIC. Report # 1138.
- KFOR. *Multinational Specialized Unit*. <http://www.nato.int/kfor/kfor/msu.htm>. (Last visited: 17 December 2005).
- Khakee, Anna and Nicolas Florquin. June 2003. *Kosovo and the Gun; A baseline Assessment of Small Arms and Light Weapons in Kosovo*. Prishtina, Kosovo. UNDP and Small Arms Survey.
- KIPRED, Local Government and Administration in Kosovo, <http://www.kipred.net/UserFiles/File/Libri%2001%20WEB%20RGB%2072.pdf> (Last visited: 23 December 2005).
- KIPRED, Political Islam Among the Albanians: Are the Taliban Coming to the Balkans? <http://www.kipred.net/UserFiles/File/2A%20Web.pdf> (Last visited: 25 December 2005).
- KIPRED, *Reforming the Electoral System of Kosovo, 2005*. <http://www.kipred.net/UserFiles/File/4A%20Web.pdf> (Last visited: 10 January 2006).
- KIPRED, *Voting Trends and Electoral Behavior in Kosovo 2000-2004* (Forthcoming).
- Klekowski von Koppenfels, Amanda. 2004. *Profiling of irregular migrants and analysis of reintegration needs of Potential Returnees from Kosovo (Serbia and Montenegro), Albania and FYROM in Belgium, Italy, the United Kingdom and Germany*. IOM. Prishtina.
- Kosovo Protection Corps. 18 December 2003. Donor Conference.
- KPC. 2004. Budget for Reserved Powers. (From KPC Internal Document) 15 January, 2006.
- Letter of Branko Bojchevski – Director of the Bureau for Public Security. Ministry of Internal Affairs. 27 November 2002. Skopje, Macedonia.
- Lindstrom, Gustav. July 2004. *Protecting the European Homeland: The CBR Dimension*. Institute for Security Studies, European Union.
- Memorandum of Understanding on Police Cooperation between The Government of the Republic of Albania and UNMIK. September 2002.
- Memorandum of Understanding on Police Cooperation between The Government of the Republic of Montenegro and UNMIK. Draft, 17 October 2003.
- Meurs, Wim van and Stefani Weiss. 6 December 2005. *Qualifying (for) Sovereignty; Kosovo's Post-Status and the Status of EU Conditionality*. Discussion Paper. Bertelsmann Stiftung.
- Moalla-Fetini, Rakia, et al. 2005. *Kosovo Gearing Policies toward Growth and Development*. International Monetary Fund.
- National Democratic Institute, OSCE Kosovo, Assembly Support Initiative (ASI). 2004. *Assembly of Kosovo Public Hearing Manual*. Prishtine.
- NATO. KFOR Objectives and Mission. <http://www.nato.int/kfor/kfor/objectives.htm>. (Last visited 12 November 2005)

- NATO. May 2005. *Research Paper*. Academic Research Branch – NATO. No. 19 Rome: Defense College.
- NMIK, Provisional Institutions of Self Government and The office of the Prime Minister. *Kosovo Government Program 2004-2008*.
- OSCE Kosovo and UNHCR Kosovo. March 2003. *Tenth Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo*
- OSCE Kosovo and UNMIK. 1 September 2000 – 28 February 2001. *Kosovo, Review of the Criminal Justice System*.
- OSCE Kosovo and UNMIK. April 2003 – October 2004. Crime, Detention and Punishment. Kosovo. Review of the Criminal Justice System. Available at: http://www.osce.org/documents/mik/2004/12/3984_en.pdf (Last visited 14 January, 2006)
- OSCE Kosovo and UNMIK. December 2005. *Implementation of Kosovo Assembly Laws. Review Period: Laws Promulgated in 2004*. Report II.
- OSCE Kosovo and UNMIK. March 2002- April 2003. Kosovo Review of the Criminal Justice System. “*Protecting of witnesses in the criminal justice system*”. Kosovo
- OSCE Kosovo and UNMIK. March 2002. Legal Systems Monitoring Sections. *On the Administration of Justice*. Report 9.
- OSCE Kosovo and UNMIK. October 2001. *Review of the Criminal Justice System*. Themes: Legal Representation Detention. Trafficking and Sexually Related Crimes, Municipal and Minor Offence Courts. Available at: http://www.osce.org/documents/mik/2001/11/966_en.pdf (Last visited 21 January, 2006)
- OSCE Kosovo and UNMIK. October 2003. *Parallel Structures in Kosovo*.
- OSCE Kosovo and UNMIK. September 2001 – February 2002. Review of the Criminal Justice System. *Themes: Independence of the Judiciary Detention Mental Health Issues*. Kosovo.
- OSCE Kosovo. *Kosovo Judicial Institute*. OSCE Fact Sheet.
- OSCE. 1 September 2000 – 28 February 2001. A review of the Criminal Justice System. July 2001. Available at: http://www.osce.org/documents/mik/2001/07/969_en.pdf (Last visited 21 December, 2005)
- OSCE. 17 December 1999. *The Development Of The Kosovo Judicial System 10 June - 15 December 1999*. Report 2. OSCE Kosovo, Department of Human Rights and Rule of Law, Human Rights Division. http://www.osce.org/documents/mik/1999/12/963_en.pdf (Last visited 15 February 2006)
- OSCE. May 2004. Assembly of Kosovo Public Hearing Manual http://www.osce.org/documents/mik/2004/05/2932_en.pdf (Last visited 15 February 2006)
- OSCE. January 2005. *Implementation of Kosovo Assembly Laws by the Executive Branch of the Provisional Institutions of Self- Government*. Available at: http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/17515_en.pdf (Last visited 20 December 2005)
- OSCE. March 2004. Kosovo Review of the Criminal Justice System “The Administration of Justice in the Municipal Courts” Available at: http://www.osce.org/documents/mik/2004/03/2499_en.pdf (Last visited 15 February 2006)

- OSCE. March 2002. Legal Systems Monitoring Section. Implementation of Kosovo Assembly Laws Report I
http://www.osce.org/documents/mik/2002/03/863_en.pdf (Last visited 14 December 2005)
- OSCE. March 2002. Legal Systems Monitoring Section. Implementation of Kosovo Assembly Laws Report II
http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/17515_en.pdf (Last visited: 20 December 2005).
- OSCE. May 2003 Review of the Criminal Justice System (March 2002 – April 2003)
http://www.osce.org/documents/mik/2003/05/859_en.pdf (Last visited: 13 February 2006).
- OSCE. July 2001. A Review of the Criminal Justice System
http://www.osce.org/documents/mik/2001/07/969_en.pdf (Last visited: 13 February 2006).
- OSCE. December 2005. *The response of the Justice System to the March 2004 Riots*
http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/17177_en.pdf (Last visited: 6 January 2006).
- OSCE. April 2000. *The treatment of Minorities by the Judicial system. Background Report*
http://www.osce.org/documents/mik/2000/08/970_en.pdf (Last visited: 20 December 2005).
- Parvanov, Anton. *Aspects of Stability and Security in South-East Europe in South-East Europe at the End of 90's*.
http://www.newbalkanpolitics.org.mk/OldSite/Issue_2/parvanov.eng.asp (Last visited: 20 December 2005).
- Priebe, Reinhard. 28 – 30 November 2004. *The Western Balkans European Perspective*. Oesterreichische Nationalbank. Conference on European Economic Integration. Vienna.
- Protocol on Cross – Boundary Repatriation of Identified Remains. February 2002. (Between UNMIK and The Government of the Federal Republic of Yugoslavia/ Republic of Serbia)
- Protocol on Joint Verification Teams on Hidden Prisons. 11 February 2002. (Between UNMIK and The Government of the Federal Republic of Yugoslavia/ Republic of Serbia)
- Protocol on Police Cooperation between UNMIK and The Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia. May 2002.
- Protocol on the Exchange of Forensic Experts and Expertise. February 2002. (Between UNMIK and Federal Republic of Yugoslavia/Republic of Serbia)
- RIINVEST. 9 March 2004. *Privatization in Kosovo: Forwards and Backwards*. Roundtable Discussion. RIINVEST. Prishtina.
- RIINVEST. January 2003. *Labor Market and Unemployment in Kosovo*. Draft Research Report. Prishtina.
- Ross, Michael. August 2003. *What Do We Know About Natural Resources and Civil War*. Los Angeles: University of California.
- Security Sector Development Advisory Team. May 2005. *Kosovo Internal Security Sector Review Concept: Scoping Study*.
- Shah, Anup. *Effects on bombing in the Environment*.
<http://www.globalissues.org/Geopolitics/Kosovo/Environment.asp> (Last visited: 10 October 2005).

- Shinoda, Hideaki. 2004. *The concept of Human Security: Historical and Theoretical Implications*. <http://home.hiroshima-u.ac.jp/heiwa/Pub/E19/Chap1.pdf>. (Last visited: 20 December 2005).
- Statistical Office of Kosovo. 2004. *Labor Market Statistics*. Prishtina, Kosovo.
- Stone, Christopher and John Markovic. March 2002. *Crime mapping and the policing of Democratic Societies*. Vera Institute of Justice.
- Svetchine, Michel, *Kosovo Experience with Euroisation of its Economy*. Bank of Albania-Fifth International Conference.
- The World Bank.. November – December 2005. *Kosovo Economic Monthly Briefing*.
- UNDP and RIINVEST. 2002. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #1, May –August 2002, Prishtina.
- UNDP and RIINVEST. 2002. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #2, September – December 2002, Prishtina.
- UNDP and RIINVEST. 2003. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #3, January – April 2003, Prishtina.
- UNDP and RIINVEST. 2003. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #4, May – August - December 2003, Prishtina.
- UNDP and RIINVEST. 2003. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #5, September – December 2003, Prishtina.
- UNDP and RIINVEST. 2004. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #6, January – April 2004, Prishtina.
- UNDP and RIINVEST. 2005. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #10, April – June 2005, Prishtina.
- UNDP and RIINVEST. 2005. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #11, July – September 2005, Prishtina.
- UNDP and RIINVEST. 2005. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #9, January – March 2005, Prishtina.
- UNDP and RIINVEST. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #8, September – December 2004, Prishtine, Kosovo.
- UNDP Kosovo and Kosovo Provisional Institutions of Self Government- Office of the Prime Minister. *Combating Corruption in Kosovo; A citizen's perception Survey in Support of the Kosovo Anti-corruption Strategy*.
- UNDP Kosovo. 2002. *Human Development Report*.
- UNDP Kosovo. 2004. *Human Development Report*. Kosovo.
- UNDP Kosovo. 2004. *Light blue: Public Perception of Security and Police Performance in Kosovo*. Prishtina.
- UNDP Kosovo. April 2005. *Assessment of Administrative Capacity in Kosovo*. Prishtina.
- UNDP Kosovo. March 2003. *The Kosovo Mosaic: perceptions of local government and public services in Kosovo*. Prishtina, Kosovo.
- UNDP, USAID and RIINVEST. 2004. *Early Warning Report, Kosovo*. Report #7, May – August 2004, Prishtina.
- United Nation Security Council. 25 January 2006. Report of the Secretary-General of United Nations Interim Administration Mission in Kosovo.
- United Nations Agencies in Kosovo. March 2004. *Where we will be in 2015: Millennium Development Goals*. Baseline report for Kosovo. Prishtina. Kosovo.
- United States Institute of Peace. December 2002. *Lawless Rule versus Rule of Law in the Balkans*. <http://www.usip.org/pubs/specialreports/sr97.html>. (Last visited: 11 January 2005).

- UNMIK, PISG and Ministry of Economy and Finance. July 2005. *Korniza Afatemesme buxhetore, projekt strategjia per buxhetin 2006- 2008. (Medium-term budgetary framework, project strategy for budget 2006-2008).*
- UNMIK, UNDP Kosovo, Provisional Institutions of Self Government (PISG). December 2005. *Kosovo Internal Security Sector Review Newsletter. Issue 1.*
- UNMIK. June 2004. Pillar 1, Police and Justice. Presentation Paper.
- US Department of State. *Kosovo: Current and Future Status.*
http://beqiraj.com/kosova/de/current_and_future_status/index.asp. (Last visited: 20 December 2005).
- Verstegen, Suzanne, Luc van de Goor and Jeroen de Zeeuw. 2005. *The stability Assesment Framework: Designing Integrated Responses for Security, Governance and Development.* The Netherlands Institute of International Relations "Clingendael".
- Wilkinson, Paul. October 2005. *International Terrorism: the changing threat and the EU's response.* Institute for Security Studies. European Union. Chailiot Paper No.84.
- Woodrow Wilson School Graduate Program. 2003. *Security and Development.* New Jersey: Princeton University.
- World Bank Kosovo. 16 June 2005. *Kosovo Poverty Assessment: Promoting Opportunity, Security, and Participation for All.* Report no. 32378- XK. Prishtina. World Bank Kosovo.
- World Health Organization. April 2002. *Health Action in Kosovo.* Newsletter on Emergency and Preparedness and Response. Issue no. 53.
- World Health Organization. February 2002. *Health Action in Kosovo.* Newsletter on Emergency and Preparedness and Response. Issue no. 51.
- World Health Organization. January 2002. *Health Action in Kosovo.* Newsletter on Emergency and Preparedness and Response. Issue no. 50.
- World Health Organization. June/ July 2002. *Health Action in Kosovo.* Newsletter on Emergency and Preparedness and Response. Issue no. 55.
- World Health Organization. March 2002. *Health Action in Kosovo.* Newsletter on Emergency and Preparedness and Response. Issue no. 52.
- World Health Organization. May 2002. *Health Action in Kosovo.* Newsletter on Emergency and Preparedness and Response. Issue no. 54.
- Yusufi, Islam. August 2004. *Security Governance: Security Sector Reform in Southeast Europe.* Budapest: Center for Policy Studies.

Për KIPRED-in

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave ka për qëllim të përkrahë vlerat demokratike në Kosovë përmes trajnimeve dhe analizave të pavarura të politikave publike. Trajnimet kryesisht fokusohen në zhvillimin e partive politike përmes Internet Akademisë për Demokraci, e zhvilluar në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare Olof Palme nga Suedia. Kërkimet fokusohen në botimin e analizave të pavarura në fusha si qeverisja e mirë, administrata, zhvillimi i partive politike, bashkëpunimi rajonal, politika ekonomike dhe qeverisja lokale.

KIPRED

Kodra e Diellit, Rr. III, Ll. 39

Prishtinë, Kosovë

Tel/Fax: +381 (0) 38 555 887

Info: info@kipred.net

www.kipred.net